



“Traduttore – Traditore” thonë italianët. Ka kohë që zhvillohet debati nëse është tradhti përkthimi i një vepre. Në këtë kontekst, sa “tradhtar” është Noli? Thuajse një shekull më parë, shqiptarët e Amerikës shtruan për diskutim këtë çështje në gazetën e tyre “Dielli”.

DEBATI I VITEVE '20 MBI SHQIPËRIMIN E “HAMLETIT” NGA FAN NOLI

Nga Andreas Dushi



SHËNIME MBI LIBRAT

Romani “Darka e gabuar” i Kadaresë
KRYEVEPRA E
PAGABUESHME NË
“DARKËN E GABUAR”

Nga Zija Çela

(fq. 5)

NEOKLASICIZMI NË
TRAGJEDINË “ABELI” TË E.
HAXHIADEMIT

Nga Fatlum Mehulli

(fq. 6)

Romani “Frosina e Janinës” i Mira Meksit

PORTRETI I PANJOHUR
I FROSINËS AQ I
NGJASHËM ME ATË
TË AUTORES

Nga Shpendi Topollaj

(fq. 10)

Romani “Shpirtra të shitur” i Kleo Latit

Zjarrmi poetike që
e ngrenë shpirtin lart

Nga Josif Papagjoni

(fq. 11)

VITI I PRUSTIT:
100-VJETORI
I VDEKJES

Nga Feride Papeleka

(fq. 20)

“ËRRËSIRA” E OLTSEN
GRIPSHIT SI
METAFORE METAFIZIKE
E KUJTESËS

Dr. Etleva Demollari

(fq. 15)



BESSA MYFTIU Rrëfim për Tiranën e dikurshme

Bisedoi Marcela Tringaj

(fq. 8)

Bessa Myftiu është poete, skenariste, autore romanesh e novelash, që lindi dhe u shkollua në Tiranë e prej vitit 1991 jeton në Gjenevë. Fillimet e saj janë si gazetare, por nuk ka lënë pas për asnjë moment pasionin për të shkruar. Ajo spikat si skenaristja e filmit televiziv mjaft të njohur “Unë e dua Erën”.

GJENDJA NË SHQIPËRI
NË MOTIN 1922

(fq. 14)

Nga Lumo Skëndo

Suksese panairit
të 22^{te} të librit
PRISHTINA 2022
7 - 12 QERSHOR 2022

LIRIA E SHKRIMTARI
nga Nadine Gordimer

(fq. 22)



SI MUND TË LEXOHE
POSTMODERNIZMI *me*
ndihmën e kritikëve dhe
teoricienëve Linda Hutcheon,
Brian McHail, John Barth,
Umberto Eco, Gerard Genette,
Roland Barthes, Matei
Calinescu, Jean Baudrillard etj.

(fq. 5)

Nga Dr. Gazmend Krasniqi

BIBLIOTEKË


- Bessa Myftiu (fq. 9)
Rrëfime nga vende të harruara
- Pablo Neruda (fq. 17)
Buqetë lirikash
- Qazim Shehu (fq. 16)
Tre tregime
- Marie Aubert (fq. 18)
Nuk ka problem
- August Strindberg (fq. 19)
Sëmundja e dashurisë
- Dino Barberis (fq. 23)
Keqardhjet

DEBATI I VITEVE '20 MBI SHQIPËRIMIN NGA FAN NOLI TË TRAGJEDISË "HAMLETI"

Nga Andreas Dushi

Gjithnjë e më tepër diskutohet mbi nevojën e përhershme për ripërkthime të veprave themelore, duke pasur parasysh faktin se gjuha evoluon. Aq më tepër, po morëm rastin e shqipes, kanonizimi në standard i së cilës është realtivisht i vonë (1972), bëhet edhe më i domosdoshëm rishikimi i veprave të përkthyer më heret. Një ndër shqipëruet që ka ngjallur gjithmonë debat është edhe Fan Noli.

Botimi i pesë përkthimeve të hershme që ai ka realizuar njoftohet në numrin 287 të gazetës "Shqipëri" e re", tetor, 1926.



Faksimil nga gazeta "Shqipëri" e re"

Nga vëzhgimi im, një vit më pas, përkatësisht nga tetori i 1927 deri në janarin e 1928 realizohet debati i parë publik lidhur me përkthimin. Në gazetën "Dielli" të Amerikës, diskutohet për "Hamletin", përkthyer nga Noli dhe botuar në Bruksel më 1926, me ndihmë financiare të shokëve të Amerikës të cilëve edhe u dedikohet ky përkthim.

Një vit më vonë, përkatësisht në tetor të 1927, në Arlington Theatre të Bostonit, u luajt nga The Shakespeare American Association tragjedia "Hamleti". Ndër të pranishmit që e ndoqën ishte edhe Hito E. Sadiku, i cili shkroi një recension për të në "Dielli" (7 tetor, 1927) ku flet për lojën

aktoriale si dhe, diçka të shkurtër mbi pritjen e "Hamletit", bashkë me kritikën e George Bernard Showt dhe Tolstoit. Ndërsa në pjesën e dytë të shkrimit, ndalet te përkthimi i realizuar prej Nolit:

Kam dëshiruar dhe tani e solli rasti të them dyfjalë për "Hamletin" e shqipëruar. Ata që dinë gjuhën anglisht munt t'a kuptojnë se sa lehtë është përkthimi i një veprë t'atillë. Fan Noli na e paska gjetur fare të lehtë për ta shqipëruar, dhe ashtu bëri; po ata që e kanë kënduar atë përkthim kanë parë se ç'vëpër u ka dhënë Fan Noli "shokëve tij t'Amerikës".

Më pas, vendos një pjesë nga akti III, skena I në anglisht dhe përkthimin e realizuar prej Nolit, emërtuar sise përkthimi që na ka bërë Fan Noli në mullirin e përkthimeve, ose "me industrinë" e tij letrare.

Duke lënë të kuptohet se teksti në shqip ndryshon nga ai në anglisht, Sadiku e mbyll shkrimin me:

Besoj që nuk duhet koment. Në qoftë se duhet, duhet të zgjatemi tepër, po s'kemi as kohë, as vend.

Por përgjigjja nuk vonon. Një javë më pas, po në "Dielli" (14 tetor, 1927), Ismail Mevlani shkruan:

*I dashur Zoti Editor,
Në gazetën Dielli këndova artikullin me titullin "Hamleti" të shkrojtur prej Z.t Hito Sadik. Ky mjeshtër i ri i letrave kritikon Nolin për përkthimin e Hamletit nga anglishtja në shqipe. Nuk dua të merem me njerëzit e rinj të letrave se ata atë punë kanë dhe munt që të dinë më tepër nga neve që punojmë për të bërë rojken, po dua të them pak fjalë për përkthenjësën e veprës me famë të Shakspear-it Hamletin në gjuhën tonë.*

Jam një miku më i ngushtë i librave shqipe. Dhe meqë jam një shoku i pandarë i librave shqipe kam kuptuar se me të këndshme dhe më të vlershme janë librat e Nolit që ka përkthyer nga gjuha e huaj. Me fakte përpara syve unë Nolin e quanj si njerin më të zotin në përkthimin dhe mjeshtërin më të mbaruar që ka kombi ynë sot në sheshin e letraturës.

Fan Nolin e kemi një kundërshtar në sheshin e politikës, po nuk do të jetë kurrë kundërshtari ynë në sheshin e letrave. Këtë Z. Hitko Sadik nuk e kupton, si duket.

[...]

Zoti Hito Sadik e paska kuptuar që është një punë shumë e rëndë të përkthesh

një vepër kllasike nga një gjuhë e huaj. Ahere pse nuk rri urtë po kritikon ata që mundohen diç të bëjnë? Keq më vjen për Zotin Sadik që përpiket të barabitë vehten e tij me Nolin, që Noli i ka mësuar abecenë Z.t Sadik, po ay që ka thënë se "Gjismë dija është më keq se marrëzia" nuk ka gënjer. [...] Nuk di po në e ndjen vehten më të zotin nga Noli, Z. Sadik ahere le të marrë mundimin të na japë ndonjë vepër të përktyer nga anglishtja. Po të mos harrojë, jo nga Përrallat e Oscar Wilde-it, por ndonjë vepër nga shkrimet e Shakspear-it, Victor Hugosë ose të ndonjë tjetri shkrimtari të fortë që janë vepra kllasike....

Hito Sadiku përgjigjet menjëherë. Në numrin e radhës të "Dielli" (18 tetor, 1927) në një letër të hapur për Mevalnin, shkruan mes të tjerash:

...Që përpiki të ma mohoni të drejtën e kritikës se nuk kam bërë përkthime si të Fan Nolit, nuk kini aspak të drejtë. Në është se ju kujtoni që kritikët duhet të jene dhe vetë autor, aherë dijeni për gjë të shigurtë se nukë paski as hiç haber se ç'është kritisisma e vërtetë. [...] Hamleti i Shakspear-it s'përkthehet aq lehtë; nuk munt të shqipërohet në vjersherim në gjuhën t'onë të tanishme, siç ka dashur t'a bëjë Fan Noli. Në prozë, mbase, nga ndonjë student i ditur. [...]

Kam arësye që flas kështu; mos kujtoni se dua t'i heth gurë një njeriu që rri në punë të tij. As kurrë. Zotëria juaj, Zoti Mevlani, s'duhet të harroni që dimë dhe ne të këndojmë parathënie librash. Po prapë, në qoftë se kini kuptuar më mirë nga introduktet e Fan Nolit, bënani haber, se jo vetëm unë po dhe disa tjerë janë bërë merak nga që s'i kuptojnë dot gjuhën.

[...]

Më duket se u zgjata shumë dhe prandaj duhet që ta pres shkurtër. Ju thoni: "Me fakte përpara syve unë Nolin e quanj njerin më të zotin dhe mjeshtërin më të mbaruar që ka kombi ynë sot në sheshin e letraturës." Edhe unë do të mbaroj duke nxierë në shesh ca nga këto fakte që juve mbase keni përpara syve:

Hamleti:

Faqe 31: U -sul, u-shtri në shtrat, n'incest pa turp!

Faqe 49: Po, ajo shtazë incestare Dhe adultare

Faqe 51: Të djalëris' e t'obseravtës sime.

Ç'janë këto - "xhevaire" të Fan Nolit? Kësisoj përkthimesh bën "mjeshtri më i mbaruar dhe më i zoti që ka kombi ynë



sot në sheshin e letraturës' - Janë fakte që themi apo janë gënjeshtra?

Tanimë përfshihet dikush tjetër në këtë debat. Ai është Asllan Dragoti i cili i del në mbrojtje Mevalnit. Në "Dielli" (28 tetor, 1927), shkruan:

Po këndojmë me vërejtje një bisedim që është hapur në "Dielli" midis ZZ.ve Smail Mevlau dhe Hito Sadik mbi shkrimet e Fan Nolit. Zoti Hito Sadik i quan shkrimet dhe përkthimeve e Fan Nolit "zero" dhe Zoti Mevlan i quan ato më të mirat shkrime dhe përkthime që ka parë gjer më sot në gjuhën shqipe. Si Zotin Sadik, ashtu edhe Zotin Mevlan i njohim si patriotë të mirë dhe si shokë të dashur dhe s'kemi as pakë dyshim në kthjelltësinë e tyre.

Zoti Hito Sadik i ardhur ketu në Amerikë nga Shqipëria posi njeri që nuk dinte nga ç'anë e hapesh A. B. C.-ja. Duke punuar rëndë nëpër fabrikat, ku bënte rojtjen e tija, mundi nga gazeta "Dielli", nga "Dielli" i Fan Nolit, Chekrezit, Omarit, Loni Kristos, Andon Frashërit të mësojë shqipen, dhe duke vazhduar se vajturi në shkollat e natës të vendit dhe në disa vende private mundi të mësojë anglishten aqë sa zuri të na japë ca shkrime dhe përkthime në "Dielli" për të cilat i shtrëngojmë dorën. Dhe unë për veten time e kam mbrojtur, e kam lëvdur kudo dhe më kë kam biseduar, po Zoti Hito Sadik nuk qëndroj atje dhe të vazhdonte të bënte atë punë. Po dita me ditë zuri të rritet; mori pendën në dorë dhe gërvishti një nga një shkrimet e studentëve tanë këtu, studentë universitetesh dhe jo fabrika pambukësh, dhe si i nuk dolli njeri që t'j a presë hovin tani rrëmbeu shkopin dhe u derdhet me radhë gjithë shkrimtarëve shqipëtarë: Kristo Floqit, Kostë Chekrezit, Loni Kristos, Mehdi Frashërit dhe proçka e proçkave që bën i derdhet këtë radhë edhe Fan Nolit. [...]

Të bashkuar plotësisht në ide të Zotit Mevlani, i lutem Zotit Aqile Tasi, Kryetarit të vyer të Vatrës dhe Redaktorit të Diellit që t'u mbyllë derën një herë e mirë për marrëzira të tilla pseudo-studentëve dhe i thomi me gjithë kthjelltësinë e zemrës Zotit Tasi se duke i dhënë liri Hito Sadikut të goditë shkrimtarët shqiptarë, dhe veçanërisht shkrimet e përkthimet e Fan Nolit dhe nesër Zoti mos e dhëntë të Faik Konitzës, dhe kur gjithë këto proçka ngjasin në shtyllat e vyera të "Diellit", "Dielli" bëhet palaço dhe Zoti Tasi humbet një nga një shokët dhe miqtë e tija...

Mandej është Sotir Katundi ai që në numrin e radhës (18 tetor, 1927) i del përzot Sadikut dhe kërkon lirinë për gjithkënd të japë mendimin e vet:

Zoti Editor,

Në një nga numërat të gazetës "Dielli" këndova që Zoti Ismail Mevlani këshillon Zotin Hito Sadik dhe i thotë që të mos bënë kritikë kundër përkthimeve të Fan Nolit, se, pas mendjes së zotërisë tij, Hitoja na genka çilimi. Në do të thotë Zoti Mevlani se Hitoja është çilimi nga mosha dhe nuk është e drejtë që të bënë kritikë, neve që e kemi njohur Hiton së afërmi i themi Zotit Mevlani që ay do të ketë parë ëndërra dhe nukë di se ç'flet. Në do të thotë se Hitoja është i ri nga mësimet dhe nukë ka haber nga kritikë, ne i themi Zotit Mevlani që Hitoja është aqë plak dhe aqë mjeshtër i mbaruar në kritikë sa përpara Ismailit ay i perqaset Arthur Brisbane-it.

Zoti Mevlani për hirin të tij dhe të çështjes do të bënte shumë mirë që të mos e shtihet me ment se si bëhen kritikë, po të vinte dhe ay vetë të mësonte atje ku ka mësuar Hitoja.

Zoti Hito E. Sadik si fisnik dhe i përparuar që është, kritikën kundra përkthimeve të Nolit e bëri në vent dhe korrekt, dhe kështu si të gjithë kritikanët e mençur, Hitoja na shtroj përpara fakte të gjalla dhe na i la t' i matim, t' i peshojmë, dhe t' i gjykojmë. Kurse Zoti Mevlani na serviu ca budallallëqe që i përqasin një njeriu të nxehur nga padija.


Le t'a dijë nga mua Zoti Mevlani se nuk do të shkojë shumë kohë kur Hitoja do të jetë në pozitë që të shkruanjë dhe të përkthenjë libra shqip aqë të bukura sa fëmija jonë do të jenë të gëzuar t' i këndojnë.

Sa për Fan Nolin që gjoja i digjet zemra Zotit Mevlani, na duket se Ismaili bie prapë në grackë, se një Nacionalisti, dhe veçanerisht një Vatrani të vërtetë, për Nolin duhet të mos i ketë mbetur as një majë gjelpëre simpatie -së. Noli sot për sot jo vetëm nga Shqipëtarët miq dhe armiq të tij (me perjashtimin e ca majmunëve këtu në Amerikë) po dhe nga tërë bota Noli njihet si një aventurier aqë shumë i djallëzuar sa Perëndia na ruajtit.

Pas heshtjes së shkurtër, Hito Sadiku bëhet sërish pjesë e debatit, tanimë më tepër në funksion të qartësimit të asaj pse ky debat filloi dhe ku do të dalë me të:


Kur hapa bisedimin përmi shqipërimin e Hamletit e bëra me gjithë ment i shtyrë nga kjo arsëye: Që munt të haqej nonjë bisedim seriós në mes të këndonjësve të Diellit:-të atyre që këndojnë libra, që meren me letraturë. Fundi i fjalës, një bisedim për të gjithë këndonjësit e Diellit, po nga ca njerës që marin vesh se ç' domethene kritike letrare, dhe kuptojnë mirë dhe likësht. Po, për fat të keq, bisedimi mori një udhë fare të shtrembër, dhe u-karakterizua një çështje krejt personale dhe e trazuar. Mbasë gjithë ky mos kuptim vjen nga që s' kemi kuptuar edhe se ç' do methënë kritikë letrare. Ketú meret vesh se nuke kemi hiç habër per gjera qe lidhen me letraturë. [...]

Unë thashë, dhe them, që Hamleti nuk është përkthyer mirë, s' është përkthyer ashtu siç duhet. Zotëria e tyre flasin për libra të Fan Nolit, dhe mprojnë themën që janë të mira, dhe, fundi i fjalës, në qofshin të liga, prapë mirë. Fan Noli s' duhet të



kritikohet. Mirë. Po ku e kanë gjetur këtë të drejtë? Pastaj, Zoti Asllan Dragoti, si njeri i arrirë që është, e quan si detyrë të tij që të shtierë pakëz dritë permi jetën time të shkuar. Bën të njohur që unë s' kam diplomë universiteti, prandaj njerëzia duhet të kenë mendjen se mos unë proklamohem mbret i letraturës shqipe. Gjëpura. Këtú mar lirinë të shtoj dyfjalë në biografine t' ime që shkrojti Zoti

Dragoti, i cili nuk i di, mbase. Kam lindur nga baba dhe nënë të cilët me folë shqip, dhe jam ritur duke folur shqip. Pastaj, në kohën e mësimut, erdha në Amerikë. Pata fatin e mirë të isha i prëgatitur kurse Zoti Faik Konitza ish Kryetar i 'Vatrës' dhe Drejtor i Diellit për disa vjet me radhë. Kështú, pra, them me lavdi që shkollës së Faik Konitzës -asaj shkollë nga e cila ka marë mësimet dhe Fan Noli vetë-i jam



mirënjohës për jete. Kaqë. S'kam më fjalë me Zotin Asllan Dragoti. Thema e këtij bisedimi është-t' a them dhe një herë-shqipërimi i Hamletit.

Tanimë është një i katërt që bëhet pjesë e bisedës, ndonëse jo lidhur drejtpërdrejtë me çështjen e përkthimit. F. I. Babameto në "Dielli" (4 nëntor, 1927) i kthen një përgjigje Asllan Dragotit dhe idesë së tij për mbylljen e dyerve të "Dielli" njerëzive si Hito Sadiku:

Bukuria me neve Shqiptarët është që në vend të përparojmë dhe t'ecjëm me çape gjigande, në çështje letrash qoftë ose në tjetër-, ecim së-prapthi, si karavidhia. Zoti Dragoti që s' ka zotësinë të pronuncojë dhe të shkruajë drejt emrin e tij që është Arsllan dhe jo Asllan-dhe të Zotit Mevlan që është Ismail dhe jo Smail kujton që kritikë e Zotit Sadik janë proçka, dhe "Dielli" bëhet palaço me këto kritikë, dhe nuk kujton proçkat mbi proçka që ka bërë vetë ne çdo rast tek "Dielli" [...]. Zoti Dragoti dëshiron-dhe me insistencë të madhe të mbyllën shtyllat e "Diellit" për ata q'ay s'dësheron të shkruajnë dhe të jenë të hapura për xhevahiret e Zotrisë tij, sikur "Dielli" është mall' i tij-dhe, s' do të kuptojë që një student i letrave munt t' i gjejë shumë gabime një ustaji të letraturës.

Shefqet Bença, në numrin e radhës të "Dielli" (8 nëntor, 1927) boton një artikull bukur të gjatë, jo veç si përgjigje ndaj Ismail Mevlanit, por bashkë me argumente në mbrojtje të tezës së shkruar nga Sadiku.

...Tani me që ky artikull është shkrojtur përmi zotësin e Fan Nolit si njeri letrash, le t'a hedhim bisedimin në palcën e vërtetë të çështjes. Fan Noli kish dëgjuar se shumica e kryeveprave që ka bota sot janë shkruar kurse shkrimtarët kanë qenë në "exile". Dhe me që dhe këtë e dënoj fati që të jetë në "exile", dhe si njeri letrash mjaft i math, vendosi që t'u jepte bashkëkombasve të tij disa kryevepera prej ajkës së literaurës së botës. Po me që nuk e dinte se sa kohë do të rinte jashtë, vendosi që të pesë përkthimet t' i bënte në një kohë shumë të shkurtër, në një mot. Për njerëzit që kuptojnë se sa të rënda janë letrat, përkthimi i të pesë librave ish fare i pamaundur, po për Fan Nolin vetë, një punë shumë e lehtë. Në një kohë të shkurtër, Fan Noli, me pakë mundime, mundi që t'a masakronte dramën më me rëndësi të letraturës së botës dhe kryeveprën me famë të William Shakespeare-it, Hamletin. Shqipërimi i Hamletit është aqë i vobektë sa po të mos ish shkrojtur emëri i dramës korrekt, njerëzit që meren me dramatistin e dëgjuar ingliz, nukë do ta kuptonin dot. Përmi këtë pikë Z. Hito E. Sadik bëri një kritikë mjaft të matur, tepër të logjikeshme, dhe fare me vent. Dhe ka përkrahës gjith' ata që interesohen me gjithë zemër në çështjen letrare dhe nuk u a ka zënë sytë nonjë cergë e hollë. Zoti Ismail Mevlani, nga ana tjetër, me që i pëlqen të jetë në opozitë, përpigjet që të mprojë të pamundurën: insiston me kryengjeshje se shqipërimi i "Hamletit" të Fan Nolit është shumë i shkëlqyer. Mbase për Zotin Mevlan ashtu është me të vërtetë, po faktet flasin më tepër se sa mprojta që bën zotëria e tij. Z. Hito Sadiku bisedoj me rëndësi një çështje letrare shumë të rëndë, se Fan Nolin, shumica e Shqipëtarëve e kujtojnë për

njeri të math; Z. Ismail Mevlani e bisedon me një mënyre të palidhur hiç, me shkel e shko; dhe e këqyr si nonjë çështje kafeneje të pa rëndesi fare.

[...]

Që Noli nukë ka bërë gjësendi hiç fare, nukë duhet që të bisedohet; gjithë njerëzit që kuptojnë anglisht mirë e kuptojnë këtë gabim. Faktet, Zoti Mevlan, flasin kurdoherë më tepër se fjalët e njerëzve; dhe këtu Noli dënohet prej fakteve. Gjithë përkthimet që Noli ka bërë tani janë zero për njerëzit që kuptojnë: të verbrit le t'i quajnë kryevepra.

Më pas, në "Dielli" (11 nëntor, 1927) vjen përgjigjja e Dragotit, personale me akuzën e Babametos dhe në mbrojtje të qendrimit shprehur më heret. Në asnje pjesë të asaj përgjigjeje nuk gjendet ndonjë gjë lidhur me përkthimin e "Hamletit", prandaj, për sa kohë çështja që ky shkrim trajton është pikërisht ajo, nga ai artikull nuk ka një pjesë që vlen të vendoset.

Të gjithëve që i dalin kundër, në numrin e radhës (15 nëntor, 1927) i përgjigjet Mevlani. Sërish, nuk ka asgjë të re për përkthimin e realizuar nga Noli, vetëm përsëritje dhe akuza, kryesisht në rafsh personal.

I bindur se ky diskutim nuk po merr fund (tanimë, përgjatë dy muajve janë shkëmbyer nëntë shkrime me përsiatje rreth kësaj çështjeje), Hito Sadiku në "Dielli" (18 nëntor, 1927) shkruan *Fjalën e fundit* për këtë çështje:

...Sido në qoftë, mua më duket më interesante që përmirë këtë çështje të dinim mendimin e një njeriu si Profesori Jobson. Zoti Jobson, si një profesor i anglishtes dhe një student i gjuhës s'onë, është në shkallë të flasë me tepër autoritet.


Unë, nga ana ime, do të marr guximin t'i dërgoj Profesorit Jobson një kopje nga Hamleti.

Duket sikur tanimë bie qetësia. Për herë të parë, që nga 7 tetori kur zë fill ky diskutim, dalin disa numra radhazi pa asnjë shkrim lidhur me çështjen e sjelljes në shqip të "Hamletit" nga Fan Noli, ndonëse Babameto sërish shkruan kundër Dragotit në numrin përkujtimor të pesëmbëdhjetë vjetorit të Pavarësisë dhe në numrin e radhës, atë të datës 3 dhjetor, 1927, kundër Ismail Mevlanit.

Shefqet Bença boton sërish në "Dielli" (6 dhjetor, 1927), si përgjigje ndaj akuzave të Mevlanit. Nuk po ndalemi në sulmin personal lidhur me të, pasi nuk kam thënë as çfarë shkruan Mevlani për të, por në çështjen e gjykimit të përkthimit:

...Si një njeri i cili meret me letraturë dhe e harxhon të shumen e kohës së tij duke kënduar kryevepera klasike, jo për të zbavitur dhe shkuar kohën si bëjnë disa të tjerë, po me qëllim shvillonjës, mora pjesë në bisedimin e librave të Fan Nolit. Me artikullin që shkrojta, çfaq mendimin tim të bazuar mi arësye përmirë shqipërimin e vobektë të Hamletit dhe përkthësive të tjera letrare që Fan Noli bëri në një mot e sipër. [...]

Në artikullin e parë thashë, dhe thom përsëri tani, se ay, Noli, si një njeri i cili e ka mësuar gjuhën tonë kurse ish tetëmbëdhjet vjetsh nukë munt dot kurrën e kurrës që të bëjë përkthime me rëndesi. Pastaj, një njeri i cili nukë di rrënjët e



Faksimim nga Fletorja Zyrtare, 1926 ku tregohet vendimi i dënimit me vdekje (në mungesë) të Fan Nolit

fjalëve shqipe, si munt që të jetë në pozitë dhe ti përdorë ato në vendin e duhur? Dhe si provë që Noli nuk e di shqipen, japim gjithë përkthimet e tij që kurse ka hyrë në sheshin e letrave. Njerëzit që këndojnë shqip mirë dhe kuptojnë anglisht aqë sa të zbulojnë gabimet e trasha të Nolit, le t'i barabitojnë përkthimet e Fan Nolit me origjinalet, dhe aherë do të sigurohen se sa themi ne janë në vent. Të pesë librat që mori përsiper të bënte njeriu që ka vetëm shpejtesi gurmazi nuk i përkthen me qellim për të stervitur Shqipëtarët, siç duan të thone disa njerës të verbër, po për të bërë rojtjen mi kurrizin e tyre. Ay vetë e dinte fare mirë se të pese kryeveprat nuk munt qe t'i shqipëronte dot në kohën që caktoj, po ky ish i vetëmi mjet për të bërë rojtjen disa kohëve. Mendimi i Nolit është ky: kurse të vërberit nukë, shohin, pse të mos i gënjes; të shurdhërit nukë dëgjojnë ata që flasin kundër tij: turma përgjithësisht beson se ay është një njeri letrash i vërtetë dhe e duartrokit duke qeshur. Jam i mendjes, dhe besoj se pakë njerës do të më kundërshtojnë, që pesë kryeveprat klasike janë një gjë fare e pamundur që të përkthen në një mot e sipër. Të netshiturit le të vazhdojnë së besuari që janë miast të lehta. Është një turp shumë i math që një njeri fjalësh si Noli të paraqitet përpara posteritetit si një mendonjësi i thellë, dhe të lartësohet prej disa të verbërve në shkallen e një shkrintari të math dhe një heroji të vërtetë. [...]

Tanimë pas dy numrash, në "Dielli" (13 dhjetor, 1927) Asllan Dragoti përgjigjet sërish, por pa u ndaluar fare në përkthimet e Nolit.

mos se i muar; po ata që i kënduan dhe i kuptuan se ç'libra janë, ata janë të pakë.

[...]

Neve si në kohët e para dhe tani më së fundi kudo që kemi gjetur rastin kemi pyetur shumë Shqipëtarë, dhe veçanërisht nga miqt' e Nolit, që në i kanë kënduar dhe ç'kanë kupëtuar nga përkthimet e fundit të Nolit. Një nga ata (S. I.) që pyetëm na tha që me të vërtetë ato libra s'kupëtohen mirë se ç'thonë, po le t'i përkthejë ay juaji më mirë. Tjatri që pyetëm (S. K.) na tha, ç'i do këto librat e Fan Nolit kur s'kupëton dot se ç' duan të thonë! Një tjetër tha, e ç' t'i dua unë këto libra kur unë s' i kupëtoj dot se ç' bëjnë dhe se ç' thonë, pa kur të vdes unë dhe në u-kupëtoshin, mua s' më hyn gjë në qese!

Një numër më pas të "Dielli" (10 janar, 1928) Shefaqet Bença jep një ide të re:

Tani bisedimin për Hamletin duhet që ta paraqesim shkurtër se i lothme gjithë shqiptarët. Jam gati që të vë një bast me juve përmirë Hamletin prej një qint dollarësh me këto kondita: Të zgjedhim një komision prej tre vetash që t'a kqyrin se a ka përkthyer mirë kryeveprën e Shakespeare-it Noli ose jo; dhe në qoftë se fitoni juve kini një rast shumë të mirë që këto të holla t'ja dhuroni shkollës letrare të Nolit si shenjë mirënjohjeje për veprat që u ka dhënë.

Shkrimi vijon edhe në numrin tjetër të "Diellit" (13 janar, 1928), tanimë si sulm i Bençës për mënyrën se si Mevlani e shkruan dhe e përdor gjuhën shqipe.

E gjithë kjo merr fund në Diellin e datës 24 janar, 1928 ku Ismail Mevlani, sërish i përgjigjet gjithë kritikëve të tij, jo për përkthimin e realizuar nga Noli, por për akuzat që ngrihen mbi të. Atij askush nuk i përgjigjet më dhe ky debat mbyllet.

Fan Noli nuk merr pjesë asnjëherë në këtë diskutim e bashkë me të, as mbështetësit e tij të njohur. Kjo më shtyn të shtroj dy hipoteza, që ndërthuren njëra me tjetrën. E para, në vitin 1926, pra kur u botua "Hamleti", u dha vendimi me vdekje për të në mungesë, vendim që vitin e ardhshëm do të kthehet në dënim me pesëmbëdhjetë vjet burg. Prandaj ai, në emigrim, udhëtonte sa në një vend, në tjetrin, pasi akoma nuk ishte vendosur përfundimisht në Amerikë. Dhe së dyti, marrëdhënia e tij me shqiptarët e "Vatrës" ishte vërtetë shumë e paqëndrueshme, ndaj edhe mundësia e botimit të një përgjigjeje në "Dielli", organ shtypi i "Vatrës" ishte thuajse i pamundur.

Ndonëse Revolucioni i Qershorit ishte mbajtur në 1924, në 1927 shohim se tentativa për një tjetër revolucion të ngjashëm nuk mungojnë. Ai kudo në Evropë mblidhte gazetarë dhe thoshte se nën rregjimin e Ahmet Zogut ishte e pamundur të jetohej ("Dielli", 19 prill, 1927).

Besoj se debati mbi përkthimin është gjithmonë i vlefshëm e në të njëjtën kohë, diskutimi mbi gjuhën shqipe e cila, sikurse çdo gjuhë, ashtu si thotë atë Justin Rrota, "shkon tue bamë ato ndryshimet e veta".

Ata po ata që i paguan ato libra do-e-

Ismail Kadare e ka shkruar “Darkën e gabuar” me shijen e pagabueshme të kryeveprës. Vështirë të sjellësh ndërmend ndonjë roman me vëllim kaq imcak, ku epika lokale historike dhe ajo mitike, në një rrëfim që estetizohet në nivelin më mjeshtëror, të fitojë kaq vlera të përbotshme. Nuk po shprehem me klishe se është roman që lexohet me një frymë, që ta mban frymën pezull apo të lë pa frymë. Them vetëm se është nga ata libra që, në të gjitha kohërat, njeriu i qytetëruar ndihet me fat që s’i kanë shpëtuar pa i lexuar.

Me gishtat e duarve numërohen titujt letrarë, ku ndihet sa i madh ka qenë ashku i autorit, vrulli, droja dhe njëkohësisht ngazëllimi prej aleluje, duke mpiksur në letër tërë atë mjegullnajë të rrokopujshme të parakrijimit. Në veprat serioze, në ato që përsosmërinë e çojnë deri në ngopje, nuk është nevoja që çdo gjë të jetë e justifikuar, por që asgjë të mos jetë pa vend. E po ashtu, asnjë shkrimtar serioz nuk e mban veten për Mesi, por mesazhet transhendente janë shpesh mesianike. I shkruar në liri të plotë dhe me përmasë planetare, ky libër i shëndetshëm ngjan si një fillim prej së pari ose si vazhdim nga majat, duk shënuar midis kulmeve të Kadaresë, nga vështrimi estetik, njëherë prej kuotave më të lartë. Një shkrimtar, sipas meje, nuk ka ku shkon më tej, më tej është gremina dhe më lart është Zoti.

2.

Nga çfarë asociacionesh përfshihen, nga çfarë përhitjesh të andejshme (andej ku hapësira s’ka kufij), apo e thënë më preکشëm, a shohin ëndrra shkrimtarët përpara se të shkruajnë një kryevepër?

Duket sikur në një natë të lumnueshme, teksa autori flinte, dy fantazma kanë vajtur ndanë shtratit të tij. E dyta, mbështjellë me mjegull, është i Verbëri që nuk sheh çfarë bëhet, por megjithatë e di se çfarë do të ndodhë. Fantazma tjetër është përkulur te shtrati dhe atij që fle, po i shpraz një ëndërr në tru. (Ai që krijoi “Pallatin e Ëndrrave” është njëlloj i pambrojtur si nga shpërblimi, ashtu dhr nga hakmarrja e vizioneve të tij.) Më pas, ka gjasa që i përgjumuri është ngritur dhe ka nisur të shkruajë dehshëm, pa e kuptuar nëse kishte parë në ëndërr Homerin dhe Shekspirin, apo ishin vetë tragjikët e mëdhenj që, jo në muret e Trojës dhe as të El Sinorit, por në një kështjellë të vjetër shqiptare u qe shfaqur në tym një i ngjashëm, vëllam i bojëshkrimit, njëfarë Ismail Kadare, princi i letrave moderne. Ndryshe nuk ka se si, në vijim, autori t’i vdesë ashtu të gjallët dhe t’i ngjallë ashtu të vdekurit. Dhe ndërsa sharmin shekspirian e mban krejt për vete, atë homerik e ndan me një bard, Vehip Qorrin. Sepse Vehipi pa sy nuk ka parë kurrë të gjallë, nuk ka parë kurrë të vdekur, e prapëseprapë di atë që të tjerët nuk e dinë.

Dikush mund të pyesë me supet ngritur për homerizmin, ku është homerizmi i autorit? Por si mund të hiqemi të stepur kur në mjaft libra të tij, Kadareja ka arritur të shohë atë që është e nënqiellshme dhe atë që është e mbiqiellshme, domethënë, përtej syve të ballit?! A s’jemi ne që, me dashje të mirë apo me dashje të ligë, prej shumë e shumë vjetësh ia kemi identifikuar edhe shenjën e jashtme?! Dikur ishte nomenklatura e lartë komuniste që pikërisht këtë shkrimtar, ndaj të cilit përdorte herë karotën e herë kërbacën, herë kërcënonte e herë servilosej, me një ngrefosje horrash e thërriste prapa kraheve “Qorri”, siç e thërrasin me këtë nofkë ende disa. Kush ka dashur të vërë vetulla, siç i thonë fjalës, ka nxjerrë sytë. Veçse jo ata që kemi jashtë, por syrin e përbrendshëm.

Pikërisht me këtë sy të mendjes, më depërtuesin e më largpamësin, te “Darka e gabuar” autori e ka parë sërish vendin e tij si pjesë të botës, dhe botën si marrëdhënie me vendin e tij. Por kësaj here e ka ringjallur së vdekurish plotësisht atë të tretin, syrin homerik.

Kryevepra e pagabueshme në “Darkën e gabuar”

Nga Zija Çela


3.

Ismail Kadare është mjeshtër i romanit shumëplanësh, çfarë e ka dëshmuar me kohë. Kurse në këtë masë të tkurrur teksti, asgjëkundi nuk ka punuar me kaq shumë fije njëherësh, për t’i ndërthurur pastaj si tela të zhveshur, plot kontakte e zjarrme. E megjithatë ia ka dalë t’i shtrijë përgjatë romanit si një kablllo solide, duke qenë vetë autori gjeneratori i rrymës dhe vetë njëkohësisht subjekti i shkarkesave të para. Në vetmi mjeshtër e mëdhenj durojnë pa u ndier atë, që të vegjëlit i lemeris pa e provuar dhe që, paskëtaj, nxitojnë ta sajojnë për publikun. Kur flas për shumë fije, nënkuptoj edhe shumë hapësirë, edhe shumë personazhe në një konflikt ndërkontinental: Lufta e Dytë Botërore dhe më pas komploti botëror, vrasja e shefave të komunizmit kudo që ndodhen, duke nisur nga Stalini e duke grirë edhe shefin

tonë: “Ndërsa zhurma për atë që quhej si më i madhi përbetim i shekullit ishte botërore, hetimi vazhdonte në gati një të tretën e planetit. Ai zhvillohej në të njëmbëdhjetë shtetet komuniste, në njëzet e shtatë gjuhë, tridhjetë e nëntë dialekte, pa përmendur nëndialektet. Rreth katërqind mjekë të mbyllur në po aq biruca ndodheshin në hetim të pandërprerë. Në asnjë prej birucave nuk merrej vesh ajo që ndodhte përjashta, ashtu si jashtë s’dihej asgjë për birucat. Guva e Shanishasë nuk ishte veçse njëra prej tyre.”

Por një i ka mjaftuar shkrimtarit, një kanxhë për ta vërtitur globin dhe për ta projektuar epokën. E kanxha do të këpëtej po të ishte prej çeliku (një materie e rëndomtë për letërsinë), por mban sepse ka substancë idealiste, siç është ajo e darkës së gabuar.

Teoria e beng-bangut, siç kam pasur rast të shprehem, nuk i qaset artit drejtpërdrejt,




por as më duket krejt e përjashtuar për përfytyrimin krijues. Në një pikë të globit, në Gjirokastër, ndodh një shpërthim dhe prej asaj nebuloze Kadareja përfshin në shtjellë gati tërë rruzullin. Ngjarja reale, ajo që dëshmohej historikisht për një darkë, nuk është veçse pikënisje. Përfytyroni që, në rastin më të mirë, në një vendbanim të vogël jepet një avion. Por çfarë mund të bëhet me të, nëse nuk ka aeroport për t’u ngritur dhe qiell për të fluturuar?! Avioni s’do të ishte më tepër sesa një qerre pa rrota. Nuk po them se në atë kohë Gjirokastra ishte një qytet krejt i humbur për pjesën tjetër të njerëzimit, them se ishte një qytet me frymë kozmopolite e ku gjithçka mund të gjendej nga pak. Por me rëndësën izoluese të mosnjohjes, së cilës i shtohet edhe rëndesa e përjetshme që ushtrohet nga provincializmi global, me peshën e llahtarshme të kështjellës, të shtëpive prej guri që ngrihen mbi gur, madje edhe të rrugëve me plloça guri, do të mbetej i ngultë në dheun e vet, i palëvizshëm dhe i patundshëm si Sfinks anonim. Për ta ngritur peshë dhe për ta mbajtur në shpatulla, për ta bërë të dukshëm për sytë e botës, veçmas për metropolet e botës, duhej një Atlas i letrave.

4.

Tema e luftës, raportet me armikun, rinjohja dhe afrimi mes palëve, ka tërhequr mjaft shkrimtarë. Veçanërisht kineastët e kanë për zemër dhe e kanë trajtuar prej vitesh në filmat e tyre. Por nëse këto raporte mbështeten zakonisht në arsyet humane, në librin e Kadaresë zbresin thellë te rrënjët, arrijnë deri te mitet dhe të vdekurit, tek arsyet e ekzistencës së shoqërisë njerëzore.

Tamam në darkën mes palëve, prej ku do të dalin dhe linjat e tjera, fillon të nyjëtohet konflikti romanor. Doktor Gurameto i madh, bash në ditën kur pararoja gjermane hyn në Gjirokastër, fton në druvezë ish-shokun e shkollës, kolonelin Fritz von Schwabe, tashmë komandant regjimenti tankesh, me katër plagë, mbajtës i Kryqit të Hekurt. Një gjerman që e ka njohur nga afër dhe e ka dashur këtë shqiptar, që është mahnitur nga rrëfimet e mikut dhe të udhëtarëve të huaj, që vjen me vizionin e besës, mikpritjes, dokeve tradicionale të shqiptarëve, me tërë ekzotikën romantike, por që është goditur teksa hynte në qytet, është “prerë në besë” dhe, gjatë darkës me muzikë e shampanjë te mikthirrësi, kërkon që gjaku të shpaguehet shumëfish sipas kanunit të Lekë Dukagjinit dhe ligjit teuton. Ja përse, në ato orë të gjata të ballafaqimit trysnues, të duket sikur shampanja pihet duke kafshuar edhe gastaren e gotave. Në përgjithësi, ky roman është si një sahat me ingranazhe të bashkëlidhura dhe çdo lëkundje e kurdis zemberekun edhe për avancën. Por në skenën e darkës ka aq shumë ngjeshje energjie, sa prej tensionit të vjen disi ndër mend ngjeshja atomike. I gjithë teatri i luftës së përbotshme sikur kondensohet te dy personazhe që, për një metaforë shkapërcyese, mund të quhen edhe Akili e Patrokli. Por, siç ngjet në epokën moderne,

(Vijon në faqen 7)



Tragjedia me titull *Abeli* e Etëhem Haxhiademit është antologjike në kuadër të dramës shqipe në përgjithësi. Intertekstualiteti, arkitekstualiteti, ndërtimi i kompozicionit dramatik, i karaktereve dramatike, përdorimi i gjuhës e kështu me radhë, janë vetëm disa prej veçorive të kësaj vepre.

Sa i përket intertekstualitetit, duhet të theksojmë se miti biblik i vëllavrasjes është tejet i lashtë. Atë e hasim qysh në *Dhjatën e vjetër*, gjegjësisht në kaptinën e katërt të librit të parë, *Librit të gjenezës*, që ka të bëjë me bijtë e Adamit, pra Kainin dhe Abelin. Pikërisht mbi këtë bazë Haxhiademi harton tragjedinë e tij. Madje, këtë e pohon edhe në parathënien e librit, në të cilën njëherë fut subjektin e shkurtër biblik dhe më pas shton: “Ja kjo asht landa e përkthye fjalë për fjalë nga bibla dhe te këto rradhë të pakta u zhvilluë kjo tragjedi”.¹ Andaj, tragjedia *Abeli* ka edhe karakteristika intertekstuale, me ç’rast merret teksti biblik dhe rikrijohet në një mënyrë të veçantë. Ndërkaq, në aspektin krahasues në mes mitit biblik dhe tragjedisë së

1 Etëhem Haxhiademi: *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë, 2000, fq. 156. (vargjet e cituara në vijim do të merren nga i njëjti botim)

Haxhiademit mund të vihet në pah edhe arkitekstualiteti, sepse kemi të bëjmë me një transformim zhanror. Në këtë

kontekst ndalemi në aspektin strukturor, me ç’rast te teksti biblik hetohet një narracion i pastër (diegesis), ndërkaq tragjedia e Haxhiademit ndërtohet mbi bazën e veprimit (mimesis), siç e kërkon edhe zhanri dramatik në përgjithësi. Po ashtu, te *Abeli* kemi të bëjmë edhe me shpërfaqjen e botëkuptimeve të personazheve, dialogë, monologë, didaskali e kështu me radhë që janë krejt specifikë nëse shihen në krahasim me tekstin burimor.

Haxhiademi boton tragjedinë *Abeli* më 1938 për herë të parë. Po e përmendim këtë fakt, sepse miti biblik që trajton vepra ka funksion social dhe politik nëse shihet në relacion me Shqipërinë e asaj periudhe që ishte krejtësisht e destabilizuar, me ç’rast vrasjet mes shqiptarëve ishin mjaft të shpeshta.

Sidoqoftë, përveç dimensionit politik që mund të jetë hipotetik, Haxhiademi në kuadër të *Abelit* trajton një çështje sociale-familjare me një rëndësi të veçantë: pra raporti i prindërve me fëmijët. Kjo tematikë i jep dramës, ndër tjerash, edhe karakteristika didaktike. Madje dhe studiuesi Sabri Hamiti tragjedinë *Abeli* të Haxhiademit e konsideron si veprën me shtrirjen më të madhe moralizuese.² Mitit biblik që ndërtohet mbi bazën religjioze, Haxhiademi i jep karakter social-aktual, duke e zhveshur kështu paksa nga religjioziteti. Kjo lëndë që ka të bëjë me zanafillën e njerëzimit, te *Abeli* trajtohet në mënyrë më komplekse sesa në Bibël. Sepse, siç dihet, në tekstin biblik determinimi tragjik vjen drejtpërdrejt nga Zoti, për shkak se ai nuk ia pranon frutat Kainit, ndërsa qengjin e Abelit po. Më pas, nga zilia, Kaini vret vëllain. Haxhiademi këtë subjekt e ndryshon në një masë, andaj në vazhdim, ndër tjerash, do ta trajtomë më gjerësisht këtë karakteristikë.


Veprat dramatike të Etëhem Haxhiademit konsiderohen neoklasike për nga natyra – njëjtë edhe tragjedia *Abeli*. “E reja” e dramës së tij mund të konsiderohet gjuha, karakterizimi i personazheve, konteksti, ndërkaq “e vjetra” qëndron në ndërtimin kompozicional duke i qëndruar besnik poetikës antike, pastaj rimarrja e përmbajtjeve klasike e kështu me radhë.

Etëhem Haxhiademin mund ta shquajmë si mjeshtër të tragjedisë, andaj edhe te *Abeli* e shohim se me sa

2 Sabri Hamiti: *Letërsia moderne; Vepra letrare 8*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, fq. 564.

Neoklasicismi në tragjedinë “Abeli” të Etëhem Haxhiademit

Nga Fatlum Mehulli



mjeshtëri i zhvillon ngjarjet duke iu përgjigjur formulës klasike të ndërtimit të këtij zhanri dramatik. Tragjedia *Abeli* është klasike qoftë për nga kompozicioni i jashtëm, qoftë për nga kompozicioni i brendshëm.

Për nga kompozicioni i jashtëm, *Abeli* ndërtohet nga pesë akte të cilat përbëhen me nga tri skena të ndryshme. Ndërkaq, modelin kompozicional të brendshëm në vijim do ta ilustrojmë edhe me shembuj (gjithnjë duke iu referuar tragjedisë së Haxhiademit dhe jo tekstit biblik).

Modeli i brendshëm kompozicional i tragjedisë *Abeli* i përgjigjet modelit klasik aristotelian. Shohim që ekspozu ndërlidhet me pjesën kur nis diferencimi i vëllezërve, gjegjësisht Kainit dhe Abelit nga ana e prindërve, pra Adamit dhe Evës, të cilët janë të vetëdijshëm për një anim të tillë. Kjo më së miri vërtetohet përmes këtyre vargjeve, kur Adami i drejtohet Evës:


*Ndëgjo, o Ev', nga çunat t'on' të dy,
Abeli muë ma shumë më hyn' në sy.
Dhe ti atë ma tepër përgëdhel
E goj' e jote thot' gjithnji Abel.* (fq.160.)

Pastaj, thurja e veprimeve ka të bëjë me mërinë e Kainit, i cili për një diferencim të tillë kërkon llogari, qoftë nga prindërit, qoftë nga vet Abeli, me ç’rast u shtron pyetje të shumta prindërve, me theks, pse ata e çmojnë Abelin më shumë se atë? Megjithëse, nuk merr përgjigje konkrete në fillim. Thurja e veprimeve, ndër tjerash, ka të bëjë edhe me dhuratat që djemtë u bëjnë prindërve. Pemët e Kainit, Adami dhe Eva nuk i pranojnë, ndërkaq flinë e Abelit e mirëpresin me gjithë zemër, madje edhe i thurin urata të shumta dhuruesit. Ky është ndryshimi i mitit biblik që e përmendëm më lart. Teksa te kapitulli biblik dhuratat i drejtohen Zotit, në kuadër të tragjedisë së Haxhiademit, dhuratat u drejtohen prindërve, sepse synohet që fokusi të bie mbi kontekstin social para se atij religjioz.

E gjithë kjo ndikon në tërbimin e mëtejshëm të Kainit, duke e çuar kompozicionin drejt kulminacionit, i cili ka të bëjë me aktin e vëllavrasjes – pra Kaini vret Abelin. Këtu shënohet edhe fundi, gjegjësisht shthurja, me ç’rast me vrasjen e Abelit konkretizohet akti i shëmtuar, andaj edhe përfundohet me mallkimin që Adami e Eva i bëjnë Kainit dhe gjithë pasardhësve të tij.

Sa i përket personazheve, tragjedia *Abeli*, sikundër edhe miti biblik, ndërtohet prej katër personazhesh që njëkohësisht shenjojnë bashkësinë e parë familjare, nëse shihet në kontekstin religjioz. Pra, kemi të bëjmë me Adamin, Evën, Kainin dhe Abelin.

Adami dhe Eva përveç në hyrje, gjegjësisht në skenën e parë të aktit të parë, gjatë rrjedhës së tragjedisë, janë të ngjashëm në veprimet dhe botëkuptimet e tyre. Simpatia për Abelin është e pranishme gjithnjë, për të cilën ata



gjejnë arsyetime të njëpasnjëshme. Por, mbi të gjitha ato që i dallojnë ndjeshëm dy vëllezërit, nga perspektiva e Evës, janë sjellja, kujdesi ndaj prindërve dhe zemërgjerësia, arsye këto që pohohen/miratoohen edhe nga Adami. Kjo dashuri asimetricke bëhet shkas kryesor për fundin tragjik. Madje, Adami dhe Eva janë të vetëdijshëm që një dukuri e tillë do të çojë drejt një zemërimi ndërvëllazëror, me ç'rast fundi medoemos do të jetë i hidhur. Në çastet kur Adami me Evën vendosin që tash e tutje Kainin ta përkëdhelin dhe ta lavdërojnë, ngjarja tragjike veçse kishte ndodhur.

Kaini, si fëmija/djali i parë i familjes, ka një barrë të dyfishtë. Përveçse duhet të përkujdeset për prindërit, ai duhet t'i rrijë gati edhe vëllait të vogël, Abelit. Andaj, nëse bëjmë një analizë psikologjike të karakterit, mund të konkludojmë që jeta e vështirë, me punë të rënda në vazhdimësi e kështu me radhë, ndikojnë ndjeshëm në psiken e individit. Njëjtë ndodh edhe me Kainin. Kur ai ndodhej në një gjendje të tillë mendore, prindërit ia shtojnë vuajtjet duke mos e inkurajuar me fjalë të mira e përkëdhelje.

Sidoqoftë, përtej kësaj, Kaini gjithsesi se ka tiparet e ziliqarit, smirëziut e egoistit. Është interesante se si karakteri i Kainit pëson ndryshim prej shfaqjes së tij e deri në fund të tragjedisë. Fillimisht, ai u drejtohet prindërve me fjalë të më të ëmbla si: *nënë e dashtun, at me vlerë* e kështu me radhë, por në vazhdimësi, armiqësia përveç ndaj Abelit u referohet edhe prindërve. Madje, kjo vërtetohet në fund kur Kaini i thotë Abelit se në këtë botë është i pavarur dhe nuk ka nevojë aspak për dashurinë e prindërve: *Dhe po t'më dojë muë nana e im at'/Nuk do t'më bahet jeta ma e gjat'/I vetëm jam e vetëm do të rroj...* (fq. 200.)

Në anën tjetër kemi personazhin e Abelit, karakteri i të cilit merr tiparet e njeriut pa të meta. Faji tragjik i tij nuk është i brendshëm, sepse Abeli nuk jep asnjë shenjë për të merituar një fat të tillë. Andaj, ky faj vjen si pasojë e faktorëve të jashtëm, gjegjësisht prindërve, të cilët ndaj Kainit shfaqin hapur antipati. Abeli është i vetëdijshëm për këtë dhe në njëfarë mënyre qorton prindërit për një vlerësim të tillë. Po japim një dialog të shkurtër mes Abelit, Evës e Adamit që na e vërteton këtë:

ABELI

*Nuk asht Kaini kshtu si e gjykoni;
Ju çdo gabim të vogël ja madhoni.*

*Ay më do muë tepër porsi vlla,
Dhe dashunin me prova ja kam pa.
Por dhe të ftohët zemrën po t'a ketë
Për muë, fajin e madh e keni vetë.*

EVA

Çfar the? Edhe ky faj po ne na ngel?

ADAMI

Pse na ngarkon me faj ti ne, Abel?

ABELI

*Ndoshta ju prisha zemrën me këtë fjalë,
Prandaj ju lutem tepër me ma falë.*

*Kainin me sy t'keq ju e shikoni,
Se fort ma pak nga unë atë e doni.
T'a doni ju atë në rradh' të par'*

Edhe ay muë s'do t'më ket' nakar. (fq. 194-195.)

Nga e gjithë kjo, shihet që Abeli si pasojë e këtij vlerësimi të pabarabartë parandien një të keqe që mund të vjen nga Kaini.

Nëse ndalemi te veprimet dhe botëkuptimet e tyre, atëherë Kaini merr tipare të materialistit, i cili preokupohet vetëm për jetën tokësore: do që gjërat e mira t'i ruajë për vete, t'i shmangët punës, të lavdërohet nga prindërit e kështu me radhë, ndërsa në anën tjetër Abeli i ri ka mendësinë e idealistit, i cili gjithnjë e

mendon botën e përtëjme, frikohet se mos po bën mëkat, mbron të vëllain verbërisht, madje del mbi fjalët e prindërve sa i përket kësaj çështjeje.

Një karakteristikë e veçantë është edhe diferenca në moshë mes dy vëllezërve, gjë që e përcakton edhe dukjen e tyre. Kaini është më i vjetër dhe përshkruhet si djalë i fuqishëm me trup të madh e muskuloz. Ndërkaq, Abeli shfaqet si djalë i ri me krah të njomë. Kjo nënkupton edhe dominimin e të madhit ndaj të voglit, gjegjësisht pushtuesit dhe të mjerit. Është rrëqethëse pjesa kur Abeli i ri i lutet Kainit që t'ia falë jetën duke iu përlulur para këmbëve. Pastërtia shpirtërore e Abelit te kjo pjesë shkon aq larg sa që i kërkon Kainit që para aktit të vrasjes t'i jap pakëz kohë që t'i lutet Zotit që t'ia falë mëkatet vëllait të tij – kjo gjë e acaronte edhe më tej Kainin. Fuqia trupore dhe mosha përcaktojnë edhe punën e tyre, me ç'rast Kaini bën një punë më të rëndë, pra është bujk, ndërkaq Abeli riosh është bari.

Haxhiademi aktin e vrasjes së Abelit e lë të nënkuptohet, me ç'rast nuk jepet skena e qartë. Megjithatë, para këtij akti jepet një skenë tejet rrëqethëse që ka të bëjë me përshëndetjen e fundit të Abelit me prindërit e tij. Duke ditur kërcënimin me vdekje nga vëllai, ai kërkon nga i ati të dijë më shumë rreth këtij fenomeni. Ndonëse Adami e Eva në fillim habiten nga këto pyetje të çuditshme, i dëftojnë se sa e tmerrshme dhe e dhimbshme është vdekja. Abeli pas kësaj, edhe pse frikohet shumë, nuk tërhiqet mbrapa. Pra, nuk u tregon atyre për kërcënimin, madje mbron Kainin dhe në fund niset drejt vdekjes me vetëdije.

Sa i përket hapësirës, Haxhiademi në fillim na njofton që ngjarjet zhvillohen në një pyll të Ceilanit, ndërkaq kategoria temporale prej fillimit e deri në fund është e paidentifikuar sikundër që është në mitin biblik. Por, te kjo pjesë, si modelim i brendshëm temporal mund të përmendim se fokusi bie mbi një episod të veçantë të jetës së kësaj familjeje. Akti tragjik ndodh kur Adami dhe Eva janë të dëshuar dhe të pa aftë për punë; Kaini i dërrmuar nga puna shumë vjeçare dhe Abeli i ri që bënte një punë më të lehtë në përputhje me moshën. Megjithatë, kohën dhe hapësirën Haxhiademi nuk i ndryshon nga miti biblik, sepse do që fokusi të bie mbi personazhet dhe veprimet e tyre si dhe t'ia ruajë tragjedisë karakterin universal.

Tragjedia *Abeli* ka një mesazh të qartë, përmes së cilit synohet ngritja e vetëdijes së familjeve shqiptare në veçanti. Bazuar mbi shkrimin e shenjtë, Haxhiademi në njëfarë mënyre u bën thirrje prindërve që mes fëmijëve mos të bëhen dallime sepse kjo gjë ngjall zilinë dhe smirën, të cilat çojnë drejt shkatërrimit të një familjeje. Andaj mund të themi që kjo vepër ka edhe karakter moralizues e didaktik.

Si përfundim, mund të shtojmë që, Haxhiademi tragjedinë *Abeli* e ndërton siç e kërkon tragjedia klasike, përmes një gjuhe krejt të veçantë dhe poetike, me ç'rast vargjet e saj i përgjigjen një rime të puthur të skemës AABB që veprës i japin një ritëm të shpejtë dhe një dramacitet tejet të madh.

Literatura

ARISTOTELI: *Poetika*, Enti i botimeve të teksteve i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1968;

ELSIE, Robert: *Histori e letërsisë shqiptare*, Sh.B. "Dukagjini", Pejë, 2001;

HAMITI, Sabri: *Letërsia moderne; Vepra letrare 8*, Faik Konica, Prishtinë, 2002;

HAXHIADEMI, Etëhem: *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë, 2000.

(Vijon nga faqja 5)

Akili ka pak nga Patrokli dhe Patrokli pak nga Akili. Jo rastësisht do të dalin të dy të dyzuar, njëri apokrif nën pelerinën e Klaus Hemf-it, tjetri në shëmbëllesën e binjakut iluziv, doktor Gurametos së vogël. Zot na ruaj, çfarë rrebeshesh do të lëshohen mbi kokat e tyre dhe prej tyre. Në këtë konflikt vetëm sa përmenden disa shefa shtetesh, sepse protagonistët janë njerëz të zakonshëm. Mirëpo, megjithatë, shohim si bien shtete, ndërrojnë epokë, ndodhin gjëma të mëdha, krusma sodomike kolektive dhe vetjake, ca tmerre mbi tmerre që na kapërcejnë të gjithëve. Dhe kjo ndodh sepse bërtama të tilla misterioze, si tharmi i këtij libri, mbijetojnë. Një roman ku të ngjan se bota është aq e vjetër, me njerëzit, me ndjesitë, me luftërat, me doktrinat, me sistemet, me rrotullamat e fatit, me kohën plus e minus, deri dhe me veglat e torturës, aq sa moderniteti nuk qenkësh veçse një shtresë nape e mbishkruar, që i shtohet palimsestit të historisë. E kështu, lexuesi përjeton një pjesë të përjetësisë. E përjeton për hir të meritave të bekuara, në rastet kur shkrimtari ngrihet në nivelet më të epërme. Ismail Kadareja i është larguar së jashtmes, së zhurmshmes, betejës me murtaja e mitrolozë, për të kaluar në përballjen vigane të metafizikës, atë më të shurdhtën por dhe më afatgjatën. Personazhet kryesore të tij, aq të prekshme, aq të besueshme, prej kockash e mishi njerëzor, vijjnë njëkohësisht si konvenca, shkrimtari i ka shndërruar në *soma pneumatikon*, në trupa frymorë ose shpirtërorë, shkurt, u ka dhënë lëndë të paasgjësueshme.

5.

"Darka e gabuar" ta çon mendjen vetiu te "Kronikë në gur", prandaj mund të quhet si kronika e dytë gjirokastrite. Por kjo e dyta është krejt në tunxh, tunxhi i mbledhur i botës, ta jep në kokë dhe fillimisht sikur të mbyt. Ndonëse i maturuar rresht për rresht dhe trillan deri në shkallim, ky roman ia kalon edhe sinqeritetit të Kronikës së mëparshme, sepse këtu kronika fiton tjetër peshë, ajo hapet, ndrydhet, kalon prapë në gjithëpërfshirje dhe, duke u bërë mizore në bukuri, as nuk fsheh dhe as kursen askënd, madje as vetë Kadarenjtë, ndaj të cilëve ka aludime inteligjente, por edhe referenca të pamëshirshme. Nga akuarelet e paharrueshme të "Kronikës në gur", te "Darka e gabuar" kalohet në pëlhurën e madhe ku punohet me skatull dhe bojëra të rënda, plot me vaj të hyjnueshëm, si te "Darka e fundit" e Leonardo Da Vinçit. Gjatë gjithë rrëfimit, pa e kuptuar mirë se nga vjen, ekziston një burim drite gati-gati e padurueshme për sytë, prandaj kalon përbrenda, atje ku ndriçohen humbellat e nënvetëdijes, siç përndriten herë-herë thellësitë nënujore. Po ta lexosh me vëmendje dhe duke u dhënë pas tekstit, bëhesh preja e rrezatimeve të tij, në çaste të tilla të vjen të buzëqeshësh, të vësh gishtin në tëmth dhe, falna Zot, të përlotesh ose të çmendesh. Për ndryshe, të shërosh duke u rikthyer të tre librave bashkë, krejt triptikut, sepse dy kronikat kanë në mes një gravurë, të ashtuquajturën "Çështje të marrëzisë". S'është tjetër veçse Sokaku i të marrëve, vetëtimja e shkurtër e gjenit që, si çdo vetëtimë që nuk zgjat, prapësepapë e ndan mëdysh qiellin e vet. Kur ke diçka për të thënë, sado kompleks konceptimi, thjeshtësia elegante e shprehjes ndihmon për t'i theksuar relievet e mendimit, ndërsa çdo sforcim i gjuhës i fsheh, e bën frazën të nxjerrë tym. Në "Darkën e gabuar" teksti ka midis rreshtave intertekstin, por vetë gjuha asgjë nuk fsheh. Madje ato shkronjat prej plumbi, siç ka mbetur tipografia në përfytyrimin tradicional, nëpërmjet njëfarë galvanizimi alkimist të gjuhës, Kadareja sikur i vesh me një shtresë floriri dhe fjala e moçme që rimerret, dhe fjala e re që krijohet, njëlloj shkëlqejnë në unison.

6.

Në vepra si "Darka e gabuar" mund të ndodhë që edhe autori të gabohet përkohësisht, në kuptimin se nuk bëhet shpejt i vetëdijshëm për shkallën e vlerës që ka krijuar. Edhe pse "i vogëlith" për nga volumi, duket se në vetëdijen dhe nënvetëdijen e autorit ky roman ka pasur shtrat të madh dhe, mbasi e ka nxjerrë nga dora, ende nën trysninë e shtratit është ndier disi pezull, madje për ca kohë gati si në boshllëk. Por pastaj s'i ka mbetur tjetër, veçse puna e mjeshtrit të diamanteve, i cili vë monoklin dhe distancën e krijon me një lëvizje mekanike, pra e largon nga vetja diamantin për të zbuluar më mirë prerjet që ka bërë. Nëse ka prerë keq, mos u mashtroni nga duart, duart e mjeshtërve asnjëherë nuk përgjaken. Por diku përbrenda, në kodrën e mushkërisë, skuq një blanë gjaku plot me thepa. Letërsia serioze nuk shkruhet kurrë pa gjakim. Dhe këtu nuk vlen modestia, modestia e përdorur si monedhë për t'u shitur plurimoralist para turmave është qesharake për shkrimtarin. Sepse, në të njëjtën kohë, gjithashtu askush nuk e di gjyqin që autori i bën vetes. Pikërisht ai, tirani i penës krenare, duket se nganjëherë aq poshtë e ul kokën, sa ngjan sikur e ka braktisur shpirti dhe atëherë vetëm Zoti e di çfarë rropamash dëgjohen brenda tij, shemben qemere, blloqe e galeri si në një minierë të braktisur, derisa fuqia e kreativitetit vendos ekuilibret e dhura dhe e rikthen në punën e re.

Është vështirë të lirohesh nga vepra e shkruar. Por për shkrimtarin ky (ç)lirim bëhet i domosdoshëm. Në këtë rast Kadareja e ka mundur veten. Për "Darkën e gabuar" ka siguruar pavarësi të plotë, romani ka lindur në një habitat të sterilizuar nga efektet e veprave paraardhëse të autorit. Një roman i frikshëm e madhështor, që sikur flet njëkohësisht në disa gjuhë, por gjithandej me një tis të pandashëm albanologjik. Kadareja shkarkon këtu tërë fuqinë dhe arsenalin më modern të artit të tij. E tregohet i çlodhur dhe i vetëpërtërirë, i vetëmjaftueshëm dhe rinovues. Me një fjalë, shfaqet si autor i supermacisë letrare.

Ka shkrimtarë të njohur që vazhdojnë të shkruajnë shumë libra dhe secili u numërohet si titull. Mirëpo, në të vërtetë, një libër kanë shkruar mirëfilli, atë më përfaqësuesin, të tjerët janë shëmbëllesa dhe fantazma të tij. Përkundrazi, Kadareja shkruan herë pas here libra të rinj, duke kundërshtuar jo vetëm modelet dhe kryemodelet e të tjerëve, por edhe ato që krijon vetë. Në vazhdim e gjatë të krijimtarisë së tij, si për paradoks, shkrimtari paraqitet një miratues i bindur i rregullave të artit, kur njëkohësisht është po aq kontestues i paepur. Duke emancipuar artin e tij, çka nuk arrihet me një të rënë të lapsit, Kadareja është emancipuesi më ndikues në letrat shqipe. Ne kemi pasur edhe shkrimtarë që e kanë luajtur këtë rol, por duke jetuar në Perëndim, si Imzot Noli dhe Faik Konica. Mirëpo askush nuk i dha artit të vet një frymë dhe shpërhapje kaq perëndimore sa Kadareja, që jetoi fort gjatë në Tiranën e izoluar. Sipas meje, Ismail Kadareja nuk gaboi asnjëherë në artin e pastër, ndërkohë që gaboi sa herë që si pikënisje pati frymëzime devijante.

7.

Përmenda diku ashkun e të shkruarit, por ka edhe ashk të leximit. Këto shënime aty bazohen. Ashku i leximit është liria e shijimit vetjak, gjendja kur më tepër ndien dhe të pëlqen të ndiesh, sesa të dyzohesh. Nuk do të jem pishman pse "e kam tepruar", siç mund të thonë çuditërisht disa kolegë, pishman jam për çfarë nuk thashë. Lashë shumë vatra pa përmendur, ndër to pajën e larmishme estetike dhe stilistike, elipset elegante të ritmit, disa punktura të stilit apo një portret shkëlqimtar, me të vërtetë një xhoel, siç është episodi me hebreun Jakoel. Për sa nuk thashë, më mbetet veçse një ngushëllim, t'i përfytyroj të nënkuptuara shenjat e vuajtjes që ka arti i madh dhe që, si për të dëshmuar se është i tillë, sikur shpërbëhet kur merret në analizë. Thua të jetë e paprekshme metafizika e tij, substanca frymore e shpirtërore, thua të jetë soma pneumatikon?!

Krijimtaria juaj përfshin rrëfime, ndjesi, përjetime, emocione e përditshmëri për fate njerëzore të një epoke absurde, fundi i së cilës përkoi fill me kohën kur ju vendosët të largoheshit. E nuk ndodh rrallë që njerëzve u vishet një memorije kolektive artificiale, që e bën një komb të pësojë krizë identiteti. Në mendimin tuaj, si nisi e bitisi ky fill i harresës kolektive?

Duke jetuar jashtë shtetit, e kam të vështirë të flas për çka ka ndodhur në Shqipëri pas rënies së diktaturës. Jam munduar, nëpërmjet krijimtarisë sime, të dëshmoj për kohën e dikurshme, duke nënvizuar mënyrën se si brezi im arriti jo vetëm të mbijetonte, por edhe të jetonte çaste të bukura, miqësi të jashtëzakonshme, dashuri ëndrrash. Dhe kur dëshmitarët e asaj kohe të kenë ikur të gjithë, kam shpresën se librat e mi do të vazhdojnë të tregojnë përditshmërinë në komunizëm. Në fakt, e tashmja e afërt gjithmonë harrohet që të mund të pranohet e ardhmja. Por interpretime të reja të së shkuarës do të ketë gjithmonë...

Padyshim se është me vend të shfarosim nga kujtesa kolektive neverinë dhe absurditetin e shumë gjërave të asaj epoke, karshi të tjerave që mbeten struktur mbështjellë me një vello nostalgjie, që ashtu të dala kohe ngurrojmë t'i ribëjmë tonat. Çfarë do të ishte ende me vlerë për t'ia rikthyer së përditshmes sonë? Ju vetë ç'ju mungon më shumë nga vlerat e asaj kohe?

Vlerat më të mëdha të kohës së dikurshme ishin të lidhura me mungesën e pronës private, realitet që nuk mund të rikthehet. Njerëzit kishin kohë t'i përkushtoheshin njeri-tjetrit, se nuk ishin të stresuar të fitonin sa më tepër. Rroga ishte njësoj si për ata të paktët që copëtoheshin duke punuar, edhe për të shumtët që vrisnin kohën me muhabete. Kur vij në Shqipëri, ndjej një mungesë solidariteti dhe një mungesë kulture të përgjithshme. Mungesë ëndrrash gjithashtu. Ne ishim vërtet të varfër, por ishim të pasur në ëndrra. Disa nga miqtë e mi e kanë ruajtur aftësinë e të ëndërruarit dhe takimi me ta është vërtet për mua një ngjarje e mrekullueshme.

Tashmë Tirana nuk është më aq familjare për ju. Miq të vjetër të larguar e që rikthimet e tyre të përkohshme zor se përkrijnë me tuajat e që e bëjnë më të vështirë rikthimin në kujtime. Rrugica e kafene të vjetra që nuk ekzistojnë më. Besnike ju shfaqet shtëpia e vjetër kërrusur nën çatinë me qerpiç. Për çka të ankohen muret e saj kur puçeni bashkë? Ç'zëra kanë humbur me kohën aty?

Fatmirësisht, nuk kam humbur asnjë nga miqtë e dikurshëm; komunikoj me ta në distancë dhe i takoj kur kthehem në Shqipëri. Për rrugicat dhe kafenet e dikurshme më vjen keq, por më shumë më dhemb në shpirt prishja e pazarit të fshatarëve dhe ndërtimi i kafeneve të panumurta aty ku katundarët prisnin klientët me dy sallata. Në vend që të ndërtohej diçka për ta, kanë mbirë kafetë! Ka humbur sharmi i Tiranës me ndërtesat e ulta, me oborret plot hardhi dhe hurma. Lagjja ime është transformuar. Ka mbetur pa u shembur vetëm shtëpia ime e vjetër; aty kam lënë femininë dhe rininë e hershme. Më mungon gjithçka: mamaja që ndriçonte kuzhinën me tërë qënien e saj, babai që ndizte sobën duke kënduar, tingujt e kitarës te shkallët e oborrit ku rrinim me motrën dhe vëllanë, limoni, zërat e komshijve, Xheri, macja jonë... Do dëshiroja kaq tepër të bëja një udhëtim në kohë e të kthehesha për pak çaste aty, në kohën kur Elina ishte akoma e vogël dhe kërcente nëpër shtëpi, kur hapej porta e oborrit dhe shfaqej silueta e ndonjërit nga shoqet e mia të shumta...

BESSA MYFTIU

Rrëfim për Tiranën e dikurshme dhe malli për të shkruar shqip

Bisedoi: Marcela Tringaj

...Ka diçka shekspiriane në këtë roman të autores Bessa Myftiu, shqiptare me banim në Zvicër që shkruan në gjuhën frënge. Ajo e mban fillin e historisë me dy duar, njëra e marrë dhe tjetra e mençur, duke harmonizuar mrekullisht të papriturat befasuese me realizmin e tablosë së ndjenjave dhe forcën e emocioneve. Nuk ka aspak moralizim në historitë e saj, por disa të vërteta të pakundërshtueshme burojnë prej tyre. Për shembull, që shpesh ne e vendosim vetë veten në situata pa rrugëdalje. Që sedra e sëmurë dhe dashuria nuk shkojnë mirë bashkë. Që s'ndahemi kurrë nga asnjë dashuri, veç mësojmë të jetojmë pa të. Ngaqë dinë ta përdorin me seriozitet dhe lehtësi armën e humorit, personazhet e këtij romani triumfojnë mbi dëshpërimin. Ato e kanë kuptuar tashmë se gëzimi është pjellë e dhimbjes, se dashuritë tragjike mund të jenë shumë të bukura dhe se asgjë nuk është aq e tmerrshme sa duket...

– Astrid De Larminat, *Figaro*

Bessa Myftiu është poete, skenariste, autore romanesh e novelash, që lindi dhe u shkollua në Tiranë e prej vitit 1991 jeton në Gjenevë. Fillimet e saj janë si gazetare, por nuk ka lënë pas për asnjë moment pasionin për të shkruar. Ajo spikat si skenaristja e filmit televiziv mjaft të njohur "Unë e dua Erën". Sot është pedagoge në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Lozanë të Zvicrës, ndërsa vazhdon krijimtarinë e saj duke ju përkushtuar shkrimit dhe kinemasë.

Bessa zgjedh të shkruaj në frëngjisht, megjithëse shumë nga veprat e saj janë botuar edhe në shqip. Kjo i ka dhënë mundësinë që të tregojë e të flasë mbi për Shqipërinë në një distancë tjetër. "Nëse në Shqipëri gjërat shqip më dhembin, në frëngjisht distanca e duhur bën që të kem një vështrim më objektiv." Por shqipja mbetet gjithmonë në thellësitë e saj. Padyshim që largimi ka ndikuar ndjeshëm në karakterin e shkrimtares.

Personazhet e historive tuaja nuk bëjnë moral. Jetojnë veten e jetën natyrshëm, me të vërtetat e tyre, qofshin këto normale apo tej saj. E kur tekta njerëzore shpjen dashurinë në qorrsoakakë, apo në humnerën e harresës, e humbjes, asgjë nuk mbetet tragjike, sepse janë vetë personazhet që triumfojnë në fund mbi dhimbjen. Ç'qosh zemre e mendjeje vendos të sfidojë njeriun e kapriçot e tij kështu?

Po, personazhet e mi triumfojnë mbi dhimbjen—dhe ky është mësimi më i bukur i kohës së diktaturës. Në kohën kur jetoja në Shqipëri, edhe trishtimi më i madh shoqërohej me të qeshura. Ne ishim mësuar ta kërkonim gëzimin në skutat më të thella që të mund të mbijetonim. Humori përbente një mjet të domosdoshëm të përditshmërisë sonë; ku ka humor



ka gjithmonë rilindje. Ne ishim të detyruar të rilindnim çdo ditë, pa asnjë eksperiencë të së djeshmes, vetëm me ëndrra për të ardhmen. Por edhe në qoftë se ëndrrat nuk bëheshin realitet, ato na jepnin lumturi gjatë kohës së ëndërrimit. Në fund të fundit, gjithçka fillon nga ëndrra...

Padyshim që tashmë Gjeneva është kthyer në shtëpinë juaj, por peripecitë që një emigrant has në fillimet e tij shënjojnë këdo. Sa të ka ndihmuar të shkruarit të kapërceje sfidat e fillimit e sa ka ndikuar mërgimi në shkrimtaren që jeni sot?

Çuditërisht, kur arrita në Zvicër, nuk shkrova asnjë rresht gjatë gjithë vitit të parë. Isha e zënë shpirtërisht me mësimin e gjuhës dhe zbulimin e një bote të re, të lirë. Dua të theksoj se nuk kam qenë emigrante në Zvicër—pak muaj pasi arrita mora pasaportën zviceriane, gjë që ma lehtësoi shumë integrimin në shoqëri. Por sfida më e madhe ishte perfeksionimi i frëngjishtes në të shkruar, peripeci të cilën e kam treguar në librin me tregime *Drejt të pamundurës*. Dhe e pamundura ndodhi! Kur profesori Zhorzh dë Prë na ktheu notat e provimit me shkrim, tha përpara klasës: «Tani do t'ju lexoj një tekst që më ka pëlqyer shumë. Edhe një francez nuk do ta kishte shkruar më bukur.» Nuk e prisja kurrë se do të ishte teksti im. Kjo frazë më ka frymëzuar dhe me ka dhënë besim të shkruaj në frëngjisht. Kur kërkoja këshilla për disa fjalë të mijat që nuk ishin korrekte nga pikëpamja gjuhësore, profesori më thoshte: "Mos lejoni t'ju korrigjojnë shpirtin." Kështu që mërgimi më bëri shkrimtare frankofone. Nuk do të kisha shkruar të njëjtët libra po të kisha qëndruar në Shqipëri dhe sigurisht nuk do të kisha të njëjtin stil. Ajo nostalgji që ndihet në veprat e mia është tregues i mallit të një shkrimtareje që ndodhet larg atdheut. Përveç kësaj, të shkruarit në gjuhë të huaj është një shkollë më vete: çdo fjalë është e kërkuar, e matur, e mësuar me mundim.

Si nisi rrugëtimi i dijedhënies në një prej një prej institucioneve arsimore zvicerane, mes më të mirave në botë? Ç'sinergji të mëkon në mendje e shpirt privilegji i të qenit pranë dijes e mes të rinjve ëndërrimtarë?

Mësimdhënien e kam patur gjithmonë pasion; të dy prindërit e mi ishin mësues. Pata fatin e madh të takoja, kur isha ende studente, një profesoreshë shumë të famshme në Universitetin e Gjenevës, Mirej Cifali, e cila më dha mundësinë të eci në rrugën e jetës. Lënda e saj kishte lidhje me shkrimin e eksperiencës; për të, nuk kishte zgjedhje më të mirë sesa të kishte si asistente një shkrimtare të ardhshme. Për mua, nuk kishte punë më të bukur sesa të shoqëroja studentët në shkrimin e eksperiencës së tyre në shkollë. Aty u përballa me një sfidë shumë të madhe që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Duke u nisur nga mënyra se si i ripunoja tekstet e mia, profesoresha Mirej Cifali Bega (që tashmë është martuar me Estref Begën në Shqipëri) më ngarkoi të kryeja të njëjtin proces me tekstet e studentëve. Fillova me studentët e vitit të parë dhe vazhdova me ata të vitit të katërt. Tani në Shkollën e Lartë Pedagogjike u mësoj profesorëve të frëngjishtes se si të shkruajnë gjuhën e nënës!

Pjesa tjetër e punës sime ka të bëjë me reflektimin mbi mësimdhënien. Jam shumë e lumtur dhe krenare që kam mundësi të jem në kontakt me ata që do të edukojnë nesër brezin e ri. Studentët e mi janë ëndërrimtarë dhe plot shpresa. Ata mendojnë se edukimi do ta ndryshojë botën dhe kanë të drejtë, megjithëse unë preferoj frazën e Dostojevskit: "Bukuria do ta shpëtojë botën!" Por a nuk është edukimi bukuria më e madhe e botës?!

1.

E njohur në gjithë qytetin për bukurinë e saj, Sadia ishte martuar me kushërerin e gjyshit, një vagabond pa katandi, me të cilin kish patur dy fëmijë. Familja jetonte në sajë të shtëpisë që ajo kishte trashëguar nga prindërit, se pat mbetur jetime qysh e vogël: jepnin me qira disa dhoma, duke pritur që t'u rritej djali dhe t'i ndihmonte për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike. Ai ishte vetëm katërmëdhjetë vjeç. Të gjithë kthenin kokën kur kalonte rrugës: ishte e vështirë, në mos e pamundur, të imagjinoje një djalosh më të bukur. Por bukuria e tij ishte tragjike, penetruese deri në dhimbje, e ëmbël deri në neveritje, shkatërruese dhe e mistershme. Këto lloj bukurish ngjallin perversionet dhe zgjojnë pasionet e sëmura në zemrat e burrave të vetmuar, pa gra, pa fëmijë, që rrijnë tërë ditën mbyllur në shtëpi duke përgjuar pas perdeve të rënda të dritareve të mëdha. Komshiu përballë e kishte parë djaloshin. Ai kish vendosur një arkivol përpara portës së Sadies, me mbishkrimin : "Ose bëhet imi ai bukurosh, ose vdes".

Mallkimet e dashurisë janë të rrezikshme! Për të shpëtuar djalin, Sadia shiti shtëpinë dhe gjithë familja u nis për Anadoll, në fund të Turqisë, larg syve perversë të komshiut. Larg syve, larg zemrës, thotë proverbi. Por mallkimi nuk i njeh distancat: përkundrazi, largësia e rrit dhe i jep forcë. Brenda tri muajve, Sadia humbi djalin, burrin dhe vajzën gjatë një epidemie të kolerës. U kthye në Shqipëri e vetmuar, e dëshpëruar. Nuk kishte më as shtëpi dhe as familje. Nuk deshi të martohej më. Përse të lindte prapë fëmijë fatkeqë? Dhe pikërisht në këtë çast, gjysh Halimi i hapi portën e Shtëpisë. Sadia sapo i kishte mbushur tridhjetë e tre vjeçët dhe ishte ende e bukur për t'i prerë kokën. Dëshpërimi ia kishte holluar tiparet duke i dhënë një pamje perëndeshe, melankolia ia kish rritur hijeshinë. U fut në familjen e gjyshit dhe nuk i përmendi kurrë as vajzën dhe as djalin e vdekur. I deshi me shpirt fëmijët e bamirësit të saj, sikur të ishin të vetët. Çuditërisht, në zemrën e tyre ajo zuri vendin e parë. Megjithëse ishte vetëm tre vjet më e madhe se sa dy gratë e Halimit, për të shmangur çdo lloj xhelozie, Sadia e quajti veten "gjyshe".

Gjatë gjithë jetës, Halimi nuk ia prishi kurrë dhe asnjëherë nuk e qortoi. Ndoshta e donte, me një dashuri të përzier me adhurim. Ndoshta respektonte fatkeqësinë e saj pa fund e pa anë, fshehur pas një buzëqeshjeje rrezatuese. Me mirësinë e saj, Sadia e ndriçonte Shtëpinë. Ajo i kishte të gjitha të drejtat, meqë fati i kish marrë gjithçka. A vajtonte fshehurazi, kur të gjithë flinin? Mos dëshironte të futej në krevatin e burrit që i kish hapur derën e shtëpisë me aq bujari? Apo kënaqej me pozicionin e saj të veçantë, me një lloj tjetër dashurie ndërtuar prej ëndrrash?

2.

Po shkoja të blija bukë, kur dëgjova që më thirrën:

- O goce!

Ktheva kokën andej nga erdhi zëri: pas hekurave të dritares së katit përdhes të shtëpisë që ndodhej mu në fillim të Rrugës, dikush ma bënte me dorë. U afrova. Dallova në fillim dy sy blu si një det i pafund, një dorë të bardhë me thonj të lyster me manikyr të kuq flakë dhe pastaj fytyrën e një gruaje që e kishte lëkurën tamam si prej fildishti. Ajo buzëqeshte; ajo i ngjante kaq pak mamit tim, mësueses, shitëses së bulmetit, pastrueses së shkollës - me një fjalë gjithë grave që kisha njohur në jetën time - sa unë arrita në konkluzionin se kurrë nuk kisha parë ndonjë grua: ajo ishte e para. Një grua e vërtetë, ashtu siç e përshkruajnë librat: jashtëzakonisht e bukur, enigmatike, magjepsëse. Gjithë qenia e saj rrezatonte butësi dhe hijeshi, kurse parfumi më kujtonte erën e manushaqeve. Fustani ngjyrë vishnje i vinte në pah zbehtësinë e qafës së bardhë të rrethuar nga një gjerdan perlash, pa dyshim të vërteta. Kush ishte kjo grua e ngujuar në këtë shtëpi famëkeqe? Mos kishte dalë direkt nga ndonjë përrallë?

- A mund të më blesh ca cigare? Kam vënë bigudinat dhe nuk dal dot.

Ajo më zgjati një kartmonedhë prej pesëdhjetë lekësh. Mora paret pa thënë asnjë fjalë dhe vrapova tek kinkaleria përballë shtëpisë. Bleva dy paketa, të cilat i vendosa me respekt mbi pëllëmbën e saj delikate. Ajo më pyeti si e kisha emrin, sa vjeç isha dhe se çfarë pasioni kisha në jetë. Kur i thashë se më pëlqenin librat, ajo ma ktheu menjëherë:

- Edhe unë kam shumë qejf të lexoj.

Por në momentin kur po përgatitesha ta pyesja se cilët ishin autorët e saj të preferuar, ajo

Fragmente nga romani "Rrëfime nga vendet e harruara"

Shënimi i autorit për botimin shqip

Ky roman u shkrua dhe u botua së pari në frëngjisht. Duke u shprehur në gjuhën e Mollierit, fitova një liri të pakufishme: munda t'i kthej të gjithë njerëzit që njihja në personazhe librash dhe arrita ta përdor të vërtetën jetësore e historike sipas qejfit. Është luks i jashtëzakonshëm për një shkrimtar t'i drejtohet një publiku të panjohur! Prandaj mos kërkoni fakte në romanin tim – lexojeni si përrallën e një kohe të perënduar. Në rast se te ndonjë personazh dalloni tiparet tuaja, mos u dëshpëroni nëse nuk i kam qëndruar besnike realitetit: asgjë nuk është krejt e vërtetë në këtë libër, veç dashurisë sime për vendlindjen.

Gjatë përkthimit të tij në gjuhën amtare ndjeva se sa më kishte marrë malli të shkruaja shqip. Dëshpërimisht...

shtoi:

- Mos të vonova! Ndoshta prindërit e tu bëhen merak.

U kujtova papritur se gjithë familja më priste ulur në tavolinë. Kur u çova bukën, motra më pyeti me një ton ironik:

- Pse u vonove kaq shumë? Mos të ndodhi ndonjë gjë e jashtëzakonshme?

- Po, - u përgjigja dhe tregova takimin tim me Aishen.

- Aman të keqen! - thirri mami. - Mos iu afro më asaj!

- Pse? Është një grua e jashtëza...

- Ajo nuk është grua, po kurvë, më ndërpreu mami.

- Femër fatkeqe, - e korrigjoi babi.

- Po ajo nuk ishte fare fatkeqe, - thashë për ta mbrojtur. - Gishtat i kishte të lyster me manikyr të kuq. Fytyra i shndriste. Kishte bërë dhe tualet.

- Pse mos zbukurohet ajo, ka gjithë atë kohë! - u hodh mami.

- Po ti, pse s'ke kohë?

- Po sepse duhet të kujdesem për ju, - ma preu ajo dhe filloi të na hidhte në pjata supën me zarzavate.

Në këtë çast, unë i ndava gratë në dy kategori: kurvat – të lyster, të bukura, të qeshura, enigmatike, dhe mamatë – gjithë kohën duke larë pjatat, duke fërguar peshkun, duke ushqyer bebet, nervoze, të lodhura.

- Po e takove prapë, mos i fol më! Vëllezërit e kanë zbur nga shtëpia se nuk kishte sjellje të mirë.

Unë bëra një tentativë të fundit për ta paraqitur Aishen me tipare pozitive:

- Asaj i pëlqejnë librat!

Por në sytë e mamit kjo dashuri për letërsinë s'ishte veçse një ves më tepër:

- Ajo lexon se nuk ka burrë dhe kalamaj. Si do ta kalojë kohën ndryshe?

- Po ti pse ke burrë dhe kalamaj, meqënëse ata të pengojnë të lexosh?

- Sepse unë jam grua e ndershme, - i dha fund diskutimit mami.

- Unë nuk dua të bëhem kurrë grua e ndershme.

- Pu, pu, pu!

Babi u mundua t'i jepte bisedës një ton filozofik:

- Prostitutat, (ai nuk e përdorte fjalën "kurvë") nuk e kanë jetën aq të lehtë sa ç'mund ta imagjinosh ti. Të gjithë i flakin, edhe burrat që i paguajnë dhe shkojnë me to. Ato nuk kanë vend askund. Ato përfaqësojnë produktin e një shoqërie të papjekur për dashurinë dhe janë viktimat e saj.

Çfarë mendonte Aishja? Nuk pata mundësi të bisedoj me të mbi një çështje kaq të rëndësishme, sepse fill pas bisedës sonë u shfaq në Rrugë një kamion Albania, që filloi të rrinte gjithë ditën i parkuar në trotuar përpara banesës së saj. Shoferi, që kishte ardhur në fillim si klient, u mrekullua nga hijeshia e kësaj kurve të admirueshme dhe e kërkoi për grua.

3.

SHTËPIA IME ka vendosur të vrasë veten. E lumtur në kohën e mbretit Zog, guximtare gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, optimiste në periudhën e komunizmit, ajo është zhytur në melankoli të thellë që prej dhjetë vjetësh. Në fillim i morën një copë të vogël nga kopshti për të ndërtuar një dhomëz ku do të vendoseshin dy makinat e shtypshkronjës së tim vëllai. U desh të pritej fiku gjethegjërë... Mbi trungun e tij të rrafshuar, muratorët vendosën pllakat ngjyrë gri të dyshemesë. Nga dritaret e katit të parë Shtëpia vështronte me hidhërim këtë përzgjatje të shëmtuar të saj, bërë prej betoni me cilësi të ulët; në netët me shi, lotë të mëdhenj i rrëshqisnin përgjatë fasadës.

Lotët iu transformuan në dënese gjatë ndërtimit të një dhome tjetër: vëllai kishte blerë tri makina të reja dhe kësaj radhe e pësoi qershia – pema më e bukur e kopshtit me ato lulet e saj të bardha në pranverë dhe frutat e kuqe në fillim të verës. Sa herë që fillonte ndonjë rrebes, Shtëpia përfitonte nga rasti që të vajtonte trishtueshëm duke tundur me dhimbje gjithë skeletin e saj. Dhe kur vëllai preu pjeshkën në lulëzim të plotë për të stisur një barrakë që të fuste presën e shtypshkronjës, disa plasaritje të çuditshme u shfaqën papritur në muret e banjës: Shtëpia kishte zgjedhur vendin më intim për të shfryrë pa ndrojtje tërë neverinë e saj.


Sigurisht, ajo as që e kishte imagjinuar sulmin kundër hurmës shumëvjeçare, mbushur plot me fruta dhe tepër kryelartë. Nuk ia kish prerë mendja kurrë se vetë prindërit e mi do t'i hidheshin përsipër me sopatë – kjo ia shkatërroi përfundimisht ekuilibrin psikik Shtëpisë. Mbi varrin e hurmës u ngrit një kuzhinë e vogël. Prindërit shpresonin t'i shpëtonin zhurmës së vazhdueshme të shtypshkronjës si dhe erërave që mbushnin oborrin. Tymi i vjellë nga një gjenerator i blerë në një dyqan të dorës së dytë në Itali e thau përfundimisht hardhinë: ajo filloi të sillej rrotull ballkonit tamam si skelet dhe pastaj u end mureve duke lëshuar herë pas here ndonjë copë nga trupi i saj i vdekur mbi kalimtarët. Askush nuk mori mundimin ta priste. Ne nuk i vrasim të vdekurit. I lëmë të jetojnë me të gjallët.

Por kjo bashkëjetesë e detyruar me kufomën e hardhisë, dikur plot fletë të gjelbra dhe zbukuruar me veshulë, e deprimoj Shtëpinë. Ajo kishte duruar prerjen e fikut të madh, degët e të cilit i bënin hije gjatë verës përvëluese, ekzekutimin e mbretëreshës pjeshkë, lulet e të cilës i frymëzonin një ndjenjë përjetësie, asgjësimin e qershisë veshur me të bardha, simbol i ëndrrave më të pastra, si dhe masakrën dhe djegien e hurmës në sobën e prindërve të mi, që kishin mbetur pa dru gjatë dimrit. Ajo kishte duruar gjymtimin e vet, shtimin e gjymtyrëve të padenja mbi trupin e saj të lehtë prej kashte e qerpiçi dhe bile, heroikisht, pati toleruar edhe barrakën në fund të kopshtit, mbi varrezën e pjeshkës. Po ama të përqafohej nga krahë të vdekur, jo, këtë nuk e duronte dot! Kjo i tejkalonte të gjitha!

Shtëpia u bë paranojake. Kur pa që gjeometrat vizituan banesën përballë, ajo u drodh nga frika: disa copa suvaje ranë nga tavani direkt mbi shpatullat e babait tim. Të nesërmen, e vetmja palmë e lagjes sonë pa vdekjen me sy: ia bënë varrin disa punonjës të një ndërmarreje të madhe ndërtimi. Në kopshtin e së ndërës Vangjeli, që kishte trëndafilat më të kuq dhe tulipanët më të bukur, do të ngrihej një pallat prej dhjetë katesh.

Dhjetë kate rriten shumë më shpejt se sa një pemë e zakonshme dhe bile akoma më shpejt se një palmë. Pas një muaji, qielli ishte zvogëluar fare. Shtëpia filloi ta sodiste diellin vetëm pasdite. Këtej e tutje agimi rrezeartë do të mbetej për të një ëndërr e paarrtshme. Nga dritaret e saj ajo do të kundronte të tjera dritare që do ta shikonin nga lart me përçmim. Për herë të parë Shtëpisë i shkoi mendja tek vetrasja, por ama vendimin përfundimtar e mori më vonë, gjatë ndërtimit të një pallati dymbëdhjetë katësh në të majtë të saj, pikërisht mbi banesën e dikurshme të Nerit.

Shtëpia e mblodhi mendjen t'i jepte fund jetës dhe vendosi të shembej me gjithë madhësinë e saj, një të diel, kur banorët e vet të kishin dalë shëtitje. Ajo nuk donte të vriste asnjëri. Por akoma nuk e dinte e shkreta se pronarët po i përgatishnin një komplot për ta zhdukur. Në sallonin e saj të madh ku ishin festuar aq dasma e ishin qarë aq shumë të vdekur, gjeometrat erdhën të pinin një gotë konjak për nder të varrimit të saj të ardhshëm. E keqja po trokiste në derë dhe nga anët tona askush nuk i shpëton dot fatit të vet. Ai i hoqi Shtëpisë lirinë e saj të fundit – të drejtën e vetëvrasjes – pasi i pat ofruar një ekzistencë të jashtëzakonshme...



Përvoja më ka mësuar se në fushën e krijimtarisë letrare do të dallosh këto tre kategori; libri, ku të tërheq e bën për vete protagonistin, libri, ku mendja fokusohet te talenti i autorit dhe libri, ku bashkohen të dyja këto cilësi. Në rastin e këtij romani, ndodhemi te ky konstatimi i fundit: shkrimtarja mjaft e mirë, Mira Meksi është shkrimtarja e bërë njësh me heroinën e saj. Është bërë alter egoja e saj. Duke folur rreth kësaj dukurie Johan Gëte ka thënë se “Çdo shkrimtar në një farë mase paraqet në veprat e tij vetveten, shpesh edhe kundër vullnetit të vet”. Pa dyshim që Mira është njëra nga shkrimtarët tona më të shquara. Kudo që do të konkuronte, suksesin do ta kishte të garantuar. E lexon këtë libër dhe nuk ka sesi të mos habitesh nga forca e gjykimit, stili i përkryer, erudicioni i rrallë dhe alternimi i anës historike me atë letrare. Në një farë mënyre, me këtë roman sa artistik aq edhe studimor, ajo i ka bërë një shërbim të vyer vetë historisë. Kulturë superior, harmoni e thellësi arsytimi, mjeshteri në ndërthurjen e ngjarjeve, gërshetim i reales me fantastiken, ilustrim i rafinuar me mitologjinë, leksik i pasur me krijime pafund fjalësh të reja, përshkrime të gjalla e plot jetë, atmosferë e besueshme e kohës të mbi dy shekujve më parë, gjendje emocionale të besueshme, personazhe kontraverse, ide të mëdha të dhëna fare thjeshtë - ja disa nga tiparet dalluese të prozës së kësaj autoreje, pak ta quash, të mrekullueshme. Mira Meksi, si një aktore teatri është shndërruar në sytë e lexuesve në një Frosinë (gr. Gëzime), të vërtetë. E bukur siç është, e mençur, mendjehapur, e shpenguar nga paragjykimet, besnike ndaj bindjeve të veta, e guximshme në të drejtën


PORTRETI I PANJOHUR I FROSINËS AQ I NGJASHËM ME ATË TË AUTORES

Nga Shpendi Topollaj

për të mbrojtur dashurinë e sinqertë, ajo është shndërruar në atë Frosinë që deri dikur ishte për ne e pa njohur. Dinim që një figurë e çuditshme dhe tekanjoze si ajo e Ali Pashait, e kishte futur në një thes dhe e kishte mbytur në liqen, atje në Lucëz. Edhe vetë, kur jam ndodhur në ishullin e Pandalejmonit, instinktivisht tresja shikimin thellësisë së liqenit, se mos e shihja atë bukuri pa formë. Pastaj përmendesha dhe kujtohesha se ajo ishte kthyer në legjendë dhe nuk mund ta gjeje jo në ujrat e liqenit, por as në Qimiterin e vjetër, as brenda një karroce aristokratësh, as rreth mureve të sarajeve të Muktarit brenda qytetit të Janinës, dhe as te kioska e ndonjë hebreu a indiani, ku e çonte romani. Ajo ishte askund dhe kudo njëkohësisht; endej aty rrotull, duke vajtuar në heshtje për fatin e saj të zi, ku ja prenë gëzimin e jetës në mes, duke paguar shtrenjtë dashurinë që ndjente për birin e Pashait të madh. Dhe në këtë anë,

në botë ndër shekuj, fatin e asaj bukurosheje e kanë pasur kushedi sesa vajza e gra të tjera. Por Mira i dha jetë asaj, e ringjalli dhe ashtu me një bagazh prej intelektualëve të spikatur për kohën, e solli në përfytyrimin tonë: “Në prag të martesës, Frosina pat nxënë njohuri të filozofisë elementare të Locke - ut dhe Kant - it, njohuri të matematikës së Mezbpourg - ut, njohuri të fizikës dhe kimisë eksperimentale, mësimet e astrologjisë, historisë, gjeografisë politike dhe shkencore, kishte marrë mësimet në latinisht, frëngjisht, turqisht dhe kuptonte gjermanisht”. Ja pra, sesi doli portreti i panjohur i Frosinës aq i ngjashëm me atë të autores së romanit. Kështu kanë marrë formë edhe personazhet e tjerë të ardhura nga legjendat. Asnjëri nga ne nuk e ka parë Krishtin, por imazhin e tij po, sidomos nisur nga bëmat dhe ato që rrëfohen, qofshin dhe jo të sakta. Por kësaj gruaje që hidhte dritë mbi Janinën e atyre viteve të vrullshme, i kishte qëlluar

të jetonte kur atje qeveriste një mizor, nga ata që askush nuk di se ku ta klasifikojë. E urrenin me budallallëk, por edhe e admironin me budallallëk. Ndofta më mirë nga të gjithë vlerësimin për të e ka dhënë François Pouqueville, kur ai vdiq: “Ata ishin shastisur krejt: kurrë ndonjëherë s’u pa dhimbje e tillë ndër epirotët luftëtarë; sepse kjo është e vërteta: që tiranët më kobzin për njerëzimin, si kanë arritur të zvetënojnë çdo lloj morali dhe kanë ushtruar pushtetin e tyre mbi gjatëtarët e njerëzve, shoqërohen së fundi nga këta me dhimbjen më të thellë”. Frosina jetonte atëherë kur Aliu për të siguruar sa më shumë taksa i gozhdonte të vdekurit te dyert e shtëpive dhe nuk i hiqte që aty pa e paguar më parë. Dhe të fismit e mirarsimuar nuk mund të pajtoheshin me këtë barbari, siç e quante konti Choiseul - Gouffier. Në bisedat e tyre ata e shfaqnin haptazi neverinë për mënyrën neronike të qeverisjes. Frosina nga ana e saj e kërkoi ndryshimin, rreket të japë ndihmesën e saj për organizimin e diçkaje të vlefshme, pasi sikurse shprehet gjatë bisedës “ju e dini mirë se historia njerëzore është e mbushur me barbari, por më besoni, për fat të keq në këtu jetojmë me psikologjinë e tmerrit, torturës, të derdhjegjakut”. Frosina nuk paska qenë një lavire, por një idealiste, dhe për fat të mirë a të keq, ashtu siç konsideroheshin sipas Hesiodit tri Hiret, edhe me një bukuri të përsosur. Para librit të Mira Meksit, përgjithësisht ka mbizotëruar opinioni se Ali Pashë Tepelena e mbyti në ujrat e liqenit Frosinë së bashku me ca femra të tjera të përdala, si dashnoren e të birit. Dhe vetëm kaq. Por ja që nuk paskej qenë plotësisht kështu. Ajo tani, veç keqardhjes që e kishte, ka fituar edhe simpatinë tonë falë kësaj shkrimtareje kaq të dashur që ka vënë mendjen dhe shpirtin e saj të pastër për ta vizatuar sa më joshëse atë në sytë tanë. Dhe na e ka dhënë Frosinë edhe njeri, edhe femër, që ka dëshira, hove dhe epshe si gjithë të tjerët. Përvëlohet nga dashuria për Muktarin, edhe pse ai nuk e meriton dashurinë pasionante të saj. Ngjet po ajo “shkrepe ashklash” që Marina Cvetajeva thotë për Venerën, dhe që Mira jonë i ka përshkruar me aq njerëzillëk e qytetari. I velur nga gratë e haremit, Muktarit shpejt i kalon dalldia për të bërë të vetën bukurinë e Frosinës. Se për të kaq ishte; sikurse thotë Litizia që e kishte provuar; ai mjaftohej duke thënë: “Robina ime, robina ime”. Por e keqja nuk mbetet këtu. Frosinë e dëshëron edhe i ati i tij, vetë Ali Pashai, që shkon befasisht dhe i futet asaj në dhomë. “Oh Frosinë, Frosinë! Më ka nevojë xhani për ty në këtë botë jarane!” - kishte përsëritur në jerm. Por Frosina, kurajoze siç është, e kundërshtoi, edhe pse ai i premtonte botën asaj. Pastaj Pashai inatçor gjen rastin kur nuset e djemve që ishin dhe motra, i ankohen për unazën që Muktarin i kishte dhuruar Frosinës dhe e ndan mendjen: urdhëron Thanas Vajën të veprojë: “Shkruaj dhe Frosinë e Argirosëve. Kështu kërkon Allahu!” Po ku do ta shkruante? Në listën e të pamoralshmeve të qytetit. Dhe ja, kaq u desh dhe ajo që Thanas Vaja tek e shihte e quante hyjneshë, vari kokën dhe pastaj vijuan vargjet e trishtuara të poezisë së Andre de Chenier “Ofelia valvitej ujërave si një zambak i bardhë”. Frosina e Janinës, ashtu si ajo hyjneshë e mitologjisë që ishte mbesa e Oqeanit, përfundoi në fund të liqenit e mbyllur në një arkë. Ndofta jemi para një krijimtarie sureale, nga ato që i kishte për zemër Andre Bretoni e Eugjen Grindeli (Pol Elyar), dhe që i torri gjatë S. Frojdi, por, kjo nuk ka fare rëndësi. Rëndësi ka ajo që përshkruhet si një tragjedi, e cila përjetohet aq besueshëm, sa të kujtohen fjalët e Çehovit i cili i lidh ndjenjat me përvojën vetjake të shkrimtarit. Dhe këtë di ta realizojë kaq magjishëm, një dorë e sigurtë e një gruaje mendjehapur e plot talent, me veprën e të cilës kemi të drejtë të mburremi, e cila vetë nuk di të mburret dhe që quhet Mira Meksi.



Dëshira për të thënë një fjalë për Kleo Latin dhe romanin e tij të fundit “Shpirtra të shitur”, botim i “Neriada”-s, nuk e ka zanafillën veç të njohja jonë e hershme, as të qenia e tij si gazetar në disa dhjetëvjeçarë. Dëshira është te hopi që unë dallova në letërsinë e tij. Kleo ka shkruar jo pak romane e libra së fundmi, mjaft të kujtojmë romanet “Dhe yjet dridhen nga dashuria”, “Mëkati i bukur i tradhtisë”, “Trupi im më përket mua”, “Hakmerru duke dashuruar”, “Jehona e tradhtisë”, “Pa dashuri as të vdesësh nuk pranohesh”. Por romani “Shpirtra të shitur”, jo për vëllimin, por për cilësinë e të shkruarit më la mbresën e një estetike të përpunuar.

Objekt letërsia ka shpirtin, bredh humbellave të saj, dallon stërpikje, hije, ankthe, zjarrmi, hyn gjer nëpër shajni, jerme, dyzime, sendërgji e fantazmagori, dhe përpiqet ta shumëfishojë atë shpirt, t'i hedh sipri një petk tjetërfarë, sa të ngjashëm me ta njëmendtën, aq dhe të dallueshëm prej saj. Prandaj ajo quhet fikcion, “e mundshmja”. Veçse çdogjësend i krijuar prej saj shtytësën e merr bash prej së vërtetës. Kleo Lati epohet më fort jo aq te trilli i pastër sesa te ngjashmëria me të njëmendtën. Ndjehet mirë këtu. Doemos edhe i pëlqen fluturimi në qiej poetikë, por rishtazi kthehet te toka dhe yllësia e tij. Ky roman, “Shpirtra të shitur”, është një hetim për njeriun dhe shoqërinë. Në dy kohë. Në dy kahe. Në dy kundërti. Bota ka shpirtra të mirë, të virgjër, fisnikë, që shkrihen për tjetrin gjer në therori. Por bota ka dhe shpirtra të këqinj, që të kafshojnë, që të vdesin. Bota ka diktaturë dhe demokraci, ka burgje dhe liri. “Shpirtra të shitur” është pjesa e errët e saj. Romani i sjellë këta shpirtra, të cilët shpesh rrinë bri teje, ashtu si të fjetur, të pabëzajë, madje të “urtë”, “miqësorë”, por befasi pas shpine ti ndjen kafshimin e tyre të egër, thikën e ngulur thellë në kockë. Nuk është thjesht tradhti. Këta shpirtzinj kënaqen me vuajtjen dhe vdekjen e tjetrit. Këto sikur i çojnë në orgazmë. Por unë them se “shpirtrat e shitur” nuk është pjesa kryesore e romanit. Ka dhe shpirtra të tjerë aty, fisnikë e vetëmohues, që krijojnë palcën e tij. E mund të gjendej një titull më përfshirës?

E mira-e keqja, kjo temë është e përtjetshme, e gjithëkohëshme. Nuk është e një caku shoqëror, as e një caku zakonor, antropologjik, fetar, nacional etj. Ndofta është qysh nga parabola e Kainit. Nga eshtrat e kësaj parabole shkrimtarët kanë nxjerrë narrativa ngjethëse dhe kanë bërë terapi dritësuese. Duke qenë se rrethi i temës hapet e hapet si ata rrathët sokratianë, letërsia përherë është mëkuar e do të mëkohet prej andej, dhe kurrë s'ka për ta hequr syrin nga ai vibrim. Në fund të fundit jeta krejt është një ndeshje e mundimshme midis të mirës dhe të keqes, midis të bukurës dhe të shëmtuarës. Ajo është sa mbarëshoqërore, gjithëpërfshirëse, në luftëra e veprime të mëdha politike, aq dhe në bulbin e vetë njeriut, aty ku ai frymon, vuan, qesh, dashuron, urren; në fibrat e holla të shpirtit të tij. Kur letërsia përthithet nga ky rreth i ngushtë, të shumtën e herës i padukshëm, ajo nxjerr prej andej një mineral të veçantë, të çmuar. Në ujërat e turbullta të një realiteti të tillë, dhe jo vetëm, lundron edhe romani i fundit i Kleo Latit “Shpirtra të shitur”. Këtë të keqe e këta shpirtra të zinj, që e gërricin dhe e brengosin së tepërmi njeriun, megjithatë ai (njeriu) i bart të dyja si fatalitet udhës së vet. Dhe shpirti dhemb. Gjak e vrer pikon. “Te shpirti yt i shitur, i zbrazët, i boshatisur, - shkruan Kleo Lati, - ti gjen fuqinë për t'u zvarritur si gjarpër... Jetët e plagosura dhe të vrara nga helmi yt janë dhuratat që ti gjithë ngazëllim i bën vetvetes. Dhe për çfarë e shet shpirtin tënd? Për çfarë e nxjerr atë në ankand? Për një kockë! Sa turp!...”

Nuk mund të thuhet se romani i Kleo Latit shquhet për ndonjë subjekt që të thith me çuditë, thagmat, mendjekrisjet njerëzore, të papriturat që të lënë gojëhapur, grishjet dhe befasitë e njëpasnjëshme të ndodhive, veprimet e paparashikueshme, pandehmat etj. Nëse do të kërkosh të tilla, ato janë të pakta. Sepse nuk është ky stili dhe parapëlqimi i autorit, as synimi i vetë romanit. “Shpirtra të shitur” është një roman që i drejtohet një përvoje jete, thuasje personale, të cilën kush më shumë a kush më pak, e ka përjetuar në dy kohët ku dhe lëviz diakronia e tij: para dhe pas vitit 1990. Sipas meje, “shpirtrat e shitur” që kanë përcaktuar edhe titullin, janë më shumë pasoja sesa ashta, fillesa gërricëse sesa bartja mentale e romanit, “kocka” e tij, burimi ku ai rrjedh e buthton gjeth. Kjo ashtë e ky burim janë të menduarit dhe të përjetuarit e heroit, Aleksit, në peripecitë ku ai ecejaket, por më shumë në brendësimet e tij shpirtërore, në

Rreth romanit “Shpirtra të shitur” të Kleo Latit

Zjarrmi poetike që e ngrenë shpirtin lart

Nga Josif Papagjoni

këqyrjet, në përjetimet dhe shpjegimet që i bën shumë dukurive dhe atyre sot, duke nxjerrë në spikamë posaçërisht dy gjëra. E para, mungesën e dinjitetit të disa njerëzve që bëhen urat e ligësisë në raport me njeriun e ndershëm e të talentuar. Me shitjen e shpirtave të tyre pushtetit totalitar dhe, ata u bënë qehallarët e devotshëm të dhunës dhe persekutimit shpirtëror. Po të njëjtat fytyra u shërbejnë sot të fuqishmëve të pushtetit, të papërkulur, zemrat e ndershme e poetike, që ngrihen mbi ndotësitë, meskinitetin, poshtërsitë e të tjerëve. Kur këta shpirtra burgosen, shtypen, cenohen, ai “ikën se nuk e duron dot një trup të vdekur. Ikën larg, në liri, në qiejt e pafund...”

Paçka se romani ka prirjen të krijojë një tablo sa më sintetike të dy kohëve, diktaturës dhe periudhës së tranzicionit, paçka se karakteri i sistemeve, afërmendsh, është i ndryshëm nga njëri të tjetri, paçka se kohët dhe ngjarjet janë të ndryshme, autori nuk rreket drejt përshkrimeve dhe një listimi të këqijash, që janë pjesë e publicistikës, të themi. K. Lati e mban penelin në ravijëzim të karakterit të njeriut, dje apo sot. Përmasë kësaj teknike narrative ai ka pohuar një ide qenësore, universale, se e keqja është po ajo, se njeriu i shprishur mbetet po ai, se e liga, vesi, zvetërimi moral janë po ato, pavarësisht sistemit politik. Dikur një bashkëpunëtori yt në gazetë, një korrektor i quajtur Jago, të bënte gjëmën me spiunimet e tij të shefat apo organet e sigurimit të shtetit, sot ai është po njësoj sahanlëpirësi i zotërinjëve të rinj si sahanlëpirësi i dikurshëm i zotërinjëve të vjetër. Në thelb ka mbetur i njëjti: Jagua. Ka ndryshuar veçse kostumi social e politik, tok me disa rituale. Emërtimi simbolik që shkrimtari i ka bërë në këtë rast personazhit është i motivuar, pasi ai synon ta sintetizojë Jagon (dhe gjithë “jagot” e tjerë) si fenomen sa


social aq dhe moral, ndaj dhe nuk ka pëlqyer t'i vërë një emër. I mjafton emri shekspirian i tragjedisë “Otello” – tinëzari Jago. Unë do doja që ai ta kishte gjithsesi një emër, të kishte dhe një profil më të përimtuar, pasi jemi në letërsi, ani pse e ka një pseudonim: “Qorri”. Në letërsinë postmoderne janë përdorur shumë emra personazhesh nga veprat e mëhershme, por ky nuk është rasti, sepse romani nuk e ka një tipologji të tillë. Kjo është një preferencë autoriale, ndofta për t'i thënë lexuesit të tij se nuk ka rëndësi emri i njeriut që i ka sjellë aq shumë telashe heroit të tij, Aleksit, sesa veprimi i poshtër, tinëzitet, servilizmi, tharmi i keq, falë të cilit ky Jago shqiptar është i gatuar. “Jago” të tillë gjenden kudo dhe shoqëria, njerëzit e mirë, dje, sot apo nesër, përherë do të ndeshen me të. Pikërisht kjo sintezë humane i ka interesuar shkrimtarit. Një Jago tjetër është edhe poetuci Gani, që njihet në organet e sigurimit të shtetit me pseudonimin “Shurdhi”. Ai i hapte veshë e sy dhe i bënte katër për të përgjuar e spiunuar shokët e vet. Një grua me emrin Rita shtirej si besnike dhe e devotshme ndaj të shoqit naiv, i cili kishte iluzionin e ndershmerisë së të shoqes së “urtë” që e “donte me gjithë shpirt”, teksa në të vërtetë ajo kurvëronte në ndërmarrjen ku punonte, nxirrte prej këtij kurvërimi përfitim vetiake, influencë dhe u jepte udhë pasioneve të shfrenuara. A s'është dhe kjo një “Jago”? Një tjetër me emrin Ema shpif se inxhinjeri i ndershëm Nevzat i paska “futur duart” në gjoks, për ta degdisur të gjorin në punë të rëndë e më pas në burg. Dyfytyrësi të tilla ka pasur e ka sa të duash. Po të njëjtën gjë bën edhe një femër tjetër me emrin Denisa, tashmë në kohën e tranzicionit, e cila e shet bukurinë, rininë dhe seksualitetin e saj te shefat e fuqishëm të parasë a politikës, duke shfrytëzuar veset dhe epshet e tyre. Disi ndryshe në maniera, por në thelb është po ajo pafytyrësi, po ajo dinakëri, po ajo zdërrhallje, po ajo orgji, veçse paksa më e “institucionalizuar” dhe me petkun e “suksesit” hedhur përsipër. Është petku i amoralitetit të kohës kur çdo gjë

shitet e blihet, trupi e shpirti bashkë, duke i kthyer në kartëmonedha, favore, tepri, zhbërje e bjerrje. Po njësoj ngjet edhe me ndoca sekretare zyrash të shefave të parave a pushtetit, që janë në fakt “prostitutat” e mbrojtura nga ligji, morali dhe e “drejta”. Ndërsa nga ajo çka bëjnë, ato nuk kanë ndonjë dallim nga prostitutat e “ndershme” të hoteleve e rrugëve. *Shpirtra të shitur* janë edhe ato, në budallallëkun, mjerimin dhe paturpësinë e mishit të tyre. Dhe të tillë “shpirtra të shitur” ky realitet paska shumë. Ato luajnë me fytyrën e “ndershmerisë dhe besnikërisë”. Dhe kësajsoj djalli shitet për ëngjëll. Kjo shtirje mizore e zemëron shkrimtarin, andaj dhe ia bën më të ashpër penën, ia mpreh akuzën, jo përmes retorikës, por përmes ndjeshmerisë që përcillet te lexuesi i tij. E shikoni, thotë ai, djajtë e djeshëm dhe djajtë e sotëm veçse fytyrat kanë ndryshuar. Dje të bënin gjëmën, dëshitimet e tyre ia ngarkonin të tjerëve duke i penalizuar për sabotim, punë armiqësore, siç i ngjau inxhinjeri Nevzat, që e futën në burg sepse kërkoi t'i shpëtonte mushkëritë e qytetit nga ndotja e pluhurit të çimentos prej fabrikës së vjetëruar. Edhe sot gjëmën të bëjnë, të pushojnë nga puna siç pushuan dhe Aleksin, se nuk duan që të thuash të vërtetën, por të mbrosh interesat kriminale të tyre.

Ndryshe nga këta “shpirtra të shitur” janë shpirtrat e mirë, fisnikë, ata që kanë në dorë një botë të bukur, shpesh ëndërrimtare, që i japin krahe mendimit të lirë dhe vetë lirisë në kohë frike e kufizimesh, sikundër janë Shkrimtari K. Dori, Fatjoni, Dhimitri, Irisi dhe vetë Aleksit, hero i romanit, i cili duket se ndjek modelin e shkrirjes dhe identifikimit të tij me vetë autorin. Këta janë njerëzit e penës, e mendimit të lirë, e fisnikërisë, andaj dhe ndrydha i vret, e padrejta i brengos, pacipësia i revoltin. Nuk mund të them se janë personazhe të veçantë, të pahasur me parë në letërsinë tonë të pas vitit 1990. Padyshim janë edhe pjesë e banketit të klisheës letrare të kohës. Do duhej diçka përtej të “njohurës”, që Shkrimtari K., për shembull, të zinte vend në një tjetër banket personazhesh, i cili mund të të befasonte dhe ti të klithje: “Auuuu, sa i veçantë qenka ky njeri!”

Mepatjetër pilari i romanit “Shpirtra të shitur” është Aleksit dhe dashuria e tij me Irisin, një nga damarët që e mbush veprën me gjak e oksigjen. Përmasë Aleksit autori bën vizatime të kohës dhe sot, jep përthyerjet e karaktereve të njerëzve përmes pasqyrës së tij reflektive. Unë vlerësoj më shumë te ky roman dhe posaçërisht te kjo linjë, Aleksit, e përmes saj në gjithë hapësirën e shpjegimit, pikërisht atë pasion, atë vrullim shpirtëror që shpesh hovçohet gjer në ndezulli ndjenjash lirike e erotike prej shkrimtarit, dhe që herë tjetër shtrihet si nëpër delta duke e hapur vështrimin, gjykimin, arsytimin. Ka shumë të tilla narrativa te romani, ose thënë më drejtë “jo narrativa” (në pamjen e ngushtë teorike të termit), sepse ato janë dëshira për të arsyetuar mbi dukuritë e ndryshme, mbi botën, njeriun, pasionet, dashurinë, seksin, veprimet, mënyrën e sjelljes, kulturën, sistemin e vlerave, politikën, filozofinë e jetës. Kjo dëshirë jo njëherë e rrëmben autorin dhe ai i ikën konceptit klasik të subjektit, ndërtimit të rrëfjës si të tillë, dhe ka qejf të promovojë ide, përjetime, zjarrmi shpirtërore. Veçse duhet ruajtur sensi pasi herë herë mëgojëza lëshohet, suspansi bie dhe në jo pak faqe vërshojnë shpjegime që mund të ngjesheshin a të shkurtroheshin. Të parat ndonjëherë janë të ngathata, të dytat janë më të zhdërvjellta; ndihet aty vrapi, koreografia e fjalës dhe e ndjenjës, ritmi, bukuria, estetika e përshkrimit. Kjo cilësi mendoj se e rrit dukshëm vlerën e romanit si dhe vetë profilin e shkrimtarit përpara lexuesit dhe letërsisë që bëhet sot ndër ne.

Kleo Lati e ka mprehur penën gjatë rrjedhës së kohës, për të ardhur sot në cilësinë ligjërimore të këtij romanit. Si gazetar, shkrimtar e përkthyes me përvojë të gjatë, fjala ka bërë një kapërcim të dukshëm në shprehimësinë e saj, në mënyrën se si sintaksa bëhet bartëse e emocionit, ideve dhe sidomos e gjendjeve shpirtërore, më tej e narrativës. Ka një gjuhë të shkrifët, një begati leksikore. Këto e bëjnë leximin të këndshëm, edhe në rastet kur diku zgjatet me shpjegime a përsiatje, të cilat vijnë “ndryshe” por që në fakt janë invariante ngjarjesh dhe domethëniesh të njëra-tjetrës. Veçse kam dëshirë ta them se në roman lexuesi has koreografi të bukura ligjërimore dhe zjarrmi poetike që të joshin e ta ngrenë shpirtin lart. Po citoj veçse një syresh për dashurinë: “...ishte një ndjenjë e fuqishme dhe e madhe si qielli i paanë. E pasosur si shtrirja e shkretëtirës. E ngrohtë si përfaqimi. E ndritshme si diamanti. E gjallë si trupi. E virgjër si dashuria. E thjeshtë dhe e madhërishtme si fjala. E fuqishme si besimi. E bukur si ëndrra...”



1. "RIVIZITIMI" I HISTORISË

Pse?

Sipas një ideje të shprehur nga Linda Hutcheon, të përcjellë edhe nga Umberto Eco: nëse shpirti avangard i modernizmit shkoi deri në heshtje (te pjesa muzikore 4,33 minuta e amerikanit John Cage, nuk luhet asnjë notë, por vetëm tregohen përgatitjet e instrumentistit për të luajtur; te tablotë e piktorit Lucio Fontana, një sipërfaqe e lyster me ngjyrë çahet me thikë; shkohet vazhdimisht drejt heshtjes në letërsi me poezitë që i kemi quajtur konkretiste, apo mund t'i quajmë me kalkun nga anglishtja: poezi për sytë), postmodernizmi shfaqet me idenë që, për të mos shkuar deri në heshtje, duhet të "rivizitojmë" historinë.

Gjithashtu, te eseja *Letërsia e shterrimit* (1967), quajtur si *manifest i postmodernizmit*, shkrimtari dhe kritiku amerikan John Barth shprehet se mënyrat e shprehjes në letërsi janë konsumuar nga përdorimi, duke e deklaruar kështu veten dishepull të Borges-it dhe Nabokov-it, frymëzuesit realë të postmodernizmit. Me këtë qëndrim, së bashku me bashkëkohësit Donald Barthelme dhe Thomas Pinchon, ai e përjashtonte funksionin tradicional të letërsisë dhe të artit si pasqyrë ku pasqyrohej shoqëria, diçka e nisur në fakt nga modernizmi, por u thellua më shumë.

Pra, duhet të "rivizitojmë" historinë, veçse jo pa ironi dhe jo në mënyrë të pafajshme.

S?

Me Joyce-in, Eliot-in, Pound-in etj., modernizmi pat krijuar formën e tij të autoritetit, por postmodernizmi u prir drejt anarkizmit, të cilin duhet thënë se e gjeti te avangardat, bashkëshoqërueset e modernizmit. Nga pikëpamja antielitiste, antiautoritariste, egoiste, anarkike, ironike, e lojës vetëkonsumuese, e humorit të zi dhe parodisë, postmodernizmi duket si një zgjatim dhe larmi e avangardave historike. Kemi parë se: "Ready-made" vjen nga dadaisti Marcel Duchamp; se ideja e rastësisë është zbulim i dadaizmit, por edhe i surrealistit me doktrinën e "shkrimit automatik".

Pra, teknika e shkrimit mund të bëhet e farefisshme me tipe të "artit të gjetur", apo "ready-made": objekte gjoja të mrekullueshme të manipuluar prej koleksionimesh të përditshme, skarcitete dhe hedhurina të gjetura te vjetërsirat, hendeqet dhe dyqanet e antikuareve, diksionerë, dosje spiunazhi, sepse kur mediumi është gjuha, lënda e parë (prodhimi gjysmë i gatshëm) për këtë tip arti, natyrisht, duhet të nxirret prej klisheve, pamjeve demode dhe artikuleve të ndërprera.

Nuk ekziston më frika e ndikimit, por kënaqësia e ndikimit në parimin e kolazhit: ku gjëra të pangjashme ngjiten për të krijuar një realitet të ri, i cili mund të përmbajë një koment për realitetin nga ka dalë, si edhe mund të jetë shumë gjëra të tjera. Nënteksti filozofik i kolazhit dhe pastiche-it mund të shihet si mbrojtje ndaj "vdekjes së tregimit/romanit", sjellë prej prozës banale, të pavetëdijshme, shkurt, si talisman kundër kalbësirës.

Meqë kumtimet e një fakti përplasen me njëri-tjetrin pa ndonjë lidhje të dukshme, krijimet bëhen kryesisht një tekst. Teksti mund të ndërtohet prej gjërash të rastit, me një univers që është sajuar prej citatesh të nxjerra nga shumëllajshmëria e ligjëritit – gjuha e njoftimeve dhe gazetave, e librave të artit dhe traktateve, e filozofisë dhe teologjisë, e librave të vjetër dhe miteve, e vizatimeve dhe psikologjisë.

Ky instalim klasikisht antilettrar i gjuhës do të kthehej në letërsi erudite, për më tepër që prodhimi përfundimtar duhej të ishte i mrekullueshëm dhe elegant, ndonëse ka përbërës vulgarë dhe të shëmtuar.

GAZMEND KRASNIQI

SI MUND TË LEXOHEJ POSTMODERNIZMI me ndihmën e kritikëve dhe teoricienëve Linda Hutcheon, Brian McHail, John Barth, Umberto Eco, Gerard Genette, Roland Barthes, Matei Calinescu, Jean Baudrillard etj.



Sodoqoftë, kështu, vërtet postmodernizmi refuzon të bëjë dallime midis estetikës dhe joestetikës - e bukura në art ka ikur nga kuptimi klasik i fjalës - por mbetet më pak subversiv se modernizmi i avangardave, pasi vihet në dyshim motoja e radikalistëve avangardë: *shkatërro dhe shpik*.

Duke braktisur rregullat e tyre të rrepta dhe duke zgjedhur logjikën e *ripërtëritjes*, siç u tha më lart, postmodernizmi hyri në një dialog rindërtues me të vjetrën dhe të shkuarën dhe kështu lind i ashtuquajtura kodimi i dyfishtë (apo shumëfishtë), vepra flet në dy apo disa nivele njëkohësisht: lexuesi mund të shijojë njëkohësisht edhe traditën, edhe të renë, ku përdoren edhe kodet «e larta», edhe ato popullore.

Si modernizmi, edhe postmodernizmi ofron gjenealogjinë e shquar të paraardhësve, nismat e të cilëve mendon se e kanë çuar në pikën e pjekurisë dhe të shprehjes së vetëdijshme. Pranohet se *Borges-i* përshtati disa tipa trajtimi rrëfimesh që tani janë bërë shumë të njohura. Pikëpamja e tij mbi botën si labirint mundësish, kohësh paralele, të shkuarash dhe të ardhmesh alternative, ku të gjitha kanë të drejta të barabarta

për t'u paraqitur në prozën artistike – një pikëpamje që në mënyrë tepër ngacmuese është debatuar në tregimin me titull *Kopshti me shtigje që bigëzohen* - tani është kthyer në një nga parashtrimet kryesore të eksperimentalizmit rrëfimor postmodern.

Borges-i e liron plotësisht imagjinatën në citimin e mëposhtëm (që është tregimi nga *Kopshti me shtigje që bigëzohen*):

Në të gjitha krijimet fantastike, sa herë që njeriu ndeshet me disa mundësi, zgjedh njërin prej tyre dhe i asgjëson të tjerat. Në fantastikën e Ts'ui Pen-it të koklavitur, ai i zgjedh të tëra njëkohësisht. Krijon kështu ardhmëri të ndryshme, kohë të ndryshme që gëlojnë dhe bigëzohen. Që këtej rrjedhin kontradiktat e romanit. Fang-u, për shembull, mban një të fshehtë. Një i panjohur troket në derën e tij: Fang-u vendos ta vrasë. Natyrisht ka shumë zgjidhje të mundshme: Fang-u mund ta vrasë furracakun, furracaku mund ta vrasë Fang-un, të dy mund të shpëtojnë, të dy mund të vdesin etj. Në veprën e Ts'ui Pen-it ndodhin të gjitha zgjidhjet; secila është pikënisja e bigëzimeve të tjera.¹

¹ Borges, Jorge Luis. *Vdekja dhe busulla*. Onufri. Tiranë 2002, fq. 65

Diçka të përafërt me këtë ide e gjejmë të realizuar te tregimi "Para banjës", me të cilin Kadare donte të jepte vrasjen e Agamemnonit:

Ai iu afrua vaskës me ujë të ngrohtë, lëbyri sytë nga kënaqësia (sa herë e kishte ëndërruar këtë vaskë në tendën e ftohtë të fushimit!) dhe në çastin kur po fuste njërin këmbë në ujë, ktheu kryet nga e shoqja, që po i vinte pas. Ajo kishte ende në fytyrë atë buzëqeshjen pakëz të zhvendosur, po, më tepër se buzë-qeshja, atij i tërhoqi vëmendjen ndriçimi metalik i diçkaje, që vetoi midis pëlhurës, që e shoqja e mbante në dorë...

U gjend përsëri jashtë vaskës, si për të ndrequr gabimin dhe ashtu, si më parë, futi njërin këmbë në ujë, pastaj pa gruan që i vinte pas, dallooi ndriçimin e sëpatës midis pëlhurës, po s'arriti ta mblidhte mendjen, madje pa u tmerruar ende nga pëlhura, që iu kthye në rrjetë e i lidhi krahët, ndjeu goditjen e parë dhe pa gjakun që skuqi ujin...

U gjend përsëri jashtë vaskës, si për të ndrequr diçka, po këtë herë ngadalshëm, si ai që përpiqet ta shkoqitë gjakftohësisht keqkuptimin. Iu afrua vaskës, avulli i ngrohtë i së cilës e bënte më të largët çdo gjë dhe lëbyri sytë nga kënaqësia (Sa herë e kishte ëndërruar këtë vaskë në tendën e ftohtë ushtarake, kur i palarë e gjithë ngut bënte dashuri me robinat) dhe, në çastin kur po fuste njërin këmbë në ujë, ktheu kryet nga e shoqja, si të sigurohej që lumturia ishte fare pranë...

Ai u gjend përsëri jashtë vaskës dhe u nis drejt saj, ashtu si miliona herët e tjera për të përjetuar me ritme të ndryshme copëzën e fundit, gjithsej njëzet e dy sekonda të jetës së tij.

Në këtë mënyrë, para tekstit postmodernist u hapën disa mundësi:

Me shtresëzimet e shumëfishta kuptimore të subjektit dhe dinamizmin e strukturave që shoqërohen nga loja metagjuhësore, ironia dhe paradoksi, na vjen në mend ideja se në një Vepër të Hapur marrëdhënia klasike e shkakut dhe pasojës zëvendësohet nga një sistem forcash ndërsjellëse, një konstelacion ngjarjesh, një dinamizëm strukturash. Ndjejmë se ai diçka refuzon luksin e shpjegimeve të thjeshta, duke sfiduar me paradoksin dhe lojën metagjuhësore.

Teksti riorganizon diskurse të mëparshme të përfshira brenda koordinatave të qarta hapësinore dhe kohore të një kulture të caktuar. Teksti i fituar, duke e parë paqëndrueshmërinë dhe dykuptimësinë si vlerë strukturuese, arrin deri në kufijtë e paradoksit. Dykuptimësia dhe paqëndrueshmëria e konceptimit bën që diskursi i krijuar të endet në hapësirën midis të shenjtës dhe profanes, të ndaluarës dhe të lejuarës, konformizmit dhe blasfemisë.

Tabloja e fituar shfaq dyshimin tipik poststrukturalist rreth mundësisë së të vërtetës dhe paqëndrueshmërisë së kuptimit. Prandaj ajo kërkoi një kod tjetër leximi, sepse me paradoksin që përmban na fton jo të dimë më shumë, por të dimë ndryshe, pra, sfidon jo dijen dhe njohuritë tona, por mënyrat tona të të kuptuarit dhe të menduarit.

Hapësira topologjike nuk mund të kuptohet pa iu referuar fshehjeve dhe kontekstualizimeve të kuptimit që përpiqen njëkohësisht të shënjojnë domethënien e veprës, duke e bërë tablonë një hipertekst, pra, një tekst i krijuar nga tekste të tjera. Paradoksi, dykuptimësia dhe paqëndrueshmëria kuptimore e tekstit na mundësojnë lojën e lirë të mendimit, vetëdijesimin se konceptet dhe modelet e fosilizuara kulturore na pengojnë të pranojmë dhe të hapemi ndaj asaj që nuk dimë.

Gjuha e shkrimtarit modernist është e "shenjuar" prej impersonalitetit. Ai derdh kronikë, fabul, karakter, kohë, hapësirë, gramatikë, sintaksë, metaforë dhe krahasim,

përveç veçorive tradicionale të faktit dhe fiksonit. Çfarë përdor për të organizuar kohën-realistet, hapësirën dhe strukturën e gjuhës – shpesh është pa lidhje, por njëkohësisht edhe gjuhë: vështrësia “në përdorimin” e saj bëhet çështje e madhe e artit të tij. Më i dukshmi është refuzimi i tij për të qenë pasqyrim i vjetruar, me komentin sipër, i një bote të qëndrueshme, të jashtme.

Një postmodernist ecën pa rregulla për të shpikur rregulla, kufijtë ndërmjet zhanreve letrare janë bërë fluidë, prandaj fragmentarizmi bëhet një nga format kanonike. Përdorimi i dendur i fragmentarizmit lidhet edhe me bindjen se njeriu bashkëkohor ka një mënyrë jo të plotë, fragmentare të vrojtimit të botës. Fragmentarizmin kuptohet si “lojë me copëzat, me pjesët”: lineariteti i rrëfimit thyhet dhe rrëfimi realizohet nëpërmjet pjesëve, copëzave, enigmave, shkurtesave, mungesave, të pakryerave...

Teknika formale më goditëse e postmodernizmit është krijimi i *fundit të hapur* apo situatat qartas të pafiksuar. Nga kjo cilësi – e cila megjithëse gjithmonë fillon me një lidhje logjike jashtëzakonisht të përdorur, çahet dhe zgjerohet në pjesë të veçanta, të lëvizshme – njeriu nuk e ndjen që e ka “mbaruar” një tekst. Procesi krijues gjen zgjatim në shpirtin e atij që lexon.

Pra, ndodh përpjekja e bashkërenditur e tekstit dhe e lexuesit. Me fjalë të tjera, megjithëse vepra e përmban nëntekstin filozofik, është e kushtëzuar mjaft që, nëse nuk mund ta kuptosh, do ta ndjesh dhe këtu qëndron gjithë çështja. Stili unik, që nuk i rri besnik një qendre, është funksion organik i afërsisë me mendimtarë të tillë si Barthes-i, Foucault dhe Derrida, më tepër se sa një përpjekje e vetëdijshme për t’u ndeshur me dilemat e mëdha filozofike në vetvete².

Postmodernizmi thekson problemet që pasojnë në një botë të shmangur prej normave absolute dhe standardeve intelektuale.

Ato janë përgjigje për mungesën e besimit në zot (me urdhëresat e tij të padiskutueshme, absolutisht të drejta) dhe dobësimin e autoritetit religjioz. Gjitha vlerat bëhen arbitrare, gjitha pohimet barabar të vërteta dhe të reme.

Rezultati i pashmangshëm psikologjik është gjendja konfuze, ambivalenca e errët, terrori, neveria, paniku.

Nëse ka një sens optimizmi te vepra e postmodernistit, kjo nuk rrjedh nga besimi i njohur modernist se arti ofron mundësinë e ikjes nga rrëmuja e botës moderne, apo që arti mund t’i ndryshojë rrethanat ekzistuese;

² *Derrida* ndjehet tepër i irrituar nga arroganca totalitare që sheh te mëtimet e mendimit perëndimor ndaj nocionit të arsyes. Sidomos kur ky ka një kohëzgjatje 2500 vjeçare, duke filluar nga Platoni e Aristoteli, nga Kanti dhe Hegeli, nga Vitgenshtaini dhe Haidegeri, të cilën e sheh si konstante logocentrike. Ai sheh nën sipërfaqen e saj më shumë se një holokaust. Derrida-së i përket futja e idesë së dekonstruksionit, përkues me poststrukturalizmin, me të cilin do të thotë që kuptimit t’i qërohen, si një qepe, shtresat që e kanë ngritur dhe e mbajnë në këmbë. Ai ngul këmbë se asnjëherë nuk ka vetëm një kuptim. Ideja e tij gjen mbështetje tek ideja e Foucault-së për epistemologjinë, teoria e verifikimit të njohjes, që merret me dallimin e dijes së vërtetë nga sipërfaqësorja. Foucault-i përmbys konvencionin e historisë si diçka lineare, një kronologji e fakteve të pashmangshme e cila krijon një tregim që krijon kuptim. *Liottard-i* foli për zëvendësimin e narrativave të mëdha me ato të vogla, shumë kohë para se të binte komunizmi i vendeve të Europës Lindore, çka do ta bënte teorizimin e tij fare të prekshëm. Eklektizmin e kohës sonë ai e quajti “shkalla zero e kulturës së përgjithshme bashkëkohore”. Pra, mund të dëgjosh muzikë reggae dhe ndërkohë të shikosh filma hollivudianë vestern; mund të hash te McDonalds në drekë dhe pilaf tradicional në darkë. Dituria mund të merret te kuicet televizive. Kur thotë se është e lehtë të gesh publik për eklektiken, ai ka parasysh përfshirjen e kategorisë së të “ulëtës”, të cilën modernizmi e pat degdisur tej. Duke u bërë kic, arti i përgjigjet shijes së patronëve. Krijuesit, kritika dhe publiku shkojnë pas sloganit “gjithçka shkon”. Në mungesë të kriterëve estetike, mund t’i qasemi veprave artistike sipas përfitimeve që sjellin. Ky fenomen e ka marrë emrin “mass kulture”, që përgjithësisht vlerësohet si paraletërsi. Pra, ndryshe nga koha e modernizmit “e ulëta” ka fituar shumë terren. Postmodernizmi karakterizohet nga përpjekja për t’i bashkëshoqëruar këto dy kategori të kundërta.

ai i përqesh haptazi këto besime me këdo të tjera më moderne.

2. INTERTEKSTUALITETI

Në një dialog rindërtues me të vjetrën dhe të shkuarën, fenomeni i *intertekstualitetit* mundëson që letërsia të largohet prej formave tanimë të konsumuara dhe të sjellë forma të reja. Kopjet, intertekstet, paroditë - janë tema që kanë sfiduar konceptin mbi origjinalitetin dhe universalitetin.

Teoria e intertekstualitetit nisët nga bindja se teksti është polivalent dhe se, sipas Todorov, çdo vepër letrare krijohet përballë dhe kundrejt ndonjë modeli, çka e kemi parë disa herë në historinë e artit, por edhe nga romantizmi e këtej.

Nëpërmjet procedimit të dekonstruksionit apo poststrukturalizmit, shumë tekste të vjetra, që gërshetohen në tekstin e ri postmodern, funksionojnë si tekste të reja, por në çdo vepër të re hetohet zëri i veprave paraprake, sepse veprat postmoderniste janë vepra të koduara dialogjike, ku vërehen gjurmë nga tekste të tjera ose kontekste.

Raporti që teksti i ri vendos me tekste të tjera, vë në pikëpyetje autorësinë, duke thyer kështu iluzionin referencial dhe idenë mbi veprën autonome dhe origjinale që kishte trumbetuar me të madhe romantizmi.

Dimë se pas konceptit të “vdekjes së autorit”, apo “autorit-funksion”, që u bënë të njohura pas studimeve të R. Barthes dhe M. Foucault. lexuesit krijojnë kuptimet e veta nga leximi. Siç thotë Michael Foucault-i, kufijtë e librit nuk mbyllen te titulli, mes pikës së parë dhe asaj të fundit, mes trajtave të jashtme dhe autonome: libri kapërthehet në një sistem referencash me libra dhe tekste të tjera dhe bëhet një nyje brenda rrjetit. Gjë që do ta shpjegonim kështu te romani *Tiranë - Vjenë - Tiranë* (Trilogjia e Shkodrës):

Intertekstualiteti thërret vepra të një trashëgimie të përbashkët, që zgjojnë ndërgjegjen e lexuesit dhe e bëjnë të vetëdijshëm për këtë përmasë. Kujtesa e veçantë bashkohet me kujtesën e përbashkët si shfaqje e gjallërisë dhe e vazhdimësisë së një tradite. Ky intertekst synon të mbajë pezull kuptimin e tekstit, duke shfaqur dykuptimshmerinë e domethënies

letrare, që, sipas poststrukturalistëve, kërkon bashkëpunimin e lexuesit.

Ndërhyrja e citimeve, aluzioneve dhe referencave e çojnë lexuesin në shtigje të reja, duke e thyer njësinë fillestare, për t’u bërë dominante heterogjenia – larmia e tipave të diskurseve. Huazimet e ligjshme apo të paligjshme duan të provokojnë: fakti që mund të thërrasim në lidhje me një vend a person një shumësi tekstesh, tregon qenësinë e përhershme dhe gjallërinë e letërsisë.

Lexuesi kalon nga citueshmëria moderniste e Eliot-it – i cili i shoqëron ato me shënime të shumta – te *ironia intertekstuale*, sipas Umberto Eco, ku citueshmëria bie, duke parakuptuar një lexues më të kualifikuar.

Kjo metodë, apo formë e mishërimit të tekstit – shkrimi që sjell, në mënyrë të pandërgjegjshme apo jo, tekste apo burime tekstesh të tjera në tekstin e planit të parë - e quajtur sot intertekstualitet, apo hiper-tekstualitet, jep pranëvëniet, ndërftjet dhe mbivendosjet, të cilat e krijojnë referimin me termat e dy akteve:

Aksi horizontal lidh autorin dhe lexuesin e një teksti;

Aksi vertikal lidh tekstin me tekstin.

Duke e parë si strukturë, njësimi i dy akteve nxjerr se çdo tekst dhe çdo lexim lejon futjen e një bote tjetër (e disa botëve të tjera), duke i dhënë hapësirës mundësi paradoksale, ku janë pranëvënë elementet më kontradiktore, për të dhënë efektin e parodisë – lojën me stile të njohura. Duke e parë si kohë, ai i jep mundësi që periudha të ndryshme të futen brenda njëra-tjetrës në të tashmen e thjeshtë. Një organizim i tillë u bën jehonë fjalëve: “...jetojmë në epokën e njëkohësisë, në epokën e mbivendosjes...” dhe leximi zbulon praninë e

heterotopisë, koncept që e sheh hapësirën si thelbësisht heterogjene, ndërtuar nga mbivendosja apo pranëvendosja e hapësirave që u përkasin regjistrave të ndryshëm,

heterokronisë, koncept që përmban bashkekzistencën e disa regjimeve të kohës në një hapësirë të vetme, qoftë kjo fizike, utopike apo virtuale. Siç shpjegon Michel Foucault-ja, është tipar thelbësor i epokës sonë të karakterizohet nga ndërveprimi dhe bashkekzistenca e njëkohshme e hapësirave dhe regjistrave kohorë të

papërputhshëm me njëri-tjetrin.

Sot dimë se ky është çasti kur merr fuqi të plotë lexuesi (Barthes): konkretisht, lexuesi i nivelit të dytë (Eco), pasi vetëm ky mund të kapë të fshehtën dialogjike. Kjo ironi ndërtekstuale duhet pranuar si provokim dhe ftesë për përfshirje, e cila pak nga pak mund ta shndërrojë edhe lexuesin naiv (të nivelit të parë), atë që kërkon të marrë vesh për fatin e personazheve, në një lexues që fillon të kapë aromën e teksteve të tjera paraprirëse dhe të ndjejë *hipertekstin*, të cilin Roland Barthes-i e përcakton

si një tekstualitet ideal, i cili, i kompozuar nëpërmjet shumë rrugëve, kanaleve ose nyjave me fund të hapur, zotëron një sistem të tërë domethëniesh dhe kuptimesh.

Të cilin Michael Foucault-i e përcakton si një lloj fusnote e “pamarkuar”, por që dallon prej saj nga vendi që zë në tekstin e dytë, pasi nuk është marrë nga një tekst, por disa të tillë, duke paraqitur një mundësi për një tregim jolinear që zbut kufijtë mes lexuesit dhe shkrimtarit.

Apo *hiper-realistin*, për të cilin Gerard Genette-i thotë se:

nënkupton raportin që ofron një tekst B (që do ta quajë hipertekst) me një tekst paraprak A (që do ta quajë hipotekst).

raporti i hipertekstualitetit shfaqet kur teksti B vendos çfarëdo lidhje ose mbështetet, në mënyra të ndryshme, në tekstin A.

Për të cilin Jean Baudrillard-i thotë se paraqet një realitet që duket më real se vetë realiteti.

Në veprat postmoderniste, shpesh, s’ka as fikson e as realitet, por vetëm hiper-realistet. Paraqitja që nuk e paraqet realitetin, por e modelon atë, çon te estetika e simulakrës, mungesa e realitetit bazë, e teorizuar nga Baudrillard-i. Ajo gjen mbështetje të marrëdhënia me stilet, diskutet dhe semiotikat e gjuhëve të ndryshme të kulturës.

Ky është simulakrumi, shkatërrimi përfundimtar i kuptimit.

Në këtë mënyrë, krejt pandërgjegjshëm, historia dhe fikcioni ndryshojnë vendet:

historia bëhet fikionale,

fikcioni bëhet historia e vërtetë.

Aristoteli (babai i mimesit) e pati kuptuar se forca e artit na mundëson zgjedhjen atje ku jeta na e privon atë. Me një lëvizje si kjo humbet bota reale (Postmodernizmi do të shtonte pyetjen: në raport me çfarë?!), por është e mundshme të fitohet një tekst, i cili në kohën tonë karakterizohet nga forca përmbysëse ndaj klasifikimeve të vjetra. Ai është një proces demonstrimi, i cili flet sipas rregullash të caktuara (ose kundër rregullash të caktuara), si dhe mbahet në gjuhë, vetëm në lëvizjen e një ligjërimi.


Në krahasim me lëndën e planit të dytë (e cila është në kujtesën dhe edukimin e lexuesit) një poet që rropatet për mbijetesë - lënda e planit të parë (histori apokrifë, të cilat e shohin përmbajtjen e kujtimit historik duke e riinterpretuar dhe, përgjithësisht, duke e demistifikuar versionin e parë ortodoks) mëton të ngrihet si një seriozitet i ri, si një autenticitet i ri, të cilët zëvendësojnë seriozitetin dhe autenticitetin e prerë mimetik (imitues).

Bashkë me Roland Barthes-in, estetin e mirënjohur francez, por edhe me narratorin, do të thoshim:

Gjuha nuk është ngarkuar të shprehë kohën. Roli i saj është të shpjerë realitetin në një pikë dhe, nga shumësia e kohëve të jetuara dhe të mbishtresuara, të abstragojë një akt verbal të pastër.

Gjatë këtij procesi, me paaftësinë e afirmimit të ekzistencës së një shembulli narrativ (gjithë ato prerje dhe fshirje), autorit postmodernist i mbetet të ringjallë ironinë romantike ose, siç përdoret më shumë sot, metafiksionin. Ky mjet, i përdorur herë pas here, atij shërben për t’i thënë lexuesit:

Je në një fikson!



Para disa javësh, gazetata jepnin lajmin e turbullirave të mëdha në Shqipëri; telegrame nga Roma e Beogradi, duke i zmadhuar gjërat sipas qejfit, paralajmëronin një kryengritje të përgjakshme, marrjen e Tiranës (kryeqytetit të Shqipërisë) nga kryengritësit dhe hyrjen e tyre në Durrës.

Edhe pse gjërat janë ekzagjeruar së tepërmi, ngjarjet nuk kanë munguar të jenë mjaft të rënda: nga data 8 deri në 15 mars, qeveria, shteti dhe vendi kaluan çaste të këqija, duke qenë se Shqipëria, ashtu sikurse pjesët e tjera të Ballkanit, është e banuar nga një popull me pasion politik shumë të forta dhe me reagim shumë të shpejtë. Ja me pak fjalë se çfarë ka ngjarë:

Qysh në muajin dhjetor 1921, një farë grusht shteti përmbyste kabinetin e Pandeli Evangjelit dhe sillte në pushtet Hasan Prishtinën. Dhoma e deputetëve ishte me pushime; por krejt popullsia shfaqti pakënaqësinë e vet, funksionarët filluan grevën dhe nga tërë anët e vendit u shfaq keqardhja për një ndryshim të tillë. Kabineti i Hasan Prishtinës ra pas katër ditësh dhe me kthimin e deputetëve në detyrë, qeveria aktuale nën kryesinë e Xhafer Ypit erdhi në fuqi. Gjithçka dukej se po ecte mirë. Por fajtorët e grushtit të shtetit të dhjetorit të shkuar duhej të dilnin para gjyqit dhe për ta parashikohesh ndëshkim. Rrjedhimisht, u shfaq këtu një element i dëmshëm në vend, të cilit i duhet shtuar një tjetër element, në mos antipatriotik, të paktën i hallakatur dhe i futur në qorrsoak: ai i të pakënaqurve për vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, konkretisht ata që ankoheshin se Protokollin e 9 nëntorit 1921 i zvogëloi edhe një herë kufijtë e Shqipërisë në favor të Serbisë.

Në fakt, qysh më 1913, koncesione shumë të gjëra u bënë Serbisë, që vuri nën sundimin e saj krahina të tilla si ajo e Kosovës dhe e Maqedonisë Perëndimore banuar nga një popullsi me shumicë dërrmuese (80 deri në 90 %) shqiptare. Pos kësaj, nga fundi i vitit 1918 deri në fund të vitit 1921, domethënë nga koha e armëpushimit deri në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Serbia shkeli kufijtë shqiptarë të njohur në Londër (1913) dhe shkretoi krahina të tëra, gjë që shkaktoi eksod dhe vuajtje, duke i shtuar elementit tashmë të pakënaqur një kontingjent të ri.

Këta të pakënaqur akuzonin për dobësi qeverinë e Tiranës dhe mendonin se duke e përmbysur, mund të shpëtonin copëza territori shqiptar mbetur nën sundimin serb. Këtyre dy fraksioneve u shtohesh një i tretë, ai që e kishte parë veten të zhveshur nga pushteti në muajin janar 1920.

Na duhet të bëjmë pak histori për të sqaruar këtë pikë:

Dihet se gjatë Luftës së Madhe Shqipëria u pushtua nga luftënxitësit, duke u bërë pa dashje shesh lufte. Pas armëpushimit, trupat italiane e shinin veten zot të krejt Shqipërisë; trupat serbe ishin ndalur në vijën e quajtur *vija e armëpushimit* e përcaktuar nga gjenerali Franchet d'Espéray mu brenda territorit shqiptar. Në muajin dhjetor 1919, një mbledhje e mbajtur në Durrës krijoi Qeverinë e Përkohshme, mbi të cilën Italia pretendonte se ushtronte kontroll dhe një lloj tutele.

Për të hequr qafe këtë ndikim italian, shqiptarët organizuan një mbledhje të gjerë në janar 1920, në Lushnjë, në përfundim të së cilës doli një qeveri kombëtare me prirje të hapur nacionaliste. Nëpërmjet saj, shqiptarët donin të shkëputeshin nga ëndrra e keqe e klauzolave të Traktatit të fshehtë të Londrës (1915), sipas të cilave Shqipëria ishte e dënuar të ndahej midis Italisë, Serbisë e Greqisë. Po ashtu, nëpërmjet krijimit të Qeverisë Kombëtare, shqiptarët shpallnin vullnetin e tyre të ruanin pavarësinë e vendit, si dhe dëshirën për të jetuar në harmoni me shtetet fqinje.

Mirëpo, për të përmbysur Qeverinë e përkohshme të Durrësit dhe për të krijuar Qeverinë kombëtare të Lushnjës, nuk mund të shmangej një numër i vogël personash të pakënaqur dhe pikërisht mes tyre u rekrutua një element i tretë reaksionarësh.

Lumo Skëndo

GJENDJA NË SHQIPËRI NË MOTIN 1922

Nga Uran Butka


Mid'hat Frashëri (Lumo Skëndo), kur ishte kryetar i Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, bashkëpunonte me shumë shtëpi botuese, agjenci të njohura, redaksi gazetash e revistash të Francës, Zvicrës, Anglisë, Italisë, etj, ku botonte artikujt, studimet, informacionet për Shqipërinë, replikat, përgënjeshtimet, debatet, në mbrojtje të çështjes shqiptare te gazetatat "The Near East", "International Review", "East Europa", "Mercure de France", "Le Monde Nouveau", "Revue Universelle", "France Orient", "Frobenius", "Corriere delle Puglie", "L'Indipendance albanaise", "Tribune libre des nationalites", "Loa revue de Geneve", "Les Peuple Libres", "Le Vie des Peuples", "La Mercure Suisse", "The New Statesman", "Foreign Affairs", "L'Humanite" etj.

Mid'hat Frashëri ishte një parashikues gjenial.. Ai ishte i bindur që çështja shqiptare e shtruar për zgjidhje për më se një shekull, do ta gjente më në fund atë, sepse nuk ishte vetëm një çështje e brendshme e Shqipërisë, por një problem kyç i Europës Juglindore dhe më gjerë. "Zhvillimi i ngjarjeve në Ballkan vërteton mirë se ngjarjet në Shqipëri nuk janë aspak të brendshme, por janë pjesë e një të tërë me rëndësi botërore, që do të ketë efekte të mëdha ndërkombëtare në kohën e ardhme"- thoshte ai.

"Për mua ka vetëm një mënyrë që të normalizohet gjendja në Shqipëri: mbajtja e lidhjeve me lëvizjen demokratike evropiane dhe rregullimi i marrëdhënieve mes vendeve të Ballkanit.

Në shkrimin problematik "Gjendja e Shqipërisë në vitin 1922", botuar te periodiku francez «Le Monde Nouveau» më 21 prill 1922 ai jep një panoramë të shkurtër të gjendjes së brendshme të Shqipërisë në rëllacion me vendet e tjerë të Ballkanit, duke theksuar se Shqipëria po i kapëcen rebelimet e shkaktuar nga interesat e huaja dhe ka hyrë udhën e paqes dhe sabilitetit.

"Ngjarjet që u zhvilluan gjatë muajit mars provuan se elementi patriotik ngadhënjëu më së miri ndaj elementit turbullues. Megjithatë, nuk duhet harruar se Shqipëria është një vend i pasioneve të forta dhe se opinionin publik është shumë i vështirë për ta udhëhequr e kanalizuar", shkruante Lumo Skëndo..



Turbullirat ndodhën midis 8 dhe 15 marsit 1922 dhe ngjarjet u zhvilluan shumë shpejt. Rebelët kishin përgatitur terrenin, duke propaganduar se përmbysja e qeverisë aktuale do të sillte çlirimin nga zgjedha e huaj të një krahine të madhe shqiptare; dhe për t'ia arritur më mirë qëllimit, ishte nxjerrë si pretekst mbledhja e një kuvendi kushtetues.

Lëvizja filloi të zbrësë nga Veriu me një bandë nën urdhrat e Bajram Currit, nga rajonet mbi Drin, në Lindje të Shkodrës; por përpara urtësisë që tregoi popullsia e këtij qyteti, e cila kundërshtoi të merrte pjesë në lëvizje, rebelët u detyruan të ktheheshin në shtëpitë e tyre, pa bërë asnjë shfaqje tjetër.

Një bandë tjetër, e drejtuar nga Halit Lleshi (major në ushtrinë serbe), u nis nga krahinat në Perëndim të Dibrës dhe marshoi mbi Elbasan; u thye në Veri të këtij qyteti nga milicia.

Të pasnesërmen e këtij luftimi, një tjetër bandë, e drejtuar nga Isuf Elezi, zbriste nga malet në Lindje të Tiranës; ajo ndeshi fillimisht një çetë të vogël xhandarmërie nën komandën e majorit Meleq Frashëri, i cili u vra dhe rebelët hynë në një lagje të kryeqytetit. Qeveria organizoi mbrojtjen dhe luftimi brenda në

qytet zgjati pesëmbëdhjetë orë. Duke qenë se mbërritën forca vullnetare, rebelët dorëzuan armët dhe u arrestuan. Thuhet se ministri i Britanisë së Madhe në Tiranë u dha të dyja palëve këshilla për vetëpërbajtje në këto rrethana të vështira.

Ndërkohë që banda e Elezit po nënshtrohej, një tjetër lëvizje shpërthente në qytetin e vogël të Shijakut dhe në Durrës, e kurditur kjo, nga të afërm të të ndjerit Esat pasha; por as kjo bandë nuk pati të nesërme dhe milicët u kthyen pothuaj pa hasur pengesa në këta dy lokalitete.

Filloi menjëherë çarmatimi, operacion tashmë i nisur para se të lindte lëvizja kryengritëse dhe që ndoshta kishte ndihmuar në përsheptimin e kësaj lëvizjeje.

Rreth dhjetë persona u dënuan me vdekje nga Gjykata Ushtarake dhe u ekzekutuan. U arrestuan edhe fajtorët të tjerë, që janë në gjykim.

Qetësia u rivendos më 14 mars.

* * *

Qeveria e mposhti lëvizjen rebele pa shumë tronditje. Çeta vullnetarësh rendën menjëherë nga të katër anët, sidomos nga rrethet jugore të Korçës e Gjirokastrës. Mirdita, ku serbët ishin përpjekur më kot të krijonin një lëvizje artificiale gjatë verës së vitit 1921, mbajti një qëndrim të hapur në përkrahje të qeverisë. Shumica e komunave i pajisën trupat vullnetare me krejt mjetet e nevojshme dhe me shpenzimet e tyre.

Aktualisht, gjendja e brendshme duket e kënaqshme. Megjithatë, duhet theksuar se, që të shtypje një lëvizje, nuk ishte gjë e lehtë në një vend ku pothuaj të gjithë ishin të armatosur. Streha që kanë gjetur një numër keqbërësish në Itali e Serbi vazhdon të shkaktojë njëfarë shqetësimi.

Qeveria shqiptare nga ana e saj po punon tani të rregullojë marrëdhëniet e veta me fqinjët, të rivendosë me ta lidhje diplomatike, duke qenë se Fuqitë e mëdha e të vogla nuk deshën të rilidhnin me Shqipërinë marrëdhëniet zyrtare të vendosura më 1913. Si pasojë, që prej Kongresit të Lushnjës, qeveria kombëtare ka vuajtur shumë dhe vetëm më 9 nëntor, Konferenca e Ambasadorëve vendosi të njohë qeverinë shqiptare. Sot 13 shtete i janë bashkëngjitur kësaj njohjeje dhe konkretisht: Franca, Britania e Madhe, Japonia, Italia, Belgjika, Zvicra, Bullgaria, Rumania, Serbia, Finlanda, Luksemburgu, Austria dhe Suedia. Por, vetëm Britania e Madhe është zyrtarisht e përfaqësuar nga një Ministër Fuqiplotë në Tiranë.

Rilidhja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet fqinje do t'i japë stabilitetin qeverisë shqiptare dhe do të parandalojë këtej e tutje kontrabandën e armëve. Nga ana tjetër, Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve, i cili duhet të caktojë në terren vijën e re të demarkacionit të parashikuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris, ndodhet në Shkodër dhe ka nisur punën në fillim të muajit mars. Po ky komision ka si detyrë të mbikëqyrë evakuimin nga Greqia të një territori të vogël, që ndodhet në Jug-Lindje të qytetit të Korçës, arbitrarisht i pushtuar nga trupat helenike; tërheqja e grekëve do sjellë menjëherë përmirësimin e marrëdhënieve midis dy shteteve kufitare, marrëdhënie që, për më tepër, nuk kanë marrë asnjëherë një karakter ashpërsie, pavarësisht nga humori i keq i shfaqur shpesh nga Greqia.

Si të rregullohen këto çështje të mbetura pezull midis Shqipërisë dhe fqinjëve, a do të njohë vallë qetësinë dhe stabilitetin shteti i ri në brigjet e Adriatikut?

Ngjarjet që u zhvilluan gjatë muajit mars provuan se elementi patriotik ngadhënjëu më së miri ndaj elementit turbullues. Megjithatë, nuk duhet harruar se Shqipëria është një vend i pasioneve të forta dhe se opinionin publik është shumë i vështirë për ta udhëhequr e kanalizuar.

Të papritura të vogla mbeten, pra, ende të mundshme për të ardhmen

“ËRRËSIRA” E OLTSEN GRIPSHIT SI METAFORË METAFIZIKE E KUJTESËS

Për herë të parë tuneli atomik që gjendet në oborrin e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve të Sigurimit të Shtetit “Shtëpia me Gjethe” u shndërrua pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve në një hapësirë ekspozuese. Kjo falë artistit bashkëkohor Oltsen Gripshi, i cili nëpërmjet gjuhës së tij artistike ka tentuar të zbërthejë errësirën si qasje filozofike dhe si simbolikë e së shkuarës para viteve '90. Një ekspozitë konceptuale sa e veçantë për nga gjuha pamore me të cilën kërkon të komunikojë, aq dhe kuptimplotë për nga aspekti përmbajtësor.

Artisti Oltsen Gripshi me errësirën nxit dëshirën për të dalë nga ajo. Errësira për të është zbrazëtia, ku qenia njerëzore shkëputet nga ekzistenca fizike, aq sa brenda saj ajo humbet orientimin në kapërcyell midis dy përmasave: reales dhe metafizikes. Sipas artistit Gripshi këtë njëj teorike e shohim të materializuar në mendimin utopik të Ernst Bloch, i cili ka arritur të shkojë përtej pikëmbështetjes së tij, duke pohuar se errësira është *desiderium* dhe e vetmja cilësi e sinqertë e qenies njerëzore e pazbuluar mirëfilli.

Ekspozita përbëhet nga një kompleks intim i zonave të errësirës dhe dritës të vendosura në rrugën që mund të imagjinohet si rruga e të vërtetës, plot pengesa, si sprova që duhen kapërcyer për të arritur njohjen, dijen.

Zbritje në thellësinë dhe errësirën e së shkuarës, frikë, një rrugëtim disi i rrezikshëm plot zikzake ku ndeshen simbole dhe fytyra gjysmë të fshehura, të tjetërsuara e të deformuara nga dhimbja e nga vuajtjet. Një rrugëtim që ngjall ankth. Duket si një rrugëtim i mundimshëm në kërkim të së vërtetës. Megjithatë, misteret e realitetit zbulohen papritur, në mënyrë të njëpasnjëshme; ankthi ngecet në vend dhe drita e dijes, e njohjes së të vërtetës duke grisur errësirën, tregon rrugën dhe jep shpresë.

Gjithsesi rrugëtimi në “Errësirë” i Oltsen Gripshit nuk është vetëm rrugëtimi ynë i përbashkët si shoqëri shqiptare në të kaluarën e errët komuniste. Ai është gjithashtu një rrugëtim në subkoshiencën e secilit, në anën e errët të personalitetit tonë, hijes tonë të brendshme që duam ta injorojmë, me vetëdije ose pa vetëdije, ndoshta, thjesht sepse nuk pranojmë lehtësisht gabimet dhe mangësitë tona! Në fund vërejmë se ky rrugëtim shërben dhe për zbulimin e vetvetes.

Në këtë ekspozitë ne përballemi me errësirën e botës sonë të nëndheshme. Ecim vazhdimisht drejt njohjes së të vërtetës për të arritur lirinë tonë. Sepse dija dhe e vërteta na bën të lirë, përdërisa vazhdojmë të kërkojmë, të dimë, të kuptojmë historinë tonë dhe atë të botës, mënyrë kjo për t'i dhënë kuptim jetës sonë.

Dr. Etleva Demollari

Kuratore e ekspozitës
Fotot nga Blerina Zela



FLOBERI

Kisha botuar një tregim në një revistë letrare dhe në këto raste, njeriu kërkon një opinion. Në përgjithësi, opinionet mungojnë dhe stisen kur nuk gjendesh ti në praninë e personave që i shqiptojnë ato. Unë gjithnjë rri me shkrimtarin AT, i cili është i ditur dhe i rreptë në gjykime, edhe pse ka një prirje nihiliste, nuk mund të them se nuk e pëlqen të bukurën. Lexon, shkruan, komenton tregimet e veta në një rreth miqsh. Shpesh ia kam treguar disa tregime të miat dhe më ka bërë vërejtje. Disa vërejtje ia kam pranuar, por shumicën jo. Atëherë me sjell një episod nga jeta e Mopasani që ia çonte tregimet Floberit dhe ky i fundit i thoshte: Grisi nuk bëjnë! Vetëm kur Mopasani botoi tregimin "Topi me dhjamë" dhe mori famë, u tha se kjo ishte leje e Floberit. Shkrimtarët shkruanë dhjetë tregime dhe duan t'i botojnë të dhjeta. Po kështu poetët, po kështu muzikantët, këngëtarët e ç'të them. Inflacioni edhe banalja e vret artin. Floberit shkruante një mijë faqe dhe botonte treqind, për një roman, ndërsa sot quhet roman një ngjarje dashurie, ca përshkrime eseistike mbi veprimet e personazheve që sillen si hije, që s'janë as konvencionalë. Nuk përshkruhet mjedisi, kontraktikat, nuk ka dramë, ka fjalë të përsëritura. Tregimi është si zari, thotë Çehovi, hidhe, nëse nuk ngec, atëherë ai është i mirë. Ndryshe!...

Këto mendime i shtellojmë përditë. Shkrimtari AT, si i vjetër, ka lexuar shumë dhe thotë se nuk bën kompromis në kurriz të artit, por le të kthemë te tregimi im.

- Grise, - thotë ai, - nuk bën!

- Si ta gris, ai është botuar?

- S'duhej ta kishe botuar, pa ta parë unë!

Nuk më pëlqyen fjalët e tij. Edhe unë e kam një vetëdije estetike, por e kam mësuar veten që ta dëgjoj me respekt dhe shumë herë i kam dhënë të drejtë, edhe kur ai nuk ka pasur. Nganjëherë më pëlqen që ai kënaqet kur i përkaht mendimi, varësisht ka apo nuk ka të drejtë. Edhe mua më pëlqen tek e shoh të kënaqur, dhe kjo është një lojë trilli, por duke mos e kundërshtuar, a mos vallë nuk po tregohem i sinqertë me të? Nganjëherë mungesa e sinqeritetit është aq e padëmshme si një shi që lag tokën e etur.

Po atë ditë në mbrëmje, të dy po merrnim pjesë në një mbrëmje letrare. Para dy ditësh, AT kishte botuar një tregim. Ai po rrinte me studiuesin dhe kritikun e shquar VB. Unë nuk e njoh VB personalisht, por u afrova.

- Më falni, - tha studiuesi, - por, më thoni emrin?...

U prezantova.

Studiuesi VB e la gotën e verës në tavolinë dhe ma dha dorën.

- Gëzohem që të njoha. Sot kam lexuar një tregim të bukur nga ty!

Unë u skuqa.

- Po po, -tha AT, vërtet tregim të bukur ka shkruar, por unë ia kam dhënë lejen ta botojë!...

TESTI

Ajo ishte një vajzë hollake, me një vështrim të qetë, por inteligjent. Sa herë e pyesja në mësim më jepte përgjigje të shkurtra, nganjëherë aq befasuese, sa më habiste. Nuk ngurroja t'ia vija notën maksimale dhe për këtë ndieja një kënaqësi, e cila më lehtësonte goxha ndërsa pyesja nxënës të tjerë që jo vetëm nuk përgjigjeshin, por vazhdonin të këmbëngulnin duke mos hapur libra e duke mos lexuar gjë.

Atë ditë sapo shpërndava testet e lëndës dhe pashë sesi nxënësit përkulën kokën dhe u përqëndruan në letër. Unë si gjithnjë rrija diku, përpara klasës duke hedhur vështrimin herë-herë tek ndonjë i pavëmendshëm ose që bënte përpjekje të merrte falas nga shoku

TRE TREGIME

NGA QAZIM SHEHU



ndonjë qarkim të përgjigjeve që duhej t'i jepte ekzaktësisht. Çdo tentativë që niste për shkëmbim fjalësh ndërpritej në çast dhe binte qetësia e murmurime zhdukej. Sytë më vajtën te Mira. Ajo nuk po shkruante. "Si ka mundësi, mendova, ajo këtë test e zgjidh për pak kohë". Në fillim nuk i fola, por pas pesë minutash e vura re sërish. Mira nuk po shkruante. Kishte vënë stilolapsin mbi fletën e bardhë dhe ishte skuqur. Mos kishte ndonjë hall, ndonjë brengë? Edhe nëse nuk e bën tani, ajo mund ta kryente testin herës tjetër. Nxënësi duhet njohur, mendova. Por fytyra e saj nuk shprehte gjë. Vetëm ishte skuqur pakëz, dhe skuqja nuk tregonte brengë. "Ec e kuptoje këtë gjë", mendova dhe bëra një ecejake kot nëpër klasë. Ndërkohë ca nxënës të dobët kishin përfituar nga kjo dhe i kishin transmetuar me njëri-tjetrin ca të dhëna zgjidhjesh. Kur u ktheva vura re sesi lëvizën me shpejtësi dhe murmurime u ndërpre. Mira ndodhej vetëm në bangë. Shoqja e saj atë ditë mungonte. Njëri nga djemtë më kërkoi leje të ulej me të. Ai nuk po e duronte shokun e bangës, i cili po e pengonte. I fola djalit tjetër, por Gimi këmbënguli. "Ulu!", i thashë.

Ai u ul pranë Mirës dhe bëra lëvizjen e zakonshme duke vëzhguar me kujdes sa majtas djathtas. Unë e di që Mira nuk do t'i tregojë gjë, mendova, ajo nuk e bën këtë, sepse është vajzë e ndërgjegjshme dhe nuk e pashë më bangën e saj, por kur ktheva vështrimin vura re se Mira po qarkonte pyetjet e testit të Gimit. "Po kjo, mendova, ndërsa nuk iu afrova afër, vetëm se i hodha një vështrim të pjerrët. Ajo nuk më pa dhe vazhdonte me ndërprerje të zgjidhte ushtrimet e Gimit. "Si mund të gabojë kjo vajzë, mendova, ajo është një nxënëse e mirë. A mund të ndihmohet shoku kështu?"

Iu afrova bangës dhe mora në duar testin e Gimit.

- Si shumë paske shkruar ti Gimi! -thashë. Ti nuk e ke nxirë ndonjëherë fletën kështu. Asaj nuk i rashë në sy. Le ta kuptonte vetë.

- Kam mësuar, profesor.

- Atë dua edhe unë, të mësosh, por bën mirë ta dorëzosh fletën!

Ai nuk reagoi. Unë lëviza tutje për të ndenjtur afër një nxënësi i cili më kërkoi një shpjegim për kuptimin e një pyetjeje. Ia shpjegova. Pastaj u ktheva. Gimim nuk po shkruante më. Mira kishte ulur kokën dhe kur e ngriti atë ishte skuqur dyfish. Më bëri përshtypje vështrimi i saj i përhumbur. Ajo e kishte kuptuar që unë e pikasa mirë veprimin e saj, e mbase për këtë u skuq edhe më. Kur ra zilja e mbarimit të orës, nxënësit dorëzuan testet dhe ndër të parat ishte Mira. Fleta e bardhë dhe e vetmja gjë e shkruar në të ishte emri i saj.

-Profesor, më tha, unë nuk jam përgatitur. Vër katër!

Unë heshta. Ndoshta me heshtjen time i dhashë të kuptonte se kjo gjë ishte normale dhe ajo nuk kishte pse ta thoshte ose ndoshta ta lija atë të reflektonte më shumë për gjestin e saj jo të mirë.

Isha i shqetësuar se çdo të bëja me atë test. Kur i shpërndava testet e korrigjuara, e ngrita Mirën në mësim dhe e pyeta për të gjitha kërkesat e tij. Ajo u përgjigj në mënyrë perfekte ashtu siç kishte ndodhur në çdo orë mësimi. Gimi e kishte kapërcyer pragun e një note kaluese, kuptohet me ndihmën e Mirës. Duhej t'ia vija atë notë. Ishte edhe gabimi im, që nuk ia mora fletën.

-Ti, Gimi, - thashë, -kujdes herë tjetër. Nuk është Mira që duhet të nxjerrë ty në breg, duhet të dalësh vetë, ndryshe mbytesh...

IDENTITETI

Ishte rastësi njohja jonë. Ai sapo ishte kthyer nga Greqia. Kishte të veshur një kostum të kaltër dhe në qafë mbante një zinxhir të hollë floriri. Më tha të ulesha në tavolinën e

tij dhe nuk e di pse ma bëri këtë ftesë, por, nganjëherë njerëzit ftojnë kot, ngaqë kanë një prirje të brendshme ta konsumojnë një gotë apo një kafe me ndonjë, qoftë ky edhe i panjohur. Sesi mund të bëhet biseda me një të panjohur, kjo, në fillim, të jep vështirësi të kuptueshme në rrjedhën e ngecjes së mosnjohjes, por gjithmonë gjendet një shteg, dhe kjo është krahina. Mbase tjetrin e pyet nga është, atëherë fillon dhe e pyet për krahinë e tij, dhe, nëse je i lexuar, i flet për historinë e saj dhe kur ai nuk e di aq mirë, me gjërat interesante që i tregon, e afron atë më shumë. Mund të ndodhë që edhe për ndonjë njeri të cilin e njeh nga ajo zonë, të qëllorësh kushëri i tij. Dhe rrjedha e bisedës merr vrull e, pa dashur apo natyrshëm, bëhesh mik me të.

Ai më tha se quhej Pjetër dhe ishte nga Mirdita. Kishte mbi njëzet vjet që punonte në Greqi. Vinte shpesh në atdhe, sidomos tani, sepse me të gjitha dokumentat ishte në rregull. Pastaj filloi të më tregojë për fillimet e shkuarjes së tij ilegal në atë vend, për rrugët e fshehta malore, rendjet nëpër natë për t'iu fshehur policisë, kthimet, dëbimet, rishkuarjet e të gjitha ato episode që kanë një ngjashmëri të habitshme me rrëfimet e dhjetra emigrantëve të treguara më parë. Më dukej se i kisha dëgjuar dhjetëra herë, po në respekt u përmbajtja të mos rrëfeja ndonjë shenjë bezdie.

Pjetri ishte i zgjuar, këtë e shprehnin sytë e tij të përmbushur me një dritë refleksesh të shkathta, që lëviznin në një hapësirë të ngushtë midis shtegut të vetullave. Kur ai mbaroi së rrëfyeri, unë ngrita gotën dhe e urova, pastaj, si për ta forcuar këtë urim, i thashë se isha i gëzuar që takova një mirditor, një njeri që ishte nga një krahinë e lavdishme, e cila në shekuj kishte ruajtur katolicizmin, kishte luftuar me të huajt dhe, siç quhej nga disa studiues, ishte tokë e katedraleve. Konservatorizmi shekullor i malësorit tonë është i habitshëm dhe impresionues. Më kanë mbetur në mendje dy vargje të një kënge popullore nga Curraj i Epërm, i thashë. Dhe ia recitova "Se për doke, zakone të veta/kemi lënë fusha, kemi lënë qyteteta". Nuk ka nevojë për koment, shtova duke vijuar se njihja shumë poetë e shkrimtarë nga Mirdita, por edhe piktorë, artistë, valltarë, regjisorë, si dhe juristë me emër. Kisha lexuar bukur mirë mbi historinë e saj martirizuese, si një krahinë që u vu në qendër të syrit të ciklonit të kuq. Një vend me bajraqe e kapedanë, mbartës i shkëlqyer zakonesh e dokesh, një shembull qëndrese.... Në këtë pikëpamje, shtova, Mirdita përbën një gonxhe të freskët të genit iliro-arbëror. Fjala "në këtë pikëpamje", nuk më pëlqeu, sepse sikur arnonte situatën e një leksioni. Po të shpreheshja së dyti mbi këtë ide, do ta hiqja, por rrjedha e bisedës mori vrull, kur Pjetri filloi të më rrëfente për gjyshërit e tij nga Oroshi, për besatimin e burrave të malësisë, për gjithë atë rezistencë të gjatë të malësorëve kundër turkut, serbit e sa e sa hordhive të huaja, por edhe kundër komunizmit.

Ngazëllimi i tij nuk vinte vetëm nga pija (ne po pinim uzo që Pjetri e kishte marrë nga Greqia, dhe mund ta shijonim me lejen e pronarit të lokalit, leje të cilin e kishte kompensuar me mezet e shtrenjta), por edhe nga ato që unë i fola, dhe nga ato që dinte. Në të vërtetë nuk kishte lexuar, por ca gjëra ia kishin përcjellë njerëzit e vendlindjes. Dhe dukej i kënaqur se nuk gjendej bosh në informacion. Kjo hetohej. Biseda, vjen një moment që vetiu vjen drejt fundit natyrshëm. Duhej të paguanim dhe nxora nga xhepi portofolin tim. Pjetri menjëherë vuri dorën përpara dhe më tha se më kishte ftuar ai, por në lëvizjen e shpejtë që bëri, nga portofoli i tij i fryrë ranë mbi tavolinë një tufë me karta. Ca u shpërndanë në dyshe. I mblodha tri prej tyre, por ndërkohë, si kurioz që jam, vura re një kartë identiteti me emrin Petro.

- Kjo, besoj nuk është karta juaj e identitetit, -thashë, ndonëse fotografia në të përfaqëonte më të Pjetrit.

- Po, e imja është, - më tha ai...

MBRETËRESHA

Unë të emërova mbretëreshë.
Ka më të gjata nga ti, duglajka.
Ka më të pastra nga ti, borëbardha.
Ka më të bukra nga ti, dritëhëna.

Por ti je mbretëresha.

Kur ecën nëpër rrugë
askush nuk të njeh.
Askush nuk shikon t'kristaltën kurorë,
dhe as qilimin prej ari të kuq,
që shkel kur kalon,
ai s'ekziston...

Dhe kur del në dritë
kumbojnë të gjithë lumenjt
në kurmin tim, qiellin
e shkundin këmbanat,
një himn e mbulon botën.

Vetëm unë dhe ti,
vetëm unë dhe ti, e dashur,
e dëgjohem.

BUZËQESHJA JOTE

Lermë pa bukë po deshe,
pa ajër më ler,
por jo!
Pa buzëqeshjen tënde mos më ler.

Mos ma merr trëndafilin.

Uji rrjedh furishëm,
në gëzimin tënd po hyn
valë e papritur
dhe si argjendi ndrin.

E gjatë është lufta ime
por do te kthehem,
me sytë e lodhur
vështrimin do të hedh:
Toka s'ka ndryshuar.

Te pragu sapo të dukem,
në qiell do fluturojë buzëqeshja,
do më kërkohet
dhe mua do m'i hapë
portat e jetës, të gjitha.

Në më të erttën orë,
Dashuria ime,
fruti i buzëqeshjes do të zhduket.
Edhe sikur shpejt
gjakun tim ta shikosh në gurët e rrugës,
Ti qeshu!
Buzëqeshja jote, shpatë
në duart e mia do jetë.

Bashkë me detin në vjeshtë,
buzëqeshja jote le të ngrejë
ujëvarën e vet shkumbëbardhë.
Dhe në pranverë, e dashur,
ta dua buzëqeshjen përsëri
si lulen që e pres,
si të kaltrën lule;
trëndafil ëndrrimtar i atdheut.

Qeshu,
qeshu natën,
ditën, nëpër hënë,
qeshu nëpër rrugët e ishullit,
qeshu...

Qeshu,
kur sytë unë t'i hap,
e përsëri t'i mbyll,
kur hapat e mi të dëgjosh;
hapat që shkojnë,
hapat që vijnë.
Mohoma bukën, ajrin,
dritën dhe pranverën,
por jo kurrë,
kurrë buzëqeshjen tënde.
Do të vdisja.

Një buqetë lirikash nga Pablo Neruda

Përktheu nga origjinali NAMIK DOKLE

Nga dhjetra libra të poetit kilian Pablo Neruda, fitues i çmimit Nobel në vitin 1971, ai me titullin "Vjershat e kapitenit" ka një histori të veçantë dhe interesante. Për herë të parë u botua në Itali, në vitin 1952, pa emrin e autorit. Letra shoqëruese e librit të dërguar në shtëpinë botuese ishte shkruar nga një grua. "Këto janë poezitë e kapitenit tim, ai dëshiron t'i botojë pa emër." shkruante ajo. Libri u ribotua katër herë pa emrin e autorit. Megjithatë, kritikë të njohur kishin shkruar disa herë se ato lirika mund të jenë vetëm të Pablo Nerudës. Njëmbëdhjetë vjet pas botimit, Neruda pohoi që ai ishte autor i librit.

KËMBËT E TUA

Kur nuk ta shoh fytyrën
shoh këmbët e tua.

Këmbët e tua me eshtrat harkuar,
të vocklat këmbë, të fortat.

E di që të mbajnë ato,
dhe gjithçka të ëmbël që ke
ngrihet vetëm mbi ato...
Balli yt dhe gjoksi,
i dyfishti purpurim
i thithkave të tua,
thellësia e syve
që shpejt fluturuan
dhe goja e gjerë frutashumë,
kuqëlimi i flokëve të tua,
e vogla kështjella ime.

I dashuroj këmbët e tua
vetëm se ecën e s'ndalën
asgjekundi mbi këtë tokë,
ecën mbi erë, edhe mbi ujë ecën,
deri sa më gjetën.

MALI DHE LUMI

Në vendin tim është një mal.
Eshtë edhe një lumë në vendin tim.

Eja me mua.

Nata ngjitet në mal.
Njeriu zbrit në lumë.
Eja me mua.
Kush janë ata që vuajnë?
Nuk e di,
por janë njerëzit e mi.

Eja me mua.

Nuk e di,
por thirrjen e dëgjoj.
"Po vuajmë, vëlla!" më thonë,
Eja me mua.

Ata më thonë:
Populli yt,
populli yt i poshtëruar,
mes malit dhe lumit,
mes dhimbjes dhe urisë,
mes vetmisë dhe luftës,
sa të ka prituri, vëlla!

Oh, ti, ti që të dua,
e vogla, kokërrkuqja e grurit!
Lufta e gjatë do të jetë
Dhe jeta po aq e gjatë...
Por ti me mua do të vishë.

BUKUROSHË

Bukuroshe,
ashtu si mbi gurin e freskët
të mengjesit, ujërat
lëshojnë shkrepëtimat shkumbëzuese,
është dhe buzëqeshja në fytyrën tënde,
bukuroshe.

Bukuroshe,
me një çerdhe të remtë krehur
në flokët e tua, një çerdhe
ngjyrë mjalti hijezuar,
ku zemra ime digjet dhe qetësohet,
bukuroshe.

Bukuroshe,
e vogël fytyra për sytë,
e vogël dhe toka për sytë e tu.
Ç'hapësira dhe lumenj
në ato sy,
edhe atdheu im është aty,
unë eci brenda tyre
dhe zdritet bota mbarë
ku kaloj,
bukuroshe.

Bukuroshe,
cickat e tua, dy simite
bërë nga toka e grurtë
dhe e arta hënë,
bukuroshe.

Bukuroshe,
belholla
që krahun tim e bën si lum
mbi trupin tënd të ëmbël duke
rrjedhur n'shekuj,
bukuroshe.

Bukuroshe,
nuk ka asgjë si vithet e tua,
por ndoshta toka ka
diku, diçka të fshehur,
aromën dhe harkimin tënd të kurmit,
ndoshta e ka diku,
bukuroshe.

Bukuroshe,
zëri yt, lëkura edhe thonjtë,
gjithçka që ke, drita edhe hija,
bukuroshe, e bukura e shpirtit,
gjithçka e imja është, e bukur,
mua më përket çdo gjë, e imja,
kur ecën apo ndalesh në udhëtim,
kur këngës ia thua a dremmit,
kur vuan dhe kur ëndërron,
gjithnjë,
kur të kam afër, apo larg,
gjithnjë,
e imja je, bukuroshe,
përjetësisht.

VDEKJA

Nëse shpejt do të shkosh,
nëse më s'do jetosh,
unë do ta vazhdoj jetën.

Nuk guxoj,
të shkruaj nuk guxoj,
nëse më s'do jetosh.

Unë do ta vazhdoj jetën.

Ku të mungojë një zë burri,
aty zëri im do të jetë,
atje ku negrit më thërrasin,
i vdekur kurrë s'mund të jem,
kur vëllezërit e mi do burgosen
dhe unë me ta do të jem.

Dhe kur fitorja,
jo fitorja ime,
por e madhja fitore
do të vijë,
edhe memec,do të flas,
edhe i verbër, do të shoh.

Jo, falmë,
nëse ti s'jeton,
nëse ti, e shtrenjta dashuria ime,
nëse ti,
do të kesh vdekur,
të gjitha gjethet mbi supet do më bien,
do bien natë dhe ditë në shpirtin tim,
zemrën dëborë do ma djegë,
do eci me ftohmen dhe zjarrin,
me borën dhe vdekjen,
këmbët do më shpien aty ku ti fle,
por...
do ta vazhdoj jetën.

Sepse ti,
mbi gjithçka të panështruar më doje,
sepse ti, e dashur, e di,
unë s'jam një burrë, por vetë burrëria.

ERA NE ISHULL

Era kalëron,
degjoje si vrapon
nëpër qiell,
nëpër det.

Rreket t'më rrëmbejë,
dëgjo si vrapon nëpër botë,
larg, të më çojë larg.

Shtrengomë në krahët e tu
në këtë natë vetmitare,
ndërsa shkulmon shtrengata
kundër detit dhe tokës,
me gojën e vet si gërbellë.

Dëgjoje erën,
më thërret duke vrapuar
larg, larg për të më çuar...

Me ballin tim në ballin tënd,
me tënden buzë në buzën time,
shtrenguar trupat tanë
në dashurinë që na përvëlton,
lere erën të kalojë
s'dua larg të më çojë.

Lere erën të vrapojë
me shkumë e kurorëzuar.
Më thërret e më kërkon
edhe pisket ndër hije...
Por unë,
në këtë natë vetmitare,
fundosur në sytë e tu
do të çlodhem, dashuria ime.

-Sigurisht që ne mund të jemi miq, por edhe të dashur, - thashë unë me pas.

Në mes të errësirës zëri im u dëgjua i hollë dhe qesharak.

Ai vuri buzën në gaz.

- Më duket se do që të tregohesh tip i fortë.

Kishim dalë për të pirë një birrë. Isha unë ajo që e kisha ftuar. Birra ma turbulloi mendjen më shumë mua sesa atij, dhe pavarësisht se ai nuk donte që të kishte një të dashur, unë e shtrëngova fort pas vetes jashtë lokalit *Teddy's Bar*, ku të dy u puthëm derisa ai u dorëzua, e në vijim më mori në shtëpinë e tij.

Të nesërmen, pasi u puthëm shkurtas, i uruam ditën e mirë njëri-tjetrit. Pushimet e verës akoma nuk i kisha mbaruar, ndaj kisha zënë vend në ambientin e jashtëm të një kafeneje me një gazetë në dorë; dush nuk kisha bërë. Gjatë gjithë periudhës së pushimeve nuk isha ngritur kurrë kaq herët. Në ambientin e jashtëm kishte vetëm dy punëtorë të riparimit të rrugës, të cilët qëndronin ulur mbi dy karrige plastike të lagura nga vesa. Më merrej pak mendja, kokën e ndjeja të rëndë, qeshja me vete. Ishte vera e parë ndër shumë vite që kisha marrë pushimet, punën e rregullt e kisha siguruar vetëm një vit më parë, ndaj dhe nuk e kisha të nevojshme që të punoja gjatë verës. Pjesja veten nëse ai mendonte për mua, kjo ishte arsyeja që kafën e derdha dy herë, në një kohë që dhe gazeta më ra përtokë nga dora po aq herë.

Nuk bëra asnjë përpjekje për ta kontaktuar atë. Pas tri javësh mora një mesazh prej tij me anën e të cilit ai më pyeste nëse ndodhesha jashtë.

- Këtë nuk ma merrte mendja, - klitha tek bisedoja me Karinën; ndodheshim në një bar, dhe pikërisht në atë çast po përpiqeshim t'i tërhiqim vëmendjen banakierit që të na shërbente.

- Ti nuk doje ta besoje, - thirri ajo me zë të lartë, - kurse unë isha krejtësisht e sigurt se ai do të merrte në telefon.

Vura re se trupit më ishte mbushur me vraga mavi që prej dy ditësh, gjë që vazhdoi edhe në ditët në vazhdimësi. Nuk isha në gjendje ta përcaktoja nëse një gjë e tillë më pëlqente apo jo. Ai më kapte nga flokët, unë shuaja etjen time seksuale, ndërkohë që ai më mbërthente me duart e tij në të dyja anët e trupit teksa lartësohesha mbi të; e gërvishta në pjesën e brendshme të kofshëve derisa ai rënkoj nga ngacmimi. Kështu vazhduam një copë herë. Ishte si një lojë e ashpër midis dy këlyshëve. Si rregull, ishim që të dy tepër të dehur, ndaj loja nuk shkonte asnjëherë deri në fund.

Ende vazhdoja të banoja në një apartament, të cilin e ndaja me të tjerë. Këtë vazhdoja ta bëja, jo se ideja më pëlqente, por thjesht përkohësisht, derisa të gjeja një hyrje më vete; me të tjerët nuk është se bisedoja për tema të veçanta, thjesht banoja së bashku me ta. Ato ishin kryesisht infermiere ose studente të shkollës së infermierëve, ndonëse nuk i mbaj mend të gjitha detajet me hollësi. Një herë dëgjova njërin prej tyre që kthehej nga turni i natës; qëlloi që ajo të futej në sallon në momentin që ne po bënim dashuri. Duhet të më ketë dëgjuar, por këtë fakt ajo nuk ma përmendi asnjëherë, ngaqë ne nuk flisnim për gjëra të tilla.

- Sa mirë që me ty nuk është problem të ushtrosh pak forcë, - tha ai tek më ceku lehtë të ndenjaturat.

Kjo ishte një nga ato gjërat me të cilat nuk isha mësuar. Më pëlqente që situata të tilla t'i përballoja pa reaguar, dhe të tregohesha sikur nuk kisha dëshirë për të qenë e dashura e dikujt, apo të lëshohesha në krahët e tij.

Prej kohësh më kishte lindur mendimi për ta dhënë dorëheqjen në punë. Nga fundi i shtatorit bleva tesha të reja dhe çizme të lehta me taka shumë të larta me të cilat nuk mund të shkoja në ambientet e punës. Ato i veshja vetëm kur bashkë me Karinën dhe një shoqen e saj shkuam në St. Hanshaugen. Në një ditë që dielli shkëlqente fuqishëm dhe të jepte kënaqësi, tek ecnim, ne shkëlmonin

NUK KA PROBLEM

tregim nga Marie Aubert

përktheu nga origjinali Aristidh Shqevi

gështenjat e rëna në tokë dhe gjethnajtën, duke pasur njëkohësisht mundësinë për t'i hedhur një vështrim fjordit që shtrihet më poshtë. Në qytet syri na kapë bare të reja, kafene, restorante e taverna pa fund; kjo ishte dhe arsyeja që ne filluam të dilnim çdo fundjavë. Unë sillesha sikur të isha njëzetë vjeçe dhe sapo t'i kisha nisur studimet, me pritshmërinë për të vrapuar më shpejt dhe për të folur me zë më të lartë. Ato më bënë disa pyetje në lidhje me të, i thashë se ne shkonim mirë dhe se takoheshim herë pas here, por unë gjithçka në jetë e prisja ashtu siç vinte, pa kurrfarë stresi. Ato m'u përgjigjën se ajo çka unë po thosha tingëllonte shumë zbavitëse, dhe se nuk ishte aspak tipike për mua që t'i merrja gjërat me kaq shumë qetësi. Unë nuk isha nga ato që mbanin të dashur, nuk qahesha, nuk zhgënjehesha, nuk isha as romantike dhe as nuk digjesha nga dëshira për të pasur një mori gjërash.

- Ai sigurisht që të do, qoftë edhe pak, - tha shoqja e Karinës.

Iu thashë se po mendoja të largohesha drejt New York-ut, të banoja aty pas korrikut për ndoshta rreth gjysmë viti, të gjeja aty një punë, të mësoja gjuhë të huaja dhe të lexoja libra.

- Këtë duhet ta bësh, - tha Karina. - Ka shumë mundësi që të gjitha këto t'i realizosh. Ne jemi tashmë në gjendje që t'i arrijmë këto objektiva.

-Kini parasysh se është dhe puna në mes, por kështu ka dhe mjaft gjëra të tjera, - thashë unë. - Sidoqoftë, do të ishte gjë e bukur që, thjesht, ta jepje dorëheqjen nga puna dhe t'ia mbathje diku.

Përfytyrova në atë çast trotuare të gjera me pemë të larta e të gjelbra, apartamente me dritare të mëdha, parkete prej kockash peshku që kërcisnin kur shkelje mbi to, pirgje librash, bare sekrete ku lejohej të pije duhan në ambientin e tyre të brendshëm, biseda të gjata me djem të rinj izraelitë, me flokë kaçurrela dhe sarkastikë, si edhe vajza që i shëmbëllenin Lena Dunham-it.

Ai më mori në telefon rreth orës nëntë e gjysmë, një të mërkurë në mbrëmje në muajin tetor. Kurrë më parë nuk më kishte marrë në telefon në ditë jave; më pyeti nëse doja të dilnim së bashku, thjesht të merrnim autobusin për në Maridalen dhe të ngrinin aty një tendë. Ai do të merrte me vete disa shishe me birrë; tingëllonte shumë entuziast.

- A nuk vjen më mirë tek unë, - e pyeta menjëherë. - Të nesërmen kam për të shkuar në punë.

- Po e marr një herë tendën me vete, pastaj vendos si të duash, - tha ai.

Gjeta dy dyshekë-thasë, pulovra të leshta dhe një pako me biskota; sigurisht që unë mund ta bëja një gjë të tillë, të hidhesha rrokapjekthi, ta takoja atë dhe të flinim të dy në një tendë diku jashtë në natyrë. Gjithsesi nuk shkova gjëkund, ndihesha e lodhur dhe kisha flohtë, temperatura jashtë kishte zbritur nën zero, e për më tepër, kishin kaluar gjashtë vite që nuk kisha fjetur në tendë.

- Sot nuk paske ndonjë qejf të madh, - tha ai teksa qeshi në momentin kur e lashë të futej brenda.

- Jam zbutur ndopak? - pyeta unë.

- Jo, aspak, - tha ai. - Sidoqoftë, shijet e njerëzve janë të ndryshme.

Ne pimë birrë nën jorganin me pupla dhe qeshëm mbyturazi. Unë ulërita në çastin kur ai më ktheu në shpinë dhe të brendshmet e mia përfunduan pranë këmbëve. Më pas ne pamë filmin e parë të serisë *Lufta e Yjeve*, versionin e vjetër. Për mua, filmi ishte i mërzitshëm, ndaj herë pas here kapitja sytë.

- Nuk mund të flesh pa parë filmin *Lufta e Yjeve*, - tha ai teksa më puthi në gushë duke e shoqëruar puthjen me një tingull të ëmbël shushurites.

-Njerëzit kanë shije të ndryshme, - thashë unë duke e imituar theksin e tij.

- Pa shiko, - tha ai, - përsëri kërkon që të tregohesh si tip i fortë.

- Ai patjetër që të do, qoftë edhe pak, - tha Karina.

- Nuk bëhet fjalë për asgjë të këstillë, - thashë unë.

- Por gjithsesi, - tha Karina; unë buzëqesha, ngaqë nuk e mbajta dot veten.

Ne i dërguam njëri-tjetrit mesazhe, por për çudi ai nuk më pyeti nëse do të takoheshim. Një të premte, teksa rrija në shtëpi, u përgatita për ta takuar dhe i dërgova një mesazh me anën e të cilit e pyeta nëse dëshironte të vinte. Pasi kishte kaluar një kohë e konsiderueshme, ai u përgjigj se nuk e kishte problem, por së pari i duhej të shkonte në një mbrëmje. Më në fund ai i ra ziles së portës në momentin kur unë kisha orë të tëra që flija, ndaj dhe u zgjova si e hutuar, ndërkohë që trupin e ndjeja të ngrohtë dhe të rëndë. Ama, dëshira ime ishte që ta lija të priste aty ku ishte, në këmbë. Ai kundërmonte njësoj si ata personat që me të mbaruar një mbrëmje, sulen drejt një tjetre; papritur e pashë të shembet përtokë tek pragu i portës.

Vura buzën në gaz dhe thirra, "o Zot!"

Ai u fut me shumë forcë. Isha shumë e lodhur, doja të flija, megjithatë e provuam për një farë kohe.

- Tani nuk mundem më, më dhëmb trupi, - thashë unë më së fundi.

- Jo, në asnjë mënyrë, - tha ai me zërin e një fëmije, dhe nuk u ndal.

- Pajtohem me mendimin tënd, - thashë unë. - Megjithatë, po më mbyllen sytë.

M'u desh ta përsërisja këtë edhe një herë tjetër, pushova së buzëqeshuri, dhe duart i vendosa mbi kraharorin e tij.

- O zot, paske dhimbje, - tha ai me një zë sikur të ishte përgjumësh. Më pas, ai u vu në lëvizje me forcën e një burri, vendosi duart e tij mbi të miat dhe m'i uli ato më poshtë në dyshek. M'u desh ta ktheja kokën anash që të merrja frymë. Trupi i tij ishte shumë i rëndë.

Të nesërmen në mëngjes e përqafova në sallon. Me sytë që i buzëqeshnin ai ma ktheu përqaftimin.

- E marrtë dreqi e marrtë, edhe unë nuk ndihem aspak mirë, - tha ai.

- Pa diskutim që nuk ndihesh mirë, - u përgjigja unë.

Nuk doja që ta lija të ikte, e mbërtheva fort, ashtu siç isha, e zhveshur, pa ditur se çfarë po kërkoi. Ai qeshi dhe më përkëdheli në shpinë.

- Mirupafshim, - tha ai.

Bëra një dush dhe u veshja si zakonisht. Dola nga shtëpia dhe shkova për një kafe bashkë me dy shoqet e mia, me të cilat më pas dolëm nëpër dyqane; bleva një pulovër të gjelbër, por nuk qëndrova gjatë për të marrë pjesë në biseda e të qeshura, për një copë herë m'u bë sikur m'u mblodh një komb në grykë, dhe më tej, në brendësi të trupit ndjeva njëfarë qetësie, por edhe një boshllëk.

Me njëri-tjetrin nuk folëm më kurrë. Nja dy herë u zgjova nga gjumi prej thirrjeve të tij të cilat nuk morën asnjëherë përgjigje nga unë.

Papritur m'u dha rasti për një punë të re, bëra kërkesën dhe kështu fitova vendin e punës. Mundësinë për të shkuar në New York me pushime e kisha, madje dhe për të qëndruar aty për një farë kohe. Pas disa muajsh bleva apartamentin tim të parë, njoha dikë që u bë i dashuri im, dhe pa dalë viti, hyrjen e shita sërish.

U desh të kalonin gjashtë vite përpara se ta shikoja këtë lidhje të re si diçka të ndryshme nga ajo lidhja e pashëndetshme që kisha pasur me djalosin e ri, djalin e fundit me të cilin mashtrova vetveten. Një ditë kisha dalë jashtë dhe po shtyja karrocën e fëmijës në St. Hanshaugen, kisha marrë lejen e lindjes për herë të dytë. Ne kishim blerë një shtëpi me një mur të përbashkët në Oppsal, dhe pritej të futeshim aty brenda muajit tetor. Nuk isha e sigurt nëse akoma vazhdoja ta doja tim shoq, por isha ende e pushtuar nga emocionet e një jete të re, nga e zakonshmja dhe madhështorja, zërat, përqaftimet dhe aroma e fëmijëve, pulovrat e vogla, si dhe nga im shoq që kisha pranë vetes netëve në shtrat, pa harruar shtëpinë e re me kopsht.

Diku aty nga lartësitë e St. Hanshaugen-it i hodha një vështrim qytetit që shtrihet përtej, ndërkohë që vajza flinte në karrocën e saj. Vjeshta kishte qenë e lagësht dhe e butë, shiu binte pjerrtas dhe lehtë mbi fytyrë. Ta shikoje fjordin ishte e pamundur. Pikërisht në atë moment u kujtova, madje u kujtova mirë se duhej ta ngrija mbulesën e karrocës së vajzës dhe të ulesha diku në një stol. Ky nuk ishte fundi, por vetëm fillimi, me parapëlqimin për takat e larta, vurratat mavi dhe planet për të udhëtuar.

Ndodh që unë shpesh të ekzagjeroj. Gjithmonë më pëlqen që të sillem kështu, të jem romantike, t'i zbkuroj e t'i praroj gjërat, por edhe të rrekem fort për t'u kthyer mbrapsht. Tashmë jam e sigurt se, po të ekzistonte mundësia e kthimi mbrapa në kohë, do të isha në gjendje t'i këmbëja të gjitha, shtëpinë dhe fëmijët, tim shoq dhe çdo gjë tjetër, vetëm e vetëm që ta rifitoja besimin se isha në gjendje t'i kapërcejja fuqitë e mia e të shndërrohesha në dikë tjetër, me bindjen se kjo do të ishte po aq e lehtë për mua, sa të vishja një palë çizme të reja dimri.

MARIE
AUBERT
A MUND
TË VIJ
TEK
TI

Onufri Tregime





August Strindberg

Sëmundja e dashurisë

Përktheu nga origjinali Qerim Raqi

Një mëngjes heret në maj po rrija ulur pranë dritares
sime
i pikëlluar
Shikoja sesi mbi lulet binin fjolla të vogla bore
aq dendur
Shkurret e trëndafilleve dridheshin dhembshurisht
dëshmonin ..
ndaj erës
Dhe për erën e ftohtë tulipani mbylli
kapakun
Atëherë u bë vjeshtë në zemër dhe unë deri lart në qiell
ngrita
psherëtimën
" Perëndi na dërgo veren - tregoje fytyrën tënde
përsëri!"

Atë çast lart në qiell ndërmjet reve të shpërndara
përkulet
një laureshë
Ngre zërin e saj kumbues, këndon për diellin dhe verën
Dhe menjëherë gjallëron kopshti, parku mali
Në zemrën time u zgjua përsëri ngazëllimi i verës dhe
shpresa -
Stuhia atje qetësinë në timin
shpirt të zemëruar
Mbrëmja ka rënë në retë e trëndafilita dhe deti pushon;
Valët dremisin ëmbël ende të përgjumura psherëtimë;
Ah, është zemra ime që psherëtimë aq e shqetësuar dhe
vajton
Valët dremisin mjaft ëmbël, ato e duan të tyrin
bregdet
Përtej qiellit në perëndim atje banon e dashura ime
larg;
Më jep njërin krah tëndin pulëbardhë, të fluturoj tek ajo
menjëherë
Të hyj fshehurazi në dhomën ku rri ajo zhytur në
ëndërrime;
t' a puthë në ballë, të ledhatoj flokun e saj të zi si nata
Kah të erdhi ai mendim i guximshëm që ajo duhej të
vuante?
Mendja e saj nuk të arrinë ty - Nuk është për ty
puthja e saj
Ah, një tjetër ajo ia ka dhuruar zemrën, një
genie tjetër
Plotë dashuri dhe dritë, errësirë dhe parzmore bëhet
fati yt!
Nata nuk më sjell qetësinë; në kasollën time
s' kam gjumë
Valët flenë shumë ëmbël -Ah, le ta duan
bregdetin e tyre!

Por, ç'tundim më përfshinë? ti je shitur tek
një tjetër?
Çfarë të kërkoj nga ti, një i huaj jam
për ty?
I varfër, shumë i varfër jam, dhe s' kam asgjë të të ofroj
vashëz
Vetëm një zemër aq të ngrohtë, një vullnet
shumë të fortë!
O, fale pra një të marrë që nuk ka pasur
guxim
Të hedhë një zjarr në shpirtin tënd, për të shijuar
miqësinë tënde
një çast

Të ngrohem pranë zjarrit hyjnor të dashurisë që ti ke
ndezur
për të dashurin tënd
Nëse unë digjem në këtë rast, O, atëherë i mjaftueshëm
dënimi

Nata ka hedhur qetësinë dhe pushon mbi tokën
e përgjumur
Gardalina fle në shkurre; ëndërron të dashurin
e saj
Era e muzgut ka harruar veten nën kurorën e gjelbër të
blirit
E puth gjethin e sapokëputur, pëshpërit për pyllin e
drrit
dhe beson
I vetëm bëjë roje pranë imazhit të verdhë të zbehët të
dhomës sime
Nuk e gjej më atë qetësinë në punë si
përpara
Mendja nuk është në përputhshmëri me
shumëllojshmërinë e
imazheve
Sepse në syrin tim ëndërrimtar, kalon imazhi yt
o, vashëz
Ah, dua ta fshij nga vatra e thellë e sime
zemër
Por për këtë nuk kam pushtet; dhe zemra atëherë të
erdhi pas
Goditjet e shpeshta të orës në shesh më thërrasin
të pushoj
Por gjumi nuk më vie, dashuria vazhdimisht
bënë roje
Ah, vetëm ca orë më parë unë shijova praninë
Lauresha ka ikur rrugës së saj; vjeshta ka ardhur
përsëri
I vetmuar qëndroj pranë urës pas të lashtit
blir
Pashë sesi në çastin e ndarjes miqët më ftonin në
lamtumirën
Përse nuk shtrëngova dorën tënde aq fort sa
të tjerët
Falënderues për gëzimin që më fale, dritën që
shpërndave në
shpirtin tim
O, kur ajo qëndeonte në kuvertë aq e mavijosur
në faqe si narcisi
Loti në sy, kuptohet, pasqyrore mall dhe dhembje
Kur kaçurrelet e zeza si nata hidheshin lirshëm në
erë
Ajo qëndronte e pastër dhe e bukur, ngjasonte me
idolet
e ëndërrave të mia
Më mbërtheu dhembja, atëherë doja të hidhesha
në thellësi
Të vdes në çast i qetë me shikimin e saj
lamtumirës
Ndoshta ajo derdhi një lot për dashurinë
e çiltër të djaloshtit
Për një zemër të thyer, ah për mua ajo
nuk qau
Tani nëpër detin e shkretë drejt bregdetit të huaj
ajo udhëton
Qetëso mërinë tënde uragan! Ti s' bënë ta thyesh
trëndafilin tim!

Një jetëshkrim i shkurtër

Prusti rrjedh nga një familje në gjendje të mirë ekonomike, pasuria e së cilës i detyrohej kryesisht punës së të atit, Profesor në Fakultetin e Mjekësisë dhe epidemiolog i njohur.

Jeta e tij u ballafaqua me kufizime qysh fëmijë për shkak të astmës. Shëndeti i tij lidhet edhe me disa privime që iu nënshtua e ëma gjatë rrethimit të qytetit më 1870 dhe gjatë Komunës së Parisit; për t'u shpëtuar trazimeve që solli lëvizja komunare, prindërit e tij patën shkuar në Auteuil (Otëj). "Para lindjes së Marsel Prustit, gjatë Komunës së Parisit, doktor Prusti pati qenë plagosur, ndërsa po hynte në spital. Zonja Prust, shtatzënë, mezi e përballoi ligështimin që pësoi për rrezikun që mund t'i kanosej të shoqit. Fëmija që solli në jetë fill pas ngjarjes ishte aq i ngathët, sa i ati dyshoi se mos nuk kishte zhvillimin e duhur mendor. E rrethuan me kujdes e ai dha shenjat e një ndjeshmërie të parakohshme, por shëndeti i tij mbeti i brishtë", shkruan një nga biografet e Prustit.

Ai e kaloi pjesën më të madhe të fëmijërisë në Paris, por në pushimet e verës shkonte te gjyshërit në Illier, një qendër rrethi, pranë lumit Luarë. Atij nuk i mungoi kujdesi e dhembshuria nga të dy prindërit, por sidomos nga e ëma që ishte e lirë dhe e shoqëroi në udhëtime edhe kur qe në moshë të rritur.

Stina e pranverës mbeti për të voglin një nga stinët më të vështira për të jetuar. Polenit i luleve i shkaktonte kriza të forta astme. Njëherë, kur ishte nëntë vjeç dhe kthehej nga një shëtitje në pyllin e Bulonjës me prindërit, atij iu zu fryma aq shumë, sa i ati mendoi se do të vdiste. Ai shpëtoi me vështirësi. Tashmë kërcënimet do të quhej i pranishëm te fëmija dhe te burri i mëvonshëm.

Mësimet fillore i mori me një grup të vogël privat; bashkënxënës kishte djalin e kompozitorit G. Bizet, gruaja e të cilit do të hapte vite më vonë një sallon ku mbledheshin artistët të ndryshëm të kohës. Prusti do të ishte një nga të pranishmit.

Studimet e mëtejshme ai i vazhdoi në liceun Condorcet (Kondorse) dhe u shqua në letërsi dhe në filozofi. Për herë të parë e vënë në tabelën e nderit në dhjetor 1884. Megjithatë mungonte shpesh për shkak të shëndetit, ai dinte përmendësh shumë krijime të poetëve Victor Hugo dhe Alfred de Musset. Shpesh botoi te revista letrare e liceut.

Dashuria e parë e fëmijërisë dhe adoleshencës së shkrimtarit të ardhshëm ishte vajza e një diplomati polak, me të cilën luante në kopshtet Champs-Élysées. Më 1887 ai nuk e takoi më dhe sipas biografëve dëshira e zjarrtë për të dashur a për t'u dashur nga tjetër kush, veç mëmës dështoi. Eshtë vasha e parë, të cilën ai u përpoq ta gjente më vonë dhe që e ka humbur përgjithmonë.

Përpjekjet e para letrare të Prustit ndodhën në vitet e fundit të liceut. Për adoleshentin letërsia është forma më e përkryer e jetës.

Kur mbaroi liceun, pak a shumë në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, ai shikohej si snob, sepse ishte i pranishëm nëpër sallonet pariziane. Aty ai njihet me borgjezinë e madhe, takon shkrimtarë, piktorë, madje edhe zonja të cilave u pëlqen biseda dhe zgjuarsia e tij.

Prusti vendosi të mos i nënshtrohej traditës familjare (vëllai i tij vazhdoi studimet për mjekësi). Më 1889 shkoi vullnetarisht ushtar dhe ruajti kujtime të bukura nga ajo jetë.

I kthyer në jetën civile, ai ndoqi disa kurse në Shkollën e lirë të shkencave politike. Më 1892, një ish-shok i liceut hapi revistën letrare *Banketi* dhe ai ishte bashkëpunëtori kryesor. Ndërkohë bisedoi me të atin që të

VITI I PRUSTIT: 100-VJETORI I VDEKJES

Nga Feride Papeka

Jo vetëm në Francë, por dhe kudo në botë janë zhvilluar e zhvillohen veprimtari kushtuar jetës dhe veprës së tij

*Marcel Proust-i lindi në 10 korrik 1871 në Paris dhe vdiq po aty më 18 nëntor 1922. Vepra kryesore e tij është cikli romanor shumëvëllimësh me titull *À la recherche du temps perdu* (Në kërkim të kohës së humbur), shtatë vëllimet e të cilit u botuan nga viti 1913 deri më 1927, domethënë një pjesë e tyre pas vdekjes. *À l'ombre des jeunes filles en fleurs* (Nën hijen e vashave në lule të moshës), vëllimi i dytë i ciklit fitoi çmimin Goncourt më 1919. Ai e mbylli jetën më 1922 dhe u fut në dhé në varrezën Père-Lachaise (Per Lashez) në Paris, i shoqëruar nga njerëz të shumtë që përshëndesnin një shkrimtar të rëndësishëm e që brezat e mëpastajmë do ta ngrinin në një pedestal shumë të lartë duke e shndërruar në mit letrar.*

merrte pjesë në një konkurs diplomatik, por pastaj ndryshoi mendje e u regjistrua në Sorbonë, dëgjoi leksionet e Henri Bergsonit dhe mbaroi licencën për letërsi më 1895.

Pas kësaj ai u paraqiti në konkurs për një vend pune në bibliotekën *Mazarine*, fitoi, punoi aty katër muaj dhe më së fundi dha dorëheqjen. Në korrik bëri një muaj pushime në Gjermani me të ëmën, pastaj në një komunë jashtë Parisit ku shkroi një

novelë që ia botoi *La Revue Hebdomadaire* në tetor të po atij viti. Gjatë kësaj vere ai pati nisur edhe një roman me personazh kryesor një të ri të dhënë pas letërsisë që jeton në fund të shekullit XIX. I vështruar si një bocë, romani nuk përbën një tekst të përfunduar. Prusti aty përmend çështjen Dreyfus.

Gjendja e mirë ekonomike i siguroi atij lehtësira për të ndjekur sallonet e borgjezisë e të aristokracisë së re. Lidhi



miqësi të ngushtë me Lucien Daudet, djalin e shkrimtarit Alphonse Daudet dhe u njoh me shkrimtarin e famshëm Anatole France.

Më 1896 botoi *Kënaqësitë dhe Ditët*, një përmbledhje poemash në prozë, portrete dhe novela sipas stilit të fundshekulli me parathënie nga Anatole France. Libri kaloi pak a shumë pa u vënë re dhe kritika e priti ftohtë; madje midis kritikëve njëri është shkrimtar dhe tregohet i ashpër. Një ditë ata gjenden ballë për ballë me pistoletat në duar për duel. Gjithçka përfundon pa plagosje, por jo pa trishtim për autorin e ri. Kjo është vepra e parë e shkrimtarit, i cili kërkoi të mos rishtypej sa kohë që merrej me *Në kërkim të kohës së humbur*.

Megjithatë ishte bir i një babai katolik dhe i një nëne çifute, Prusti përdori të drejtën për mos t'u përcaktuar në bazë të besimit. Në korrespondencë lexojmë se nuk është besimtar. Megjithatë si Dreyfusard i bindur ai ishte i ndjeshëm ndaj antisemitizmit të epokës dhe pësoi edhe vetë sulmet anti-semite të disa prej penave të shquara të Francës. Duke qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i çështjes Dreyfus, ai shpërnda një peticion që kërkonte rishikimin e procesit, të cilin ia jep për ta firmosur edhe Anatole France-it në mbështetje të kapitenit francez që akuzohej për tradhti të lartë.

Atij i pëlqente të takohej rregullisht me anëtarët e rrethit Noailles-Brancovan, të njihej me estetikën e fillimshkullit, sepse Anna de Noailles ishte një yll në ngjitje i poezisë së re dhe vëllai i saj Constantin de Brancovan sapo kishte themeluar revistën *La Renaissance latine*, mishërim i kësaj lëvizjeje estetike.

Takimet e Prustit bëhen jo rrallë një shfaqje e vërtetë estetike që i dhurohet një soditësi pasiv. Në një letër ai shkruan: "Takova Lucy Gérard në Cabourg. Ishte një mbrëmje e këndshme, nga ato që perëndimi i diellit nuk e kishte harruar ngjyrën e trëndafiltë, megjithatë fustani i saj ishte krejt trëndafili dhe së largu dërgonte në qiellin e portokalltë ngjyrën plotësuese të muzgut. Unë ndenja gjatë duke vështruar këtë njollë të imët trëndafili, derisa e pashë që u shkri me horizontin; u ktheva në shtëpi me rrufë". Ndonjëherë njaftojnë dy rreshta që tregojnë ngazëllimin e tij se ka gjetur formulën e re të suksesit në shkrimtari: "Po shkruaj një skicë; Burzhe zbrit, ndërsa Bojles prapset". (Paul Bourget dhe René Boylesve janë dy romancierë të kohës së Prustit).

Më 1900, përmes një miku të tij diplomat në Londër, ai zbulon estetin anglez John Ruskin, shkruan disa artikuj për estetikën e tij. Ruskin-it i ishte ndaluar ribotimi apo përkthimi i veprës në gjallje. Me vdekjen e estetit po atë vit, Prusti vendosi ta përkthente, por ndërmori së pari një pelegrinazh në vendet e përshkuara në librat e tij e sidomos në Venecia ku shkoi me të ëmën. Duke ndjekur hapat e Ruskin-it, ai vizitoi vepra arti të tjera, të cilat do t'i përshkruajë vetë më vonë.

Për rastësi ai zuri vend në hotelin ku kishin qëndruar për ca kohë George Sand dhe Alfred de Musset. Ndër të tjera ai shkoi edhe në Padovë ku u njoh me një afresk të madh të Giotto-s, komentim për të cilin e futi në veprën e tij të ardhshme *Në kërkim të kohës së humbur*.

Artikujt e parë për Ruskin-in ai i botoi te *La Gazette des Beaux Arts*. Episodi për përkthimin rimerret te romani *Albertine disparue* (*Albertina e zhdukur, apo e Arratisura* sipas përkthyeses së Prustit, Edit Kodra). Prindërit e Marselit luajnë një rol përcaktues në punën e tij si përkthyes. I ati, një njeri i qetë që e la të birin ta zgjidhte vetë rrugën e jetës, e vlerëson si mjet për ta vënë në punë. Sepse Prusti ka qenë i panënshtuar nga çdo lloj detyre shoqërore dhe sapo ka dhënë dorëheqjen nga puna në bibliotekë. E ëma e ndihmon shumë; meqë

Prusti nuk e zotëron mirë anglishten, ajo i vihet përkthimit fjalë për fjalë të tekstit anglez. “Duke u nisur nga ky material, shkrimtari arriti të krijonte me tekstin një frëngjishte të shkëlqyer”, shkruante një kritik kur u botua përkthimi i parë i librit *Bibla e Amienit*, 1904.

Në vjeshtë të vitit 1900, familja Prust u zhvendos në lagjen 8. Ai u njoh aty me princin Antoine Bibesco (Antuan Bibesco); princesha Helen (e ëma e Bibesco-s), kishte hapur një sallon, në të cilin ftonte muziktarë dhe piktorë (G. Fauré ‘Fore’ është i rëndësishëm për sonatën e Vinteuil në veprën e tij). Princi Bibesco mbeti një nga miqtë e Prustit deri në fund të jetës.

Ai i vazhdoi pelegrinazhet ruskiniane, dhe më 1902 vizitoi Belgjikën dhe Holandën.

Martesa e vëllait, Robert Prust, më 1903 dhe vendosja e tij në një shtëpi tjetër, e ndryshoi jetën e përditshme të familjes. Vdekja e prindërve (i ati më 1903, e ëma më 1905), e keqësoi shëndetin e tij. Me të ëmën ai ishte shumë i lidhur, madje në shumë raste kërkonte kujdesin e saj edhe i rritur, prandaj kjo ngjarje i la gjurmë të thella.

Pas këtyre fatkeqësive, Prusti bëri një pushim në Versajë. Atje njohu poetin bohem Robert de Montesqueu, i cili e ndihmoi të hynte në sallonet më elegante të kohës e të njihte personalitete të tjera.

Universi intelektual i Prustit zgjerohet nga dita në ditë. Por edhe ankthi, vuajtja, xhelozia, sëmundja, vetmia e artistit, po ashtu shtohen. Léon Daudet në një libër të vitit 1905 e përshkruan kështu Prustin që hyn në restorantin Weber: “Rreth orës shtatë e gjysmë erdhi te Veberi një djalë i ri i zbehtë, me sy të zjarrtë duke kafshuar dhe lëmuar me dorë njërin cep të mustaqes së errët e të gjatë, i mbështjellë me rroba të leshta si të ishte një stringël kineze. Ai kërkoi një bistak rrushi e një gotë uji dhe tha se do të ikte, se ishte me grip, se do të shkonte të shtrihej, se i bënte keq zhurma. Hodhi përreth vështrime të shqetësuar, pastaj tallëse dhe më së fundi shpërtheu në një të qeshur të gëzuar dhe qëndroi edhe ca. Shumë shpejt nga goja e tij dolën me një ton ngurrues e të nxituar vërejtje me një risi të jashtëzakonshme dhe konstatime të çuditshme. Imazhet e tij të paparashikueshme për sendet dhe njerëzit, ishin si ajo muzika siprane që rrëfejnë se dëgjohej në tavernën e teatrit Globus kur hynte Shekspiri me shokët e vet. Ai përmendi Mercutio dhe Puck (dy personazhe, shënim imi, F. P.), shprehu disa mendime njëri pas tjetrit, i shkathët për të kërkuar falje, për të qenë i përzemërt, me një vetëdije ironike, natyrisht të ndërlikuar, i ndjeshëm dhe i butë”.

Shkrimtari i ardhshëm grumbullon lëndën e duhur për hartimin e veprës së tij madhore, një vetëdije krijuese që vështron gjithçka me vëmendje për t'i dhënë jetë më pas. Një punë e ngadaltë e me durim që skicon planin e domosdoshëm e të papërsëritshëm të një lloji që nuk kishte paraardhës, por nuk do të ketë as pasardhës në letërsi, atë të katedrales së kohës.

Veç kësaj letrat e tij dëshmojnë për një njohje të hershme të autorëve; ato na informojnë për leximet e pafundme, për tablotë e pikurës apo ekspozitat, koncertet që ka parë, për personalitetet që ka njohur edhe pse tërësia e bibliotekës së tij, e muzeut të tij imagjinar, e dijes së tij, sigurisht, është e pamundur të parafytyrohet. Të duket se ai ka lexuar gjithçka, ka parë gjithçka, ka dëgjuar gjithçka.

Më 1907 Prusti filloi të shkruante veprën madhore *Në kërkim të kohës së humbur* dhe u veçua nga bota. Rikrijimi i të shkuarës paguhej me çmimin e flijimit të përditshëm. Ai dërrmohej në punë natën, flinte ditën dhe dilte rrallë, vetëm në mbrëmje sa për të ngrënë darkë. Për pesëmbëdhjetë vjet, ai jetoi kështu i vetëm në dhomën e tij të veshur me tapë, në një apartament në Bulevardin Haussmann, në të cilin u vendos pas vdekjes



së prindërve. I mbështjellë dimrit me pallto dhe shall, ngaqë nuk ndizte zjarr prej astmës, shkruan dhe përpunon duke shtuar dhe duke ngjitur dta-ditës aq shumë copa letrë në faqet e para të dorëshkrimeve, saqë punëtori i shtypshkronjës e ka vështirë t'i lidhë me tekstet.

Vëllimi i parë *Du côté de chez Swann* (Për *Suanin*, 1913) nuk u pranua nga Gallimard sipas recensës së shkrimtarit André Gide (Zhid), megjithë përpjekjet e princit Bibesco dhe shkrimtarit Louis Robert. Një vëllim nga kjo seri *Un amour de Swann* është përkthyer në mënyrën më të shkëlqyer nga Edmond Tupja me titull *Kur dashuronte Suani*. Gide u pendua pastaj për mendimin e nxituar. Asnjë botues nuk u tregua i interesuar për botimin e tij. Përfundimisht libri u botua me shpenzimet e autorit në shtëpinë botuese Grasset. Vëllimin e dytë *À l'ombre des jeunes filles en fleurs* (Nën hijen e vashave në lule të moshës), e botoi më 1918 te Gallimard dhe më 1919 fitoi çmimin Goncourt. Ai botoi gjithashtu *Pastiches et Mélanges* në NRF, 1919. Në këtë kohë ai ndërroi shtëpi dhe ëndërronte të pranohej në Akademinë franceze, por i kanë mbetur vetëm tre vite për të jetuar.

Stili i Prustit që quhet “kujtesë automatike” vështrohej si shumë i veçantë. Është një strategji shkrimore për ta sjellë të shkuarën në të tashmen me të gjitha emocionet, ndjesitë dhe ndjeshmëritë. Kjo karakteristike bën që shkrimësia e tij të jetë shumë e hollësishme, madje labirintike.

Sipas Jacques de Lacretelle dy shkrimtarët që kanë ndikuar shumë te Prusti janë Saint-Simon dhe Balzac. Nga shkrimtarët e gjallë ai çmonte së tepërmi Anatole France-in. Në një libër që i ka dhuruar, ai shkruan: “Zotit Anatole France, Mjeshtrit të pashoq, më të madhit, më të dashurit, me mirënjohje të veçantë nga Marcel Proust-i që e thërret gjithnjë Nabi dhe kujtohet për Kohën e humbur”.

Emra dhe pseudonime

E ëma e Prustit e thërriste “*floriri im, kanarina ime, budallushi im*”. Miqtë dhe shokët e quanin “*Lecram* (emri i tij i lexuar mbrapsht), *Bleta e luleve heraldike, Saturnian* dhe herë-herë kur donin të cilësonin mënyrën e tij të të shkruarit përdornin foljen “*proustifier* (prustifikoj). Darkat e tij në hotelin e madh parizian i dhanë emrin “Prusti i Ritz-it”.

Romancieri Paul Bourget duke iu referuar shijes së tij për porcelanin e Saxe-s, i shkruante mikes së tyre të përbashkët “[...] saksu yt psikologjik, Marseli i dashur [...]”.

Në shkrimet e tij të fillimit Prusti vetë shpesh ka përdorur pseudonime. Në shtyp ai firmoste: Dominik, Mark Antoni, Eko ose thjesht D.

Vdiq më 18 nëntor 1922, nga një pneumoni, kur e kishte shkruar fjalën *Fund* (Fin) në dorëshkrimin e vëllimit të fundmë të serisë romanore. Ai tashmë ishte bërë i famshëm me një veper të shndërruar në monument të letërsisë botërore. “Pasi kishte shkruar apo diktuar, rreth orës tre të mëngjesit, Prusti tepër i lodhur, e mbështeti kokën në nënkresë. Ai kërkoi që t’ia lënë ndezur abazhurin me dritë të gjelbër”. (Jean-Yves Tadié, *Biographie*, Gallimard, Paris, 1996, f. 908).

“I sëmuri i madh gjenial” e quan George Belmont, i cili ka mbledhur kujtimet e Céleste Albaret, 82 vjeçe, ish-guernante dhe njeriu i vetën të cilit i hapte zemrën Prusti për tetë vjetët e fundit të jetës. “Ajo që sjell dëshmia e saj e pazëvendësueshme, është imazhi tronditës dhe i papërsëritshëm i së vërtetës, i një Prusti të humbur e më së fundi të rigjetur dhe që del nga kujtimet më besnike, ato të zemrës, për të rijetuar midis nesh” (Nga parathënia e librit *Monsieur Proust* (Zoti Prust) me kujtimet e Albaret-it.

“Gjatë natës së 17 nëntorit duke u gdhirë 18, ai më thirri në mesnatë [...]”

-E dashur Selest [...] do të punojmë së

bashku.

Dhe nisi të më diktonte deri rreth orës dy të mëngjesit.

Në një çast tha:

-Më duket se lodhem më shumë duke diktuar se duke shkruar, për shkak të frymëmarrjes.

E mori penën dhe vazhdoi vetë për më shumë se një orë.

Imazhi i akrepave mbi fushën e orës është gdhendur në sytë e mi përjetësisht në çastin kur pena e tij u ndal së lëvizuri mbi letër [...]. Ishte saktësisht ora tre e gjysmë e mëngjesit” (Céleste Albaret, *Monsieur Proust*, Robert Lafont, Paris, 1973, f. 421, 422).

Një fotografi e bërë nga Man Ray të nesërmen, tregon një Marsel Prust në shtratin e vdekjes, në profil, me mjekër si profetët, mbështjellë me të bardha.

Përjetësimi

Më 1923, një vit pas vdekjes, *La Nouvelle Revue Française* (NRF) iu kushtua Marsel Prustit.

“Përdorimi letrar [...] i përvojës që ka mbledhur nga bota, do të na lejojë të mbërthejmë kalimin e saj në veprën e tij, si portret “me të dhëna jo si të tilla”, por së pari të transpozuar me ato që sjellin një rikrijim të tërësishëm të Kohës së humbur dhe Kohës së rigjetur (Claude Mauriac, *Revista e Re Franceze*, Paris, 1923, f. 70).

“Koha më mungon të flas për Marsel Prustin, ashtu si do të doja dhe duhen apo jo, vëllime të tëra dhe jo vetëm për veprën, por për jetën e tij, për jetën tonë” (Léon Paul Fargue, *Revista e Re Franceze*, Paris, 1923, f. 81).

Vepra e tij është botuar në *Pléiade*. Me qindra studime, libra, konferenca shkencore e takime janë mbajtur dhe mbahen për veprën e tij. Vetëm korrespondenca e tij ka 25 vëllime. Prusti është një pus i pashterrshëm.

Romani i mbetur në dorëshkrim me fragmente, i shkruar më 1895, u zbulua dhe u botua më 1952 me titull *Jean Santeuil*, sipas emrit të personazhit kryesor.

Kundër Sainte-Beuve-it (Contre Sainte-Beuve), në të vërtetë është një botim *postume* më 1954 me formën e një përmbledhjeje me fragmente tregimtare dhe ese të shkruara kushtuar shkrimtarëve që adhuronte Prusti si Balzac, Flaubert dhe të tjerë, në të cilat nuk mungon edhe fryma kritike. Aty ai i kundërvihet Sainte-Beuve-it dhe metodës së tij të analizës, sipas së cilës vepra e një shkrimtari është pasqyrim i jetës së tij dhe mund të shpjgohet prej saj. Kështu Prusti themelon poetikën e tij se vepra ekziston pavarësisht nga jeta e autorit dhe se ajo e ka kuptimin te vetvetja.

Fshati Illiers (Ilier) e frymëzoi Prustin të sajonte Combrey (Kombre) në veprën e tij. Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së shkrimtarit më 1971, fshati ku ai kalonte pushimet e fëmijërisë, për ta nderuar, e ndryshoi emrin në Illiers-Combrey.

Shtëpia e hallës Leoni të romanit është shndërruar në *Muzeu Marcel Proust*, dhe administrohet nga shoqëria *Miqtë e Marcel Proust-it*.

Disa parathënie dhe artikuj shtypi që kishin dalë kryesisht në gazetën *Figaro* duke filluar nga viti 1908, u përmbledhën në një vëllim më 1999 me kërkesën e Gaston Gallimard.

Dy librat e përkthyer nga Prusti janë përmbledhur në një botim nga shtëpia botuese Robert Lafont më 2015.

Parathënia e përkthimit të Ruskin-it është botuar me titull *Sur la lecture* (Për leximin) dhe ribotuar me titull *Journées de lecture* (Ditë leximi) nga Gallimard më 2017.

Në prill të vitit 2021 Gallimard botoi sërish një përmbledhje me dorëshkrime të zbuluara më 2018 me titull *Les 75 feuillets et autres manuscrits inédits* (75 fletët dhe dorëshkrime të tjera të pabotuara) që i paraprinë dikur serisë romanore *À la recherche du temps perdu*.

Cila është liria e shkrimtarit? Për mua shkrimtari ka të drejtë të ruaj dhe të botoj botërisht një këndvështrim depërtues, të fuqishëm, vetjak të situatës në të cilën ndodhet shoqëria e tij. Nëse mundet të bëjë më të mirën dhe të jetë i çliruar nga konformizmi publik i interpretimit politik, moralit dhe shijeve.

Kur jeton në këtë kohë, në këtë vend, dhe në këtë mënyrë si jetojmë ne, "liria" të vjen në mendje si një koncept krejtësisht politik, dhe kur njerëzit mendojnë për lirinë e shkrimtarëve, ata kanë menjëherë përfytyrimin pamor të një grumbulli të madh librash të djegur, të ndaluar, dhe të damkosur që qytetërimi ynë ka bërë pirg, një turrë librash ku vendi ynë ka dhënë dhe jep ndihmesën e vet. E drejta për t'u lënë i qetë për të shkruar atë që të pëlqen për ne që jetojmë dhe punojmë në Afrikën e Jugut nuk është çështje akademike. Këndvështrimi vetjak ka qenë dhe do të jetë gjithmonë burim frike dhe zemërimi për ithtarët e një mënyre jetese, si ajo e të bardhëve në Afrikën e Jugut, e cila nuk pranon asnjë pikëpamje tjetër përveç asaj që shihet nën dritën e një doktrine të veçantë vetë-përligjëse.

E gjithë ajo që mund të bëjë shkrimtari, është të vazhdojë të shkruajë të vërtetën siç e sheh ai. Këtë nënkuptoj me "këndvështrim vetjak" të ngjarjeve, qofshin ato ngjarje të mëdha publike të luftërave dhe revolucioneve, qofshin individuale dhe intime të jetës së përditshme, personale.

Për sa i përket fatit të librave të tij - vjen një çast në historinë e disa vendeve kur ndjenjat e shkrimtarëve të tyre shprehen më së miri te kjo poezi e shkruar nga Bertolt Brehti:

Kur Regjimi urdhëroi që librat me mësim të rrezikshme

Të digjeshin publikisht dhe kudo

Qetë u detyruan të tërhiqnin karroca plot me libra

Tek turra e druve,

Një poet në ekzil,

Ndër më të mirët,

Zbuloi me tërbim kur studioi listën

E librave të djegur, se librat e tij

Ishin harruar. Rendi drejtë shkruanisë së vet Mbi krahët e zemërimit u shkroi letër atyre në pushtet.

Më digjni, shkroi vrikthi me stilolaps, më digjni!

Pse ma bëni këtë. Jashtë listës mos më lini.

A s'e kam thënë gjithmonë

Të vërtetën në librat e mi?

Kurse ju tani si gënjeshtar më shihni!

Ju urdhëroj: Më digjni!

Nuk është poezi shumë e mirë, pavarësisht nga humbjet që mund të ketë prej përkthimit nga origjinali në gjermanisht; megjithatë, për sa u përket shkrimtarëve të Afrikës së Jugut, ne mund t'i kuptojmë ndjenjat e dëshpëruara të shprehura në këtë poezi dhe në të njëjtën kohë të vazhdojmë të luftojmë që librat tanë të lexohen në vend që të digjen.

Ndalimet dhe syrgjynosjet janë rreziqe të tmerrshme të njohura me të cilat duhet të përballim një shkrimtar, dhe shumë prej tyre janë përballur me to, nëse shkrimtari i përket një vendi ku liria e shprehjes, mes lirive të tjera, është e shtypur, por nganjëherë aftësia krijuese ngrin në vend që të shkatërrohet. Një Tomas Man i mbijeton ekzilit për të shkruar një Doktor Faust; një Pasternak kalon në mënyrë të paligjshme një Doktor Zhivago pas një heshtjeje dhjetëvjeçare; një Solzhenicin shfaqet me botën e tij të tmerrshme, të paprekur, në hartën e Arkipelagut Gulag; më afër kontinentit tonë: një Chinua Achebe, që shkruan nga Amerika, nuk e zbulon prozën për të kënaqur një regjim nigerian nën të cilin ai s'mund të jetojë; një Denis Brutus ka një autoritet gjithnjë në rritje jashtë vendit, ndërsa poezia e tij mbetet e ndaluar në vendin e vet; dhe një Breyten Breytenbach, pasi pranoi përjashtimin nga

Nadine Gordimer

(Nobel 1991)

LIRIA E SHKRIMTARIT

Përktheu: Granit Zela



ligji racist që e lejonte të vizitonte vendin e tij me një grua jo të bardhë, pa dyshim duhet të pranojë rrethanat po aq të çuditshme që botuesi nuk do t'ia botonte librin që do të shkruante në lidhje me vizitën, pasi ishte e sigurt që do të ndalohej.

Përmes gjithë këtyre peripecive, shkrimtarët e vërtetë vazhdojnë të shkruajnë për të vërtetën ashtu siç e shohin. Dhe nuk pranojnë të censurojnë veten. . . Ju mund t'i digjni librat, por integriteti i artistëve krijues nuk është i mishëruar më në letër më shumë sesa në telajo - ai mbijeton për aq kohë sa vetë artisti nuk mund të bindet, të mashtrohet ose të frikësohet për ta tradhtuar. E gjithë kjo, edhe pse e vështirë për t'u jetuar, është pjesa e luftës së shkrimtarit për liri të cilën bota e ka më të lehtë për t'a kuptuar.

Ekziston një kërcënim tjetër ndaj kësaj lirie, në çdo vend ku liria politike është e ndaluar. Është një më tinëz dhe për të cilin më pak njerëz janë të vetëdijshëm. Është një kërcënim që vjen nga vetë forca e kundërshtimit të shkrimtarit ndaj shtypjes së lirisë politike. Ajo liri tjetër, paradoksalisht më e gjerë, e përbërë - liria e pikëpamjes së tij vetjake për jetën - mund të kërcënohet nga vetëdija për atë që pritet prej tij. Dhe shpesh ajo që pritet prej tij është pajtueshmëria me një dogmë të kundërshtimit.

Do të ketë nga ata që e shohin si zëdhënës të tyre; njerëz idealet e të cilëve, si genie njerëzore, janë të njëjta, dhe kauza e të cilëve, si genie njerëzore, është e tija. Mund të jenë ata, vuajtja e të cilëve është e tij. Identifikimi me admirimin dhe besnikërinë ndaj tyre krijon një gjendje konflikti brenda tij. Integriteti i tij si genie njerëzore kërkon sakrificën e gjithçkaje për luftën e bërë në anën e njerëzve të lirë. Integriteti i tij si

shkrimtar vendoset në çastin kur fillon të shkruajë atë që duhet të shkruajë.

Ky është - pavarësisht nëse e pranojnë të gjithë apo jo - dhe do të vazhdojë të jetë një problem i veçantë për shkrimtarët me ngjyrë në Afrikën e Jugut. Për ta, ai shtrihet edhe në një dogmë fjalori: zhargonit i luftës, me prejardhje ndërkombëtare, është i drejtë dhe i përshtatshëm për tribunën publike, gazetën, deklaratën në bankën e akuzës; nuk është i mjaftueshëm, nuk është aq i thellë, i gjerë, i epshëm, tronditës, i freskët për fjalorin e poetit, të tregimtarit apo të romancierit.

As nuk është, siç do të pretendohet, "gjuhë e popullit" në një situatë ku sigurisht është shumë e rëndësishme që shkrimi krijues nuk duhet të arrijë vetëm tek elita. Zhargonit të luftës i mungon si pragmatizmi shpikës, ashtu edhe poezia e të folurit të zakonshëm - cilësi për të cilat përballet me sfidën për t'i rrokur dhe hulumtuar në mënyrë imagjinare, duke shprehur siç bëjnë shpirtin dhe identitetin e një populli ashtu siç s'mund ta bëjë kurrë "lutja fisnike" e klisheve të njëmijë duarve.

E vërteta është se një shkrimtar duhet të ruajë të drejtën për të thënë të vërtetën ashtu siç e sheh, me fjalët e tij, pa u akuzuar se ka zhgënjyer anën që mban. Sepse, siç ka shkruar Philip Toynbee, "dhurata e shkrimtarit për lexuesin nuk është entuziazmi shoqëror, përmirësim moral apo dashuri për atdheun, por zgjerim i perceptimit të lexuesit. Ky është kontributi unik i shkrimtarit në ndryshimet shoqërore. Ai duhet të lihet i qetë, nga vëllezërit ashtu si edhe nga armiqtë, për ta bërë këtë dhuratë. Dhe ai duhet ta bëjë edhe kundër prirjes së tij".

Nuk është nevoja të shtoj, se kjo s'do të thotë se ai tërhiqet në një kullë fildishi.

Dhurata nuk mund të bëhet nga ndonjë vend i tillë. Zhan Pol Sartri ka dhënë përkufizimin e mëposhtëm të përgjegjësisë së shkrimtarit ndaj shoqërisë si intelektual, pasi ai vetë kishte zënë një pozicion të tillë në Francë për pjesën më të mirë të shtatëdhjetë viteve: "Shkrimtari është besnik ndaj një politike dhe organi social por nuk resht kurrë së kundërshtuari atë. Sigurisht; mund të lindë një kontradiktë midis besnikërisë dhe kundërshtimit, por kjo është kontradiktë e frytshme. Nëse ka besnikëri pa kundërshtim, nuk është gjë e mirë: ai nuk është më një njeri i lirë".

Kur një shkrimtar shpall këto lloj lirisht për veten, ai fillon të kuptojë përmasat reale të përpjekjeve të tij. Ky nuk është një problem i ri dhe nga të gjithë shkrimtarët që u është dashur të përballen me të, nuk mendoj se e ka parë kush më qartë ose e ka trajtuar me një ndershmëri të tillë të pakompromis si rusi i madh i shekullit të nëntëmbëdhjetë, Ivan Turgeniev. Turgenievi kishte reputacion të jashtëzakonshëm si shkrimtar përparimtar. Ai ishte i lidhur ngushtë me lëvizjen përparimtare në Rusinë cariste dhe veçanërisht me krahu më revolucionar të udhëhequr nga kritiku Belinski dhe më pas nga poeti Nekrasov. Me skicat dhe tregimet e tij, njerëzit thoshin se Turgenievi po vazhdonte punën që kishte filluar Gogoli për të zgjuar ndërgjegjen e klasave të arsimuara në Rusi ndaj të këqijave të një regjimi politik që mbështetej te robëria.

Por miqtë, admiruesit dhe shokët përparimtarë nuk e kuptuan gjenialitetin e tij, pikërisht për atë që e bëri të tillë - ruajtja e me fanatizëm e lirisë së shkrimtarit për të riprodhuar të vërtetën dhe realitetin e jetës, edhe nëse kjo e vërtetë nuk përkon me simpatitë e veta.

Kur romani i tij më i madh, "Etër dhe bij", u botua në vitin 1862, ai u sulmua jo vetëm nga e djathta se u kishte shkruar pas qejfit nihilistëve revolucionarë, por shumë më ashpër nga e majta, vetë brezi i ri, nga të cilët personazhi kryesor në roman, Bazarovi, ishte edhe prototip edhe apoteozë. Radikalët dhe liberalët, në mesin e të cilëve bënte pjesë edhe vetë Turgenievi, e quajtën tradhtar, sepse Bazarovit iu paraqitën të gjitha gabimet dhe kontradiktat që Turgenievi shihte në llojin e tij, te vetja, dhe të cilin ai krijoi të tillë sepse - po të përdorim fjalët e tij - "në këtë rast, jeta e tillë ka qenë".

Sulmet u ripërtërinë pas botimit të një romani tjetër, "Tymi", dhe Turgenievi vendosi të shkruante një sërë kujtimesh autobiografike që do t'i lejonin t'u përgjigjej kritikëve duke shpjeguar pikëpamjet për artin e të shkruarit, vendin e shkrimtarit në shoqëri dhe cili duhet të jetë qëndrimi i shkrimtarit ndaj problemeve të diskutueshme të kohës së tij. Rezultati ishte një seri esesh të sinqerta që përbëjnë një testament të jashtëzakonshëm të kredos së një shkrimtari. Duke u marrë veçanërisht me Bazarovin dhe "Etër dhe bij", ai shkruan për kritikët e tij:

...Në përgjithësi, ata nuk e kanë idenë e duhur se çfarë po ndodh në mendjen e një shkrimtari ose cilat janë gëzimet dhe hidhërimet, synimet, sukseset dhe dështimet e tij. Ata, për shembull, nuk dyshojnë as për kënaqësinë që përmend Gogoli dhe që ka të bëjë me ndëshkimin e vetes dhe të gabimeve te personazhet imagjinare që përshkruan; ata janë shumë të sigurt se gjithçka që bën një shkrimtar është të "zhvillojë idetë e tij"... Më lejoni ta ilustruj këtë që po them me një shembull të vogël. Unë jam një perëndimor i pandreqshëm dhe i pakorrigjueshëm. Nuk e kam fshehur asnjëherë dhe nuk po e fsheh as tani. E megjithatë, pavarësisht nga kjo, më ka dhënë kënaqësi të madhe të shfaq në personin e Panshin [një personazh te "Një shtëpi zotëerinjsh"] të gjitha anët e zakonshme dhe vulgare të perëndimorëve:

e bëra sllavofilin Lavretski “ta dërrmoj plotësisht”. Pse e bëra, unë që e quaj të rreme dhe të kotë doktrinën sllavofile? Sepse, në rastin e dhënë, jeta, sipas ideve të mia, ka qenë e tillë dhe para së gjithash doja të isha i sinqertë dhe i vërtetë. Në përshkrimin e personalitetit të Bazarovit, përjashtova gjithçka artistike nga gama e simpative të tij, e bëra të shprehej me tone të ashpra dhe pa stërholime, jo nga një dëshirë absurde për të fyer brezin e ri, por thjesht si rezultat i vëzhgimeve të mia ndaj njerëzve si ai... Parapëlqimet e mia vetjake nuk kishin të bënin me të. Por unë pres që shumë nga lexuesit e mi të habiten nëse u them se me përjashtim të pikëpamjeve të Bazarovit për artin, unë kam gati po ato bindje.

Dhe në një ese tjetër, Turgenievi e thotë përmbledhtasi: “Jeta përreth shkrimtarit i siguron përmbajtjen e veprave; ajo është reflektimi i përqendruar i saj; por shkrimtari është po aq i paaftë për të shkruar një panegjirik sa një pamflet... Kur gjithçka thuhet dhe bëhet – ky reflektim është pas gjithçkaje. Vetëm ata që nuk mund të shkruajnë më mirë i nënshtrohen një teme të caktuar ose bëhen pjesë e një plani të paracaktuar.

Këto kushte për të cilat kam folur janë të veçanta, ndonëse të zakonshme për shkrimtarët që jetojnë në kohën e bombës atomike dhe racizmit, siç ishin në kohën e çizmes ushtarake pushtuese dhe shkopit të gomës dhe, pa dyshim, nëse kthehem në epokat e mëparshme, simbolet e të cilave mbajnë shenjën e shtypjes dhe turpeve që fshihen prej qytetërimeve tona.

Ka edhe kushte të tjera, më kalimtare, më pak të dhunshme, të cilat ndikojnë në lirinë e mendjes së një shkrimtari. Po moda letrare, për shembull? Po cikli i risive, imituesve, përbuzësve dhe më pas krijimit përsëri të një risie? Një shkrimtar s’duhet të bëhet shumë i ndërgjegjshëm për modën letrare, ashtu si nuk duhet ta lejojë të pengohet nga drejtuesit burokratë, nëse do të vazhdojë të krijojë një vepër që është e tij. Them “të bëhet i ndërgjegjshëm” sepse moda letrare është pjesë e kushteve të tij të punës; ai mund të bëjë zgjedhjen për ta refuzuar, po nuk mund të zgjedhë nëse ndjekja e modës letrare i kërkohet apo jo nga botuesit dhe lexuesit, të cilët nuk e lënë të harrojë se duhet të hajë.

Shkrimtari novator, kjo mrekulli e rrallë, duhet prituri me tronditje dhe emocion. Dhe ndikimi i tij mund t’i shtyjë njerëzit në drejtime të reja vetjake. Por novatori i radhës rrallë, thujase kurrë nuk vjen nga imituesit, ata që krijojnë një modë sipas imazhit të tij. Jo çdo shkrim me vlerë është risi, por besoj se risia vjen gjithmonë nga një vizion individual, i ndjekur në mënyrë vetjake. Ndjekja mund të rrjedhë nga një traditë, por tradita nënkupton një zgjedhje ndikimi, ndërsa një modë e bën ndikimin e momentit të vetmin për të gjithë ata që janë bashkëkohorë me të.

Një shkrimtar ka nevojë për të gjitha këto lloj lirish, që mbështeten në më themeloren, atë të lirisë nga censura. Ai nuk kërkon mbrojtje nga jeta, por depërtim tek ajo pa e shmangur. Shkrimtari depërton fuqishëm te jeta sipas mënyrës së tij dhe duhet t’i lihet atij, të shoh nëse ka ndonjë fryt prej kësaj përpjekjeje. Çdo qeveri, çdo shoqëri - çdo vizion i një shoqërie të ardhshme që ka respekt për shkrimtarët duhet t’i lërë të jenë sa më të lirë, të shkruajnë në mënyrat e tyre të ndryshme, të bëjnë zgjedhjet e tyre të formës dhe gjuhës, dhe të bëjnë zbulimin e tyre të së vërtetës.

Sërish, Turgenievi e shpreh këtë më së miri: “Pa liri në kuptimin më të gjerë të fjalës - në raport me veten...në të vërtetë, me popullin dhe historinë, një artist i vërtetë as që mund të mendohet, pa atë ajër, është e pamundur të marrësh frymë”.

Dhe unë po shtoj edhe fjalën time të fundit: Vetëm në atë ajër, përkushtimi dhe liria krijuese bëhen njësh.

Dino Barberis

KEQARDHJET

Tregim

Përktheu nga origjinali Durim Taçi



Kisha marrë të shkruaja edhe një herë një ditar të vogël vetiak si atëherë kur isha adoleshent. Më kujtohet që asokohe e bëja çdo ditë, derisa i thashë vetes, dikur, se ia vlente më shumë të jetoje se sa të shkruaje si po jetoje. Po tani më bëhet sikur ditët rendin më shpejt, pa mundur dot t’i gëzoj një e nga një. Kështu vendosa të hidhja në letër së paku ndonjë përshtypje mbi ndodhi a takime, sidomos të rastit, që më kishin lënë diçka. Kur ia thashë tim biri, ma ktheu se do kishte qenë më mirë të hapja një blog. Po kush do e lexonte atë që shkruaja unë? Kujt do t’i hynin në punë?

“Je i zymtë!” qe komenti i tij. Dhe kishte të drejtë, kohët e fundit isha mbyllur në vetvete e nuk e kuptoja arsyen. Mbase ishte puna që më rëndonte edhe më shumë...

Vendosa të mjaftohesha me orët që më paguanin. Lija ndonjë praktikë pune në mes, po nuk e vrisja mendjen. Kujtoj se kur isha i ri e ndërprisja të mësuarit edhe pse e dija se të nesërmen do pyetesha në dërrasë të zezë, mjafton që koha të ishte e bukur dhe parapëlqejta të rrezikojta për të nesërmen në vend që të humbisja një xhiro tjetër me biçikletë apo edhe në këmbë. Vetëm se tani nuk e merrja vesh mirë se çfarë duhet të bëja gjatë këtyre minutave lirie që më prisnin ditët si me thikë... Nuk arrija më të qëndroja në vend pa bërë asgjë, kështu ia shpreha gruas shqetësimin duke i propozuar të bënim ndonjë shetitje në qendër të qytetit, hera-herës.

“Çfarë po ndodh me ty? Do vija sa herë të doje, po qe se do më jepje një dorë me punët e shtëpisë, të hekurosësh, për shembull. Pastaj, kohën e mbetur bredhim”. Nuk më kuptonte: nuk doja të sillsha vërdallë, lart e poshtë, si atëherë kur ishim të rinj, por thjesht të shkëputesha pak. Edhe ajo puna e hekurit të rrobave: nuk bëhej nami se diçka mbetej pa hekurosuar... Nuk ma vari: edhe ajo vetë ishte shndërruar në vegël e atij

mekanizmit pervers të ritmit të shfrenuar të përditshëm.

Ai ishte problemi i vërtetë: tanimë ecej përpara prej zakonit. Që nga zgjimi deri tek gjumi i darkës pothuaj gjithçka ishte njësoj. Me pak ndryshim të shtunën e të dielën, por që edhe ato ngjanin tmerrësisht... E shtuna: blerja e ushqimeve dhe punët e shtëpisë. E diela: zgjim i vonë e ideja për të bërë diçka ndryshe, por që nuk gjendej lehtë. Kujtoj që vite të shkuara çdo ditë ishte e paparashikueshme. Gjatë kohës së gjimnazit ishte orari i shkollës që përcaktonte edhe kohën e shetitjeve të përditshme, por në universitet këto bredhje bëheshin edhe më të gjata: vareshin nga provimet e pastaj secili bënte si ti tekej. Dita më e bukur ishte ajo pas çdo provimi: ishe i lirë të sorollateshe, të ndreqje a të prishje e prapë të dukej se e kishe gjithçka nën kontroll. Kurse tani, nuk dihet përse, të duket sikur secili ka hyrë në një kafaz të madh të pruar ku ka hapësirë bajagi të madhe veprimi, po prapë është kafaz. Krahasova veten me Xhorxon, që gjithmonë ka qenë shok i aventurave të mia.

“Eh, shpesh, jemi vetë ne që burgosim veten. Nuk kemi bërë më pushime aventurash, edhe ngaqë kemi familjet tona. Unë jam i gatshëm për ndonjë gjë në fakt: mund të bëjmë diçka të veçantë e t’i sjellim vetes atë shijen e befasisë”. Jo, nuk më kishte kuptuar. Unë nuk kërkoja të papriturën, se me të tilla ishte e mbushur dita plot. Kërkoja ajër të freskët, të dilja jashtë çdo veprimi të zakonshëm. “E mora vesh - më tha - ke disa keqardhje nga rinia, e cila nuk kthehet më. Në moshën tonë kjo është edhe e natyrshme”.

Kështu e asgjësonte fare dëshirën time: i thoshte keqardhje. Mendova: në rregull, kishte ndonjë gjurmë keqardhjeje, po nuk ishte vetëm e tillë. Ishte vetëdija se jeta ecte shumë shpejt dhe për këtë duhej jetuar më vullshëm edhe për ca kohë. Pastaj edhe

rinia ime nuk kishte qenë fare pa andralla: në gjimnaz kisha pasur probleme me shokët, tre vajza më kishin lënë, njera pas tjetrës, sa nisa të dyshoja që ishte këmba ime që nuk shkonte e jo këpuca që mbathja. E pastaj më ishte dashur të punoja që të paguaja studimet, se prindërit nuk ia dilnin. Jo, kishte qenë në fakt një rini e shkujdesur. Po, isha vetja e nuk më rëndonin të gjithë këto vështirësi. I kaloja me lehtësinë e atij që çan valët duke bërë surfing... përpara! Tani edhe vështirësia më e vogël duket barrë e rëndë. Nuk isha më i shkujdesur...

“Mor babë - më tha vajza - shkujdesja i përket moshës sime. Dhe po të iku njëherë nuk kthehet më. Po edhe ne tani nuk është se kemi halle që na lënë pa gjumë... Apo jo?”

Jo, ashtu ishte, po prapë kjo nuk më pëlqente.

I mendova gjatë fjalët e vajzës, sepse fshihnin diçka të pathënë. Më në fund e kuptova: po më thoshte se keqardhjet janë tipike për ata që kishin kaluar të pesëdhjetat. E pabesueshme: kishte guxuar të më mësonte mua që isha tridhjetë vjet më i madh se çfarë më priste nga jeta. Si ka mundësi e dinte ajo këtë gjë? Natyrisht bëhej fjalë për vendin e tyre, shpikur nga të rinjtë, të cilin e ruanin me fanatizëm, një “territor” që kërcënohej nga prindërit, nga prindërit që duan të mbesin përjetësisht të rinj (dikush thoshte madje “adoleshentë”), pavarësisht se mosha tregonte tanimë se harku ishte në zbritje. Kjo gjë më ngriti nervat dhe për ca ditë e kuptova që po i rrija me turinj.

“Mjaft tani - vërejtje gruaja - mos bëj si adoleshent me Klaudian. Sikur të ka vjedhur lodrat...”. Edhe ajo ishte bashkëpunëtore... Po ajo nuk kishte keqardhje, se moshën time kishte? Po të mos kishte keqardhje, teza e vajzës sime do kishte rënë që në nisje.

“Keqardhje? - më tha duke qeshur - nuk do ti quaja kështu, se nuk kam asgjë nga ç’kam bërë për të cilën do të pendohesha. Po i quaj raste të humbura, por që kanë ndihmuar të kap të tjerat”. “Dëgjo, shpjegohu më mirë e mos na filozofu kot”.

Më buzëqeshi edhe një herë me atë vështrim mëshirues që më bënte të ndihesha gdhe. “Kur blen në dyqan, më shumë gjëra i lë, apo jo? Dhe po të pyesin a nuk të vjen keq për ato që le? Unë do të thosha: jo, sepse, tek e fundit kam blerë diçka tjetër që më hyn në punë”. Ah, po: tani po e marr vesh pse më kishte bërë të vetin gruaja: se më mungonte mençuria. Mendova për ditë me radhë e mu kthye buzëqeshja: tek e fundit kështu ishte.

Derisa të shtunën tjetër, me të në dyqan e pashë se shkonte të gjente ku kishte oferta. “Më fal - i thashë - makarona kemi. Raftin plot”.

Ah, pa shiko. Nuk qenka puna tek zgjedhjet e vetëdijshme e tek fakti se të tjerat janë ato që mbeten jashtë vëmendjes... Jo: vrapo për të kërkuar oferta speciale në jetë, edhe pse nuk janë për ty. Po kur të mos ketë oferta? Çfarë do bësh? Kjo është një periudhë në të cilën mungojnë ofertat speciale. Ia thashë këtë.

“Dëgjo - këtë herë ishte pak e nxehur - në vënd që të ma mbushësh kokën me frikërat e moshës së mesme, përse nuk shkon e zë radhë tek arka? Kështu fitojmë vendin!”. Ja përsëri: në kërkim të diçkaje speciale... nuk ishte edhe aq e mençur sa hiqej. Mirëpo, ishte më normale dhe kjo e bënte më simpatike.

Kujtoj shumë mirë se si mbaroi ajo periudhë keqardhjeje e hatërmbetjesh. Ndodhi kur im bir njoftoi se shpejt do kishin një fëmijë. E fejuara e tij do të lindte pas gjashtë muajsh. Martesa? “Eh - tha ai - të lindë i vogli e pastaj të shohim”. “Qenka djalë?” “Nuk e dimë e as nuk duam ta dimë. Nëse shkon si duhet do bëheni gjyshër, kaq”.

Ja oferta speciale, shërbyer në një kupë të argjendit. E kësaj radhe nuk doja ta humbisja e të vrapoja pas fantazmave të së shkuarës.

ADIL OLLURI

**VDEKJA
E
OMERIT**



OnufriRoman